# RAPORT PËRFUNDIMTARË MBI "AUDITIMI PËRPUTHSHMËRIE MBI VEPRIMTARINË E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBTARE TË BREGDETIT "


| | | |
|---|---|---|
| | Përmbajtja | 1 |
| I | **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE** | 2-2 |
| | 1.Përshkrim i shkurtër Raportit Përfundimtarë | 2-2 |
| | 2.Përshkrim i gjetjeve kryesore | 2-4 |
| | 3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit | 5-6 |
| II | **HYRJE** | 7-7 |
| | 1.Objekti i auditimit | 7-7 |
| | 2.Qëllimi i auditimit | 7-7 |
| | 3.Identifikimi i çështjes | 7-7 |
| | 4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese | 8-8 |
| | 5.Përgjegjësitë e audituesve | 8-8 |
| | 6.Kriteret e vlerësimit | 8-8 |
| | 7. Standartet e auditimit | 9-10 |
| | 8.Metodat e auditimit | 9-10 |
| | 9.Dokumenti i auditimit | 9-10 |
| **III** | **PËRSHKRIMI I AUDITIMIT** | 10-82 |
| 1 | Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim | 10-10 |
| 2 | Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit. | 10-10 |
| Pika 1 | 1.Mbi hartimin dhe Zbatimin e buxhetit.<br>a. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. | 10-14 |
| Pika 2 | Zbatimi i legjislacionit për realizimin e proceduarve të Prokurimit Publik; Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve. | 15-40 |
| Pika 3 | Mbi auditimin për krijimin dhe përditësimin e inventarit kombëtar të zonës bregdetare, bashkëpunimi me strukturat e tjera . | 40-43 |
| Pika 4 | Mbi auditimin e procedurave të ndjekura për dhënien në përdorim dhe administrim të plazheve publike dhe private. | 43-55 |
| Pika 5 | Mbi kryerjen e monitorimeve, inspektimeve, dhe zbatimin e procedurave për shkeljet e konstatuara. | 56-81 |
| **IV.** | **GJETJET DHE REKOMANDIMET** | 81-91 |
| **V.** | **ANEKSE** | - |

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Agjencisë Kombëtarë të Bregdetit kryen veprimtarinë në zbatim të VKM-së, nr.568,datë 17.07.2019,"Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 " Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së.

**I .1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit**

Agjencisë Kombëtarë të Bregdetit kryen veprimtarinë e saj referuar VKM-së, nr.568,datë 17.07.2019,"Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 " Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së. Ka për objekt. zbatimin e buxhetit,lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve; Mbi krijimin dhe përditësimin e inventarit kombëtar të zonës bregdetare, bashkëpunimi me strukturat e tjera; Mbi procedurat e ndjekura për dhënien në përdorim dhe administrim të plazheve publike dhe private; Mbi kryerjen e monitorimeve, inspektimeve, dhe zbatimin e procedurave për shkeljet e konstatuara.

**I .1. Përshkrim i shkurtër i Raportit tëAuditimit**

**I.** 2. Përshkrim i përgjithshëm i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

| GJETJA NR. | PËRMBLEDHJE E GJETJES | REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTARË | RËNDËSIA | REKOMANDIMI |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Nga auditimi u konstatua se, dokumentacioni në sistemin e-inspektime, në përgjithësi, i mungonte dokumentacioni bashkëlidhur, veprime në kundërshtim me Urdhrin nr. 25 datë 10.08.2018 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ" si dhe pikën 2.2 dhe 2.7, Kreu II të Urdhrit nr. 13, datë 23.04.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në RSH". | Fq.55-67 | *E Mesme* | Inspektoret e Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të marrin për çdo subjekt të inspektuar të hidhen të gjithë dokumentacioni në sistem e-inspektime, që ndodhet në subjekt, në të kundërt të merren masa administrative me gjobe sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. |
| 2 | Nga auditimi u konstatua se , në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, për vitin 2021-2022 janë marrë 44 masa administrative gjoba për subjektet që ushtrojnë aktiviteti pa kontrata "stacione plazhi'. Por nga AKB, nuk ka korrespodencë zyrtare / shkresa informuese drejtuar Policisë | Fq.61-72 | *E mesme* | Agjencia Kombëtare e Bregdetit, të mundësojë korrespodencë zyrtare / shkresa informuese , në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Bashkiake, apo dhe një bashkëpunim me inspektoret e taksave pranë NJQV-ve, për marrjen e masave për pezullimin e aktivitetit të pa ligjshëm, dhe lirimin e hapësirave publike .Por janë mjaftuar vetëm me masën administrative gjobë. | | | Vendore, të marrë masë në rastet e konstatimi të ushtrimit të aktivitetit pa kontratë, të sekuestrojnë dhe të bëjnë të mundur lirimin e hapësirave publike të zaptuara pa drejtësisht /kontratë. |
| 3 | Në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për vitin 2021- 2022, që janë vendosur gjithsej 105 gjoba, në vlerë totale 13,080 mije lekë, nga këto kanë likuiduar 11 subjekte kryesisht me vlerë likuiduese 1,660 mije lekë, me likuidimi vullnetare, janë pa arkëtuar në vlerën 87,440 mijë lekë, duke mos ndjekur procedurat ligjore sipas "Kreut VI ,neni 45,46, te ligjit nr. 10433,datë 16.06.2011 si dhe Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenin 9, shkronja b pika 4 të nenit 30, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative". | *Fq.70-79* | *E mesme* | Agjencia Kombëtare e Bregdetit, sektori juridik të marrin masat e nevojshme për ndjekjen e 94 gjobave në vlerën në vlerën 87,440 mijë lekë dhe të ndjekin të gjitha procedurat ligjore në procese gjyqësore/dhe deri në arkëtimin e tyre. |
| 4 | Nga auditimi u konstatua se**,** kontratat për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturë shërbimi janë konstatuar mangësi në elementët dhe dokumentacionin e nevojshëm, Në 9 raste, aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë për stacione plazhi janë miratuar me plan operimi që nuk është sipas formatit të publikuar online dhe nuk janë plotësuar nga subjekti sipas rubrikave të kërkuara;<br>Në 16 raste, nuk janë paraqitur fotografi të strukturës së shërbimit/ strukturës Akomoduese në raport me stacionin e plazhit;<br>Në 5 raste, aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë për stacione plazhi janë | Fq 46-50 | *E mesme* | Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve të marrë masa që të shqyrtojë aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit, në respektim të kritereve dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi, duke përfshirë kontrollin e rregullshmërisë nga pikëpamja ligjore e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | miratuar pa certifikatat e kualifikimit të vrojtuesve;<br>Në 2 raste, subjekti rezulton debitor në tatime;<br>Në 2 raste, subjekti nuk ka të regjistruar aktivitetin " strukturë shërbimi/strukturë Akomoduese " në ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit. " | | | dokumentacionit. |
| 5 | Nga auditimi u konstatua se, në 9 raste kontratat për ushtrimin e stacioneve të plazhit në kontratat e punës ndërmjet subjekteve dhe vrojtuesve të plazhit, është përcaktuar se vrojtuesit kanë 1-2 ditë pushim në javë. Në këto raste mungon një vetëdeklarim i subjektit, se nuk do ta ushtrojë veprimtarinë përgjatë gjithë ditëve të javës. | Fq 42-50 | *E mesme* | Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa në vijimësi, që para nënshkrimit të kontratës, subjekti duhet të paraqesë marrëveshjen e motorizuar me vrojtuesit e plazhit, e vlefshme përgjatë gjithë ushtrimit të veprimtarisë së tij. |
| 6 | Nga auditimi u konstatua se**,** në 7 raste kontratat për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturës së shërbimit , kontratat e formatit tip të qirasë nuk janë firmosur nga përfaqësues të Bashkisë së Vlorës. | Fq43-55 | *E mesme* | Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që të njoftojë në rrugë shkresore njësitë vendore përkatëse për nënshkrimin e kontratave, që të vijohet më tej me përcaktimin e koordinatave në terren të stacioneve të plazhit. |
| 7 | Nga auditimi i përdorimit të karburantit në institucionin e AKB-së grupi i auditimit konstatoi disa mangësi në dokumentimin e përdorimit të karburantit si:<br>- Përgjithësisht Fletët e Udhëtimit nuk ishin të nënshkruara nga punonjësit e AKB-së për të justifikuar lëvizjet e kryera si dhe Fletë Udhëtimet përgjithësisht, nuk janë shoqëruar me | Fq 35-40 | *E mesme* | Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që në vijimësi, të gjithë punonjësit e AKB-së që përdorin automjetet e këtij institucioni të kryejnë dokumentimin e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | faturat tatimore të subjekteve ku është marrë karburanti pavarësisht se në sistem sasia e karburantit rezulton e konsumuar veprime në kundërshtim me Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika nr. 36. | | | plotë të përdorimit të karburantit dhe ky dokumentacion të shoqërohet me Faturat Fiskale për çdo konsum karburanti. |
| 8 | Nga auditimi u konstatua se, përllogaritja e fondit limit nga "Komisioni për përllogaritjen e karburantit për Institucionin" nuk është bërë në mënyrë të detajuar pasi nuk janë përcaktuar shumë faktor të rëndësishëm si numri total i Inspektimeve, Monitorimeve, Verifikimeve etj të kryera gjatë viteve të kaluara. Për sa më sipër nuk është bërë një përllogaritje e detajuar për totalin e kilometrave të përshkruara në vitet e kaluara për të arritur në një përllogaritje më të saktë për nevojat e institucionit të AKB-së për karburant për automjetet në dispozicion të tij, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 2875, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar si dhe Udhëzimi nr. 6, datë 16.01.2018, "Përllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër" pika nr.7. | Fq 20-26 | *E mesme* | Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa dhe , të bëhet një përllogaritje e saktë dhe e detajuar mbi nevojat e institucionit për punë, mallra dhe shërbime, në çdo procedurë me qëllim realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe përdorimin me efektivitet, efecientë dhe ekonomi citet të fondeve publike. |

## A. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT

**Për auditimin e përputhshmërisë**

Ne kemi audituar Agjencinë Kombëtare të Bregdetit , përsa i takon shkallës së zbatimit të rregullave, ligjeve, termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord kriteret, e auditimit të përputhshmërisë dhe bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë, e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit është krijuar me Vendim Nr.569, datë 17.07.2019 "Për miratimin e kompetencave , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", Urdhrit Nr. 25, datë 03.02.2020, ndryshuar me Urdhrin Nr. 186, datë 15.11.2022, të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Bregdetit". *Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e* se *Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, janë evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën*

*gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar/kualifikuar.*

**Baza për opinionin (I modifikuar/kualifikuar)**

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura, si vijon:

-në 25 subjekte nga të cilat 13 me veprimtari "Operator Turistik" dhe 12 subjekte me veprimtari "struktura Akomoduese "në listat e verifikimeve, ne rubrikën "Komente" evidentohet se subjektet e planifikuara për inspektim kanë qenë të mbyllura fizikisht.

-në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, për vitin 2021-2022 janë marrë 44 masa administrative gjoba për subjektet që ushtrojnë aktiviteti pa kontrata "stacione plazhi'. Por nga AKB, nuk ka korrespodencë zyrtare / shkresa informuese drejtuar Policisë Bashkiake, apo dhe një bashkëpunim me inspektoret e taksave pranë NJQV-ve, për marrjen e masave për pezullimin e aktivitetit të pa ligjshëm, dhe lirimin e hapësirave publike.

-në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për vitin 2021- 2022, janë vendosur gjithsej 105 gjoba, në vlerë totale 13,080 mije lekë, nga këto kanë likuiduar 11 subjekte kryesisht me vlerë likuiduese 1,660 mije lekë, me likuidimi vullnetare, janë pa arkëtuar në vlerën 87,440 mijë lekë.

-në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, për vitin 2021-2022 u konstatuan në 13 raste nga auditimi me zgjedhje i praktikave të inspektimit, ndaj agjencive dhe operatorëve turistik, janë hartuar autorizime vetëm për një pikë të Ligjit nr. 93/2015 "Për Turizmin", konkretisht pajisja me licencë.

- në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, për vitin 2021-2022 në 7 raste , kontratat për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturës së shërbimit formatit tip të qirasë nuk janë firmosur nga përfaqësues të Bashkisë së Vlorës.

- në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, për vitin 2021-2022 në 9 raste, kontratat për ushtrimin e stacioneve të plazhit në kontratat e punës ndërmjet subjekteve dhe vrojtuesve të plazhit, është përcaktuar se vrojtuesit kanë 1-2 ditë pushim në javë.

-në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, për vitin 2021-2022- në 5 raste, aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë për stacione plazhi janë miratuar pa certifikatat e kualifikimit të vrojtuesve;

- në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, për vitin 2021-2022,në 2 raste, subjekti rezulton debitor në tatime;

- në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, për vitin 2021-2022,në 2 raste, subjekti nuk ka të regjistruar aktivitetin "strukturë shërbimi/strukturë Akomoduese " në ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit.

- në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, për vitin 2021-2022, në 6 raste nuk është bërë hedhja në sistemin e APP-së, duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit. Pra këto procedura duhet të kryheshin si procedura normale prokurimi dhe jo si blerje nën 100.000 lekë pa tvsh.

-Për llogaritjen e fondit limit për karburantin grupi i punës në Institucionin për nevojat e institucionit për karburant për automjetet në dispozicion të tij, nuk ka bërë një përllogaritje e detajuar për totalin e kilometrave të përshkruara në vitet e kaluara për të arritur në një përllogaritje më të saktë për nevojat e institucionit.

**Përgjegjësitë e Drejtuesve të Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.**
Strukturat drejtuese të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, janë përgjegjëse: për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Si dhe për përdorimin e burimeve financiare,
-Hartimin dhe zbatimin e buxhetit,
-zbatimin e legjislacionet për prokurimet publike,
-Inspektimet sipas fushës së veprimtarisë së subjekteve,
-dhënien në përdorim dhe administrimin e plazheve,
**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin Ligjshmërisë dhe rregullshmërisë**
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të kolauduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatimin e kritereve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## I. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr.561/1 datë 30.06.2023 "*Auditim përputhshmërie mbi veprimtarinë*" Agjencisë Kombëtarë të Bregdetit për periudhën nga 01.01.2021 deri në 31.12.2022, u kryе auditimi "Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë në Agjencinë Kombëtarë të Bregdetit" nga Grupi i Auditimit me përbërje:

**Grupi i Auditimi me përbërje:**
1.V. B., përgjegjës grupi
2.Sh. H., anëtare
3.A. V., anëtar

***1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit*:** Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Kombëtare të Bregdetit duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me është vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare të Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për Sigurimin e perfomancës në zonat bregdetare; Organizimin e punës për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare; Organizimin e punës për nxitjen e investimeve në zonën bregdetare; Organizimin e punës për bashkërendimin e programeve, të projekteve zhvilluese me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare; Sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet inspektimit dhe kontrollit të veprimtarive turistike.
***2.Qëllimi i auditimit*: v**lerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare të Agjencinë Kombëtar të Bregdetit mbi çështjet që lidhen me ruajtjen, menaxhimin, nënshkrimin e kontratave me stacione të plazhit monitorimin inspektimin stacionet e plazhit.

***3. Identifikimi i çështjes***

**1-**Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit ,
A .Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave,
**2-** Mbi auditimimin e prokurimeve publike të fondeve publike
b-Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave punëve dhe shërbimeve.
3-Mbi auditimin për krijimin dhe përditësimin e inventarit kombëtare të zonës bregdetare bashkëpunimi me strukturat tjera.
4-Mbi auditimin e procedurave të ndjekura për dhënien në përdorim dhe administrimin e plazheve publike dhe private.
**5-** Mbi auditimin për kryerjen e inspektimeve dhe zbatimit të proceduarve për shkeljet e konstatuara.
**6-** Të tjera gjatë auditimi.

**4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar**:

Agjencia Kombëtare e Bregdetit , është përgjegjëse për veprimtarinë duke u referuar Vendim Nr.569, datë 17.07.2019 "Për miratimin e kompetencave , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit" Vendim Nr.171, datë 27.03.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit "ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" Rregullore e Brendshme Nr. 9034/1 prot., datë 07.11.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit".

***5. Përgjegjësitë e audituesve:***

Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar:
-Të vlerësojmë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4100* ), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese;
-Të vlerësojmë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në ketë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300);
-Të kryejmë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të objektivit.
Ne jemi të pavarur e theksuar kjo në ISSAI-n 10 "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe ISSAI 30 "Kodi Etik", apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i përmbushim përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

**6. Kriteret e vlerësimit:**

Për dhënien e opinionit të përputhshmërisë jemi bazuar në aktet ligjore, nënligjore, urdhra, udhëzime dhe rregullore në fushën menaxhimit të bregdetit dhe auditimit e konkretisht: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit";
Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat";
Ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil";
Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";
Ligji nr. 9720 datë 23.04. 2007, i ndryshuar nr. 114/2015, dt. 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik";
Ligji nr. 44/2015, "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë";

Akte nënligjore

VKM nr.
VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil".

Udhëzime, Urdhra dhe Rregullore

- Rregullore e Brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së ;
- Rregullore "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH", miratuar me vendimin nr. ;

Standardet e Auditimit:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë" etj.
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
- Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së, etj..

Akte ligjore:

***7. Standardet e auditimit***

Rregullorja e Brendshme "Mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit", miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015; Rregullorja e Brendshme "Për procedurat e auditimit të KLSH"; Udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016" Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t" (ISSAI), "Standardet e Kontrollit të KLSH", "Manualeve" si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

**8. Metodat e auditimit**

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

-*Metoda e ekzaminimit*: Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe evidencën e veprimeve.

-*Metoda e ekzaminimit kryq*: Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me

një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve**.**

-*Metoda e intervistimit*: Është konsideruar si një nga metodat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patuar përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxheria dhe operacionet gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësisë së audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

-*Metoda e testimit të detajuar*: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

**9.Dokumentimi i auditimit**

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë.

Dokumentimi i Auditimit është bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren "Për Procedurat e Auditimit", miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 107 datë 08.09.2017 si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI).

## II-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

### 1.Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme auditimit të përputhshmërisë se në çfarë mase, subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi.

Auditimi ka përfshirë Mbi hartimin dhe Zbatimin e buxhetit; Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave; Zbatimi i legjislacionit për realizimin e proceduarve të Prokurimit Publik; Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve; Mbi krijimin dhe përditësimin e inventarit kombëtar të zonës bregdetare, bashkëpunimi me strukturat e tjera; Mbi procedurat e ndjekura për dhënien në përdorim dhe administrim të plazheve publike

dhe private; Mbi kryerjen e monitorimeve, inspektimeve, dhe zbatimin e procedurave për shkeljet e konstatuara.
Veprimtaria kryhet në zbatim të: VKM nr. 569, datë 17.07 2019 *"*Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", VKM nr.31, datë 22.01.2014 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit"; VKM nr.171,datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores "*Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"*, i ndryshuar; VKM nr. 730, datë 20.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret tarifat afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese".
**Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:**
**Në zbatim të pikës 1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit .**
Në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit nr. 561/1, datë 30.06.2023, "Mbi auditimin e hartimit dhe zbatimit të Buxhetit
u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
-Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;
-Situacioni i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit';
-PBA dhe buxheti vjetor;
-Raportet e monitorimit;
-Dokumente të bankës etj.
**Në zbatim të pikës 1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit .**
Në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit nr. 561/1, datë 30.06.2023, "Mbi auditimin e hartimit dhe zbatimit të Buxhetit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
-Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;
-Situacioni i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit';
-PBA dhe buxheti vjetor;
-Raportet e monitorimit;
-Dokumente të bankës etj.

- ***Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit për vitin 2021dhe 2022***

***<u>Për vitin 2021</u>***

Informacioni për parashikimin e PBA 2021-2023 nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit për shkak se nuk disponohet as në forme elektronike por as në formë shkresore. Arsyeja sulmi Kibernetike që u bë mbi disa platforma ndër të cilat edhe AKSH-i.
Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, në zbatim të ligjit nr. 115/2021, datë 25.11.2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 8490/1 prot, datë 28.12.2020, me shkresën nr. 60 date 22.01.2021, "Mbi miratimin e buxhetit për shpenzimet kornete për vitet 2021-2023", u miratua çelja e buxhetit për vitin 2021 i cili ka pësuar ndryshime gjatë këtij vitit, ndryshime të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme.

*Në 000/lekë*

| Programi | Tipi shpenzimit | Buxheti Fillestar | Fondi Veçantë | Shtesa Akti Normativ | Pakesime nga Akti Normative | Transferime | Plani me Ndryshime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **04760** | Shpenzime personeli 600 | 38,000,000 | | | 3,300,000 | - | 34,700,000 |
| | Shpenzime personeli 601 | 6,300,000 | | | | - | 6,300,000 |
| | Shpenzime Korrente(602) | 8,000,000 | | | - | - | 8,000,000 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Tranferime(604) | | 130,000 | | - | -100,000 | 30,000 |
| | Shpenzime Kapitale (231) | - | - | 6,000,000 | - | - | 6,000,000 |
| | **TOTAL** | **52,300,000** | **130,000** | **6,000,000** | **3,300,000** | **-100,000** | **55,030,000** |

*Burimi: Sektori i Financës pranë Drejtorisë së Financës dhe e Shërbimeve Mbështetëse në AKB*

Buxheti i akorduar në fillim të vitit 2021 ka pësuar ndryshime gjatë vitit si rezultat i përfitimit të fondeve buxhetore nga VKM, nëpërmjet rishpërndarjeve të fondeve dhe Akteve Normative sipas tabelës më poshtë:
1. çelje nga buxheti - Shkresa nr 60 datë 22.01.2021- Mbi miratimin e buxhetit për shpenzimet kornete për vitet 2021-2023,
2. pakësim fondi te pagave me 2,500,00 - Shkresa nr. 1516 datë 27.08.2021 - Dërgohet miratimi i detaji mit të ndryshimeve sipas Aktit normativ nr. 26, dt. 22.06.2021,
3. pakësim me 100,000 lekë fondi I veçantë i cili rial kohet tek AKZM - Shkresa nr1708 date 28.09.2021-rialokim fondi për vitin 2021,
4. rialokim fondi I veçante nga MTM tek AKB prej 30,000 leke - shkresa nr. 1906 prot, dt. 03.11.2021 Rialokim fondi për vitin 2021,
5. pakësim i fondeve te lira te llog. 600 për vlerën 800,000 - Shkresa nr 8808/2 date 17.12.2021 Dërgohet miratimi i detaji mit te ndryshimeve sipas aktit normativ nr. 34, dt. 03.12.2021,
6. shtim fondesh për pagesat e projekteve te huaja, kosto lokale - shkresa nr 8808/3 date 20.12.2021-Ne zbatim te aktit normativ nr. 34, dt. 03.12.2021,
7. çelje nga buxheti - Shkresa nr. 204, dt. 29.03.2021- Detaj imi i fondit te veçante për vitin 2021.

***<u>Për vitin 2022</u>***

Informacioni për parashikimin e PBA 2022-2024 nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit për shkak se nuk disponohet as në forme elektronike por as në formë shkresore. Arsyeja sulmi Kibernetike që u bë mbi disa platforma ndër të cilat edhe AKSH-i.
Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, në zbatim të ligjit nr. 115/2021, datë 25.11.2021, "Për buxhetin e vitit 2022", u miratua çelja e buxhetit për vitin 2022 i cili ka pësuar ndryshime gjatë këtij vitit, ndryshime të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

*Në lekë*

| Programi | Tipi shpenzimit | Buxheti Fillestar | Fondi Veçantë | Shtesa Akti Normativ | Pakësimi nga Akti Normative | Transferime | Plani me Ndryshime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **04760** | Shpenzime personeli 600 | 38,000,000 | | | 1,850,000 | 2,300,000 | 38,450,000 |
| | Shpenzime personeli 601 | 6,300,000 | | | 136,000 | 200,000 | 6,364,000 |
| | Shpenzime Korrente | 9,500,000 | | 700,000 | - | - | 10,200,000 |
| | Shpenzime Korrente Pastrimi i bashkive bregdetare | 205,000,000 | | | 101,300,000 | | 103,700,000 |
| | Tranferime(604) | | 160,000 | | - | 1,000,000 | 1,160,000 |
| | Shpenzime Kapitale | 22,500,000 | - | | 20,500,000 | - | 2,000,000 |
| | **TOTAL** | **258,800,000** | **160,000** | **700,000** | **103,286,000** | **3,500,000** | **161,874,000** |

*Burimi: Sektori i Financës pranë Drejtorisë së Financës dhe e Shërbimeve Mbështetëse në AKB*

Buxheti i akorduar në fillim të vitit 2021 ka pësuar ndryshime gjatë vitit si rezultat i përfitimit të fondeve buxhetore nga VKM, nëpërmjet rishpërndarjeve të fondeve dhe Akteve Normative sipas tabelës më poshtë:

1. çelje nga buxheti - Shkresa nr. 63 datë 24.01.2022 - Detaj imi I buxhetit te shpenzimeve korrente për vitet 2022-2024,
2. çelje nga buxheti - Shkresa nr. 137 datë 10.02.2022 - Detaj imi i fondit te veçante për vitin 2022,
3. çelje nga buxheti – Shkresa nr. 262 datë 08.03.2022 -Dërgohet detaji mi i buxhetit 2022-2024 për shpenzimet kapitale,
4. Pakësim fondi i pagave prej 850,000 dhe fondi i sigurimeve prej 136,000 - Shkresa 356 datë 05.04.2022 -Miratimi i detaji mit të ndryshimeve sipas aktit Normativ nr. 3, dt. 12.03.2022,
5. transferim i fondit te sinjali stikës prej 10,000,000 për projektin REGLPORTS tek AKB për 2,500,000 dhe diferenca tjetër tek AMT - shkresa nr. 397 datë 12.04.2022- Transferim fondi për shpenzime kapitale,
6. pakësohet fondi për sinjali stikën me 10,000,000 - Shkresa nr. 638 datë 05.05.2022- Në zbatim të aktit normativ nr. 3, dt. 12.03.2022.
7. pakësohet fondi i pagave me 1,000,000 dhe shtohet fondi 602 me 700,000. Gjithashtu, pakësohet fondi i pastrimit me 101,300,000 - Shkresa 2307 date 14.09.2022 -Miratimi i detaji mit të ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr. 12, dt. 14.09.2022.
8. Transferohet fondi 2,300,000 nga llog.600 dhe fondi 200,00 nga llogaria. 601 nga AKT tek AKB pasi nuk ka pasur fonde te mjaftueshme për pagat e muajit nëntor 2022 - Shkresa nr. 2948/1 dt. 21.11.2022-Mbi kërkesën për shtese fondit te pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për muajin Nëntor 2022.
9. Akt Normativ - Shkresa nr. 3215 datë 28.12.2022 - Miratimi i detaji mit të ndryshimeve të shpenzimeve kapitale sipas Aktit Normativ nr. 17, dt. 01.12.2022.
10. shtesë fondi 606 prej 1,000,000 - VKM nr. 898, dt. 29.12.2022 "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve".

Në tabelën e mëposhtme paraqesim realizimin e buxhetit edhe në përqindje për periudhën 2021-2022 sipas artikujve buxhetorë për institucionin e AKB-së.

*Në lekë*

| **Artikulli** | **Viti 2021** | | | **Viti 2022** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Plan** | **Fakt** | **%** | **Plan** | **Fakt** | **%** |
| 600 | 34,700,000 | 32,665,633 | 94 | 38,450,000 | 38,219,745 | 99 |
| 601 | 6,300,000 | 5,288,902 | 84 | 6,364,000 | 6,311,872 | 99 |
| 602 | 8,000,000 | 7,564,524 | 95 | 113,900,000 | 113,776,380 | 100 |
| 606 | 30,000 | 30,000 | 100 | 1,160,000 | 1,069,700 | 92 |
| 231 | 6,000,000 | 5,321,549 | 89 | 2,000,000 | 1,985,838 | 99 |
| **Totali** | **55,030,000** | **50,870,608** | **92.4** | **161,874,000** | **161,363,535** | **99.7** |

*Burimi: Sektori i Financës pranë Drejtorisë së Financës dhe e Shërbimeve Mbështetëse në AKB*

Siç vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se, buxheti në total;
- për vitin 2021 është realizuar në masën **50,870,608 lekë** ose rreth 92,4 % e planit të 12-mujorit të vitit 2021 që ishte **55,030,000 lekë**.
- për vitin 2022 është realizuar në masën **161,363,535 lekë** ose rreth 99,7 % e planit të 12-mujorit të vitit 2022 që ishte **161,874,000 lekë**.

Gjithashtu konstatohet një diferencë ndërmjet planifikimit të buxhetit për vitin 2021 dhe vitit 2022.
Kjo diferencë vjen për arsye se në vitin 2022, AKB, me VKM nr. 804, datë 20.12.2021, " Për disa shtesa në VKM nr. 569, datë 17.07.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", të ndryshuar, lidhi kontratë për shërbimin e pastrimit në zonat bregdetare të bashkive Durrës, Kavaje, Sarandë dhe Himarë me vlerë të fondit limit në procedurën e Prokurimit **91,557,753.00 lekë.**

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetje** | Mbajtja e informacionit jo vetëm në formë elektronike por edhe në formë shkresore |
| **Situata:** | Informacioni për parashikimin e PBA 2021-2023 nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit për shkak se nuk disponohet as në forme elektronike por as në formë shkresore. Arsyeja sulmi Kibernetik që u bë mbi disa platforma ndër të cilat edhe AKSH-i.<br>Informacioni për parashikimin e PBA 2022-2024 nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit për shkak se nuk disponohet as në forme elektronike por as në formë shkresore. Arsyeja sulmi Kibernetik që u bë mbi disa platforma ndër të cilat edhe AKSH-i.<br>Sa më sipër ky informacion nuk disponohet nga AKB. |
| **Kriteri:** | - Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", i ndryshuar, neni nr. 43.<br>- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, neni nr. 17. |
| **Ndikimi/Efekti** | Mos mbajtja e informacionit në formë shkresore sjell mungesën e tij në situata të ndryshme edhe pse ai mund të disponohet edhe në formë elektronike. |
| **Shkaku** | Mos mbajtja e informacionit në formë shkresore por mbajtja e tij vetëm në formë elektronike. |
| **Rëndësia** | E Mesme. |
| **Rekomandim** | Agjencia Kombëtarë Bregdetit të marrë masa që të gjitha dokumentet të përpilohen dhe të mbahen jo vetëm në formë elektronike por edhe në formë shkresore si dhe të protokollohen dhe arkivohen. |

**<u>Raportet e monitorimit</u>**

Nga auditimi gjithashtu u konstatua se për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, rezulton se AKB nuk ka hartuar dhe dorëzuar raportimet 4 mujore të monitorimit të buxhetit, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në kundërshtim me nenin 65 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" si dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", kapitulli VI "Raportet e Monitorimit" pika 270 që thotë" Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore, duhet të paraqesin raportet e monitorimit tek Nëpunësi i Parë Autorizues, deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katër mujorit dhe konkretisht deri në 30 Maj, 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të ardhshëm, sipas të dhënave përfundimtare, pas rakordimeve me Ministrinë përgjegjëse për Financat".

Për vitin buxhetor 2022, ky raportim është kryer brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj. Pra;

- Raporti monitorimit për 4-mujorin I të vitit 2022 është hartuar dhe dorëzuar brenda muajit shkurt të vitit 2022,
- Raporti monitorimit për 8-mujorin e vitit 2022 është hartuar dhe dorëzuar brenda muajit shtator të vitit 2022,
- Raporti monitorimit për 12-mujorin e vitit 2022 është hartuar dhe dorëzuar brenda muajit shkurt të vitit 2023.

***<u>Pretendimi i subjektit:</u>***

*Subjekti me anë të observacionit protokolluar me tonën 561/1prot, datë 05.10.2023, ka dërguar raportin e monitorimit të PBA për vitin 2021.*

***<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>***
*Grupi i auditimit është shprehur edhe në Akt Konstatim se për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, rezulton se AKB nuk ka hartuar dhe dorëzuar raportimet 4 mujore të monitorimit të buxhetit, pranë Ministrisë së Turizmit dhe mjedisit, në kundërshtim me nenin 65 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" si dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", kapitulli VI "Raportet e Monitorimit" pika 270 që thotë" Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore, duhet të paraqesin raportet e monitorimit tek Nëpunësi i Parë Autorizues, deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katër mujorit dhe konkretisht deri në 30 Maj, 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të ardhshëm, sipas të dhënave përfundimtare, pas rakordimeve me Ministrinë përgjegjëse për Financat".*
*Gjithashtu grupi i auditimit është shprehur se për vitin buxhetor 2022, ky raportim është kryer brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj.*

**Në zbatim të pikës 2 . Zbatimi i legjislacionit për realizimin e proceduarve të Prokurimit Publik;**
U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentacioni elektronik në faqen e APP;
- Kontratat e lidhura për shërbimet e pastrimit të zonës bregdetare

- **Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.**

Nga auditimi ka rezultuar se, është hartuar regjistri i parashikimeve dhe i realizimit për vitet objekt auditimi.
Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi. Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pikësimeve është dërguar regjistri përkatës. NJP dhe NZ, kanë vepruar në përputhje me VKM, nenin 4 "Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik", pika 1, ku cilësohet: "Në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime, AK është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së".
Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 914, neni 4 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar.

- ***Auditim mbi saktësinë e riaplikimit të procedure të procurement (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).***

Për auditimin e kësaj nën çështjeje u verifikuan: Dosjet e procedurave; Përcaktimi i kritereve të vlerësimit; Hartimi i DT; dokumentacioni ligjor dhe administrativ në SPE, lidhja e kontratave, etj.

- **Mbi administrimin e dosjeve nga NJP:** Nga Grupi i auditimit u shqyrtua i gjithë dokumentacioni i ndodhur në dosjen e prokurimit për të gjitha procedurat e audituara, nga ku rezultoi se: Në përgjithësi nga NJP, janë zbatuar të gjitha detyrat e përcaktuara, si: përgatitja e regjistrave të prokurimit; përzgjedhja e llojit të procedurës, hartimi urdhrit të prokurimit; përgatitja e DT, plotësimi i gjithë dokumenteve standarde për t'u plotësuar nga AK, ka administruar të gjitha procesverbalet e mbajtura gjatë zhvillimit të procedurës; ka respektuar afatet e procedurës, ka administruar dokumentacionin e OE fitues, ka shqyrtuar të gjitha rekomandimet e APP-së, mbi kriteret kualifikuese, sipas vërejtjeve të saj gjatë monitorimit të

procedurave, etj. Nga ana e juristit të NJP janë administruar dhe inventarizuar të gjitha dosjet e prokurimit. Pjesë e dosjeve ishte i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas akteve ligjore, nënligjore dhe DST.

- **Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik:**

Nga ana e AK gjatë periudhës objekt auditimi2021-2022, ka zhvilluar një procedurë prokurimi.

Në mënyrë nominale procedurat e audituara janë në Aneks nr, bashkëlidhur.
Sipas riskut dhe materiali tetit bazuar në llojin e procedurave për gjithë vitet objekt auditimi, është audituar **100%** të fondit limit.

Nga auditimi i procedurës rezultuar se **ka fituar vlera më e ulët e vlefshme e paraqitur në procedurën e prokurimit si dhe ulja nga fondi limit është në masën 5.7%.**
Ndërkohë që për periudhën objekt auditimi nga procedurat e audituara ka rezultuar një pjesëmarrje e 2OE prej së cilëve **janë s'kualifikua 1 prej tyre.**

*Tabela analitike "Mbi procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga AK, UMT dhe të audituara nga grupi i auditimit të KLSH:*

| Viti | Numër procedurash | Fondi limit | Operatorë Ekonomikë | | Vlerae ofertës fituese | Diferenca nga fondi limit | Audituar nga KLSH | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | pjesëm arrës | të skualifi kuar | | | Numër | Vlerë |
| **2021** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **2022** | 1 | 91,557,753 | 2 | 1 | 86,411,340 | 5,146,413 | 1 | 86,411,340 |

Baza ligjore mbi të cilën ka nisur kjo procedurë nga AKB.
Me shkresës me nr. 547, datë 21.1.2022 "Detaj imin i buxhetit të shpenzimeve kornete për vitet 2022-2024 fondi i alokuara me kodin 92603AF, në vlerën *205,000,000* lekë, me tvsh dhe pa tvsh *170,833,333* lekë me objekt; Bashkitë të mbështetura për pastrimin e Bregdetit. Ky fond është miratuar nga Ministria e Financave.
Në bashkëpunim me institucione të tjera, ministria përgjegjëse për Mjedisin është institucioni përgjegjës; Së bashku me institucionet e tjera vartëse, si dhe marrëveshje e bëra midis AKB dhe Bashkive përkatëse.

| Nr.rendor | Marrëveshja | Nr. prot, datë | Shërbimi | Periudha |
|---|---|---|---|---|
| 1. | AKB-Bashkia Durrës | Nr.1254, 16datë 8.2.2022 | Për Sigurimin e Shërbimit të Pastrimit të 16zonës Bregdetare të Bashkisë Durrës gjatë sezonit Turistik | 15-Qershor 2022 -15 Shtator2022 |
| 2. | AKB- Bashkia Kavajë | Nr.507 , datë 8.2.2022 | Për Sigurimin e Shërbimit të Pastrimit të zonës bregdetare të bashkisë Kavajë gjatë sezonit Turistik | 15-Qershor 2022 -15 Shtator2022 |
| 3. | AKB-Bashkia Himarë, | Nr.663 , datë 8.02.2022 | Për Sigurimin e Shërbimit të Pastrimit të zonës bregdetare të bashkisë Himarë gjatë sezonit Turistik | 15-Qershor 2022 -15 Shtator2022 |
| 4. | AKB-Bashkia Sarandë | Nr.513 , datë 8.02.2022 | Për Sigurimin e Shërbimit të Pastrimit të zonës bregdetare të bashkisë Sarandë gjatë sezonit Turistik | 15-Qershor 2022 -15 Shtator2022 |

*Punoi : Grupi i Auditimit*

***-Auditimi mbi argumentimin e fondit Limit.***

Për justifikimin/argumentimin e fondit limit të aprovuar nga Ministria e Financave, nga AKB, nuk kishin të parashikuar në.(Fisha e proj),këto shërbim, kjo në kundërshtim me **ligj nr. 115/2021 "për buxhetin e vitit 2022"** nenin 44 të ligjit nr. 9636, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për rishpërndarjen e fondeve buxhetore përcaktojnë treguesit e faktit në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11 të këtij ligji ,nga nëpunësi zbatues .
Me datë 04.04.2023, nëpërmes Memo Komisioni i Blerjeve të vogla, ka bërë propozimi për një ekspert të jashtëm për llogaritjen e fondit limit pasi pretendon se nuk kanë të mundur për specifiken qe ka shërbimi për llogaritjen e fondit.
Lidhur me propozimin e bërë nga Grupi i Komisionit të Blerjeve të vogla, AK nuk ka propozuar dhe analizuar asnjë kandidat nëpërmes prokurimit me vlerë të vogël, për ta kryer shërbimin e studimit për fondin limit dhe termat e Referencës për objektin e prokurimit, por ka kontraktuar ekspert te licencuar në fushen e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe si bazë ligjorë për kontraktimin e ekspertit ka referuar në mbështetje ligjore VKM-në 720, datë 29.11.1995"Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera shtetërore". E cila rezulton të jetë finalizuar nëpërmjet kontratës nr. 358, datë 05.04.2022 "Për përgatitjen e dokumentacionit tekniko ekonomik për shërbimin e pastrimit të zonës Bregdetare për 4 Bashkitë; Durrës, Kavajë, Himarë dhe Sarandë përgjatë sezonit turistik 15 qershor -15 shtator 2022". Lidhur me procedurën e përzgjedhjes, kontraktimit dhe pagesës për ekspertin që ka kryer shërbimin. Për përgatitjen e dokumentacionit tekniko ekonomik për shërbimin e pastrimit të zonës Bregdetare për 4 Bashkitë; Durrës, Kavajë, Himarë dhe Sarandë përgjatë sezonit turistik 15 qershor -15 shtator 2022, u evidentua sa më poshtë vijon;
Nga auditimi rezultoi se eksperti i zgjedhur është punonjës pranë Bashkisë Tiranë dhe si i tillë nuk mund të lidhë kontratë punësimi vetëm nëse do të ishte në kushtet VKM-së **Nr. 1703, datë 24.12.2008 "**për **vendosjen e standardeve te shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale /te përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore".**
Në nenin 3 "Detyrat e punëmarrësit", pika 1 e kontratës citohet që" punëmarrësi të punësohet si ***ekspert i jashtëm*** me eksperiencë në zbatimin e VKM-së nr. 319, datë 31.5.2018 "Për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve" dhe janë renditur kërkesat sipas memos se kërkuar nga komisioni i hartimit të dokumenteve.
Nga natyra e objektit të veprimtarisë, kjo është një kontratë shërbimi e cila duhet ti nënshtrohej rregullave të prokurimit publik udhëzimi nr.5 datë 25.06.20211 "Për blerjet me vlera të vogla dhe zhvillimi nëpërmes sistemit elektronik" dhe jo të përjashtohej nga këto rregulla. Kjo referuar dhe pikës 5, të VKM-së **Nr. 1 703, date 24.12.2008 "**për **vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale /te përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore" ku citohet;** Për efekt të këtij vendimi, nuk do të konsiderohen dhe trajtohen si punonjës me kontratë, ekspertet e fushave të ndryshme të licencuar. Shërbimi i ofruar prej tyre i nënshtrohet procedurave përkatëse të prokurimit publik apo akteve te veçanta ligjore në fuqi. Duke ju referuar Ne nenin 3 " Detyrat e punëmarrësit", pika 1 e kontratës citohet që" punëmarrësi të punësohet si ***ekspert i jashtëm*** me eksperiencë në zbatimin e VKM-së nr. 319, datë 31.5.2018 "Për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve" dhe janë renditur kërkesat sipas memos se kërkuar nga grupi I KHD-së. Ndërkohe lidhur me pagesën e punëmarrësit I referoheni nenit 7 të kontratës ku citohet se; punëmarrësi do të marrë si shpërblim dy paga mujore sa paga që merr specialist i prokurimeve në sektorin e financës, Buxhetit dhe prokurimeve ne AKB, kategoria IV–a, kjo do të ishte e mundur vetëm për punonjësit në organike që ndërmarrin aktivitete jashtë institucionit por jo për ekspertët që sjellin një shërbim të specializuar, gjithashtu në kontratë nuk është përcaktuar koha e kryerjes

së kësaj ekspertize, shërbimi.. Specifikojmë që kontrata lidhet për një shërbim ekspertize të jashtme dhe pagesa trajtohet si shpërblim punonjësi.
Si përfundim:
Kontrata punësimi me kohë të pjesshme duhet të aprovohet sipas VKM-së *Nr. 1 703, datë 24.12.2008 "për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale /të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore si dhe shpërblimi i punonjësve bëhet për punonjësit e miratuar në organike me Urdhër të Kryeministrit dhe me procedurat e statusit të nëpunësit civil.*
Kontrata e lidhur me ekspertin e fushës nga Drejtori i Përgjithshëm i AKB, nuk përmbush kriteret e trajtuara më lart.
-Lidhur me procedurën e nënshkrimit të kësaj kontrate nuk u evidentua që nga AK të ketë një korrespondencë zyrtare komunikimi me ekspertin e fushës, i cili është Ekspert i Fushës dhe Përgjegjës i sektorit të Menaxhimit dhe mbetjeve të integruara pranë Bashkisë Tiranë , por është ekspert i certifikuar për këto fushë.
-nuk është kryer përzgjedhja sipas përcaktimeve të përshkruara me lartë, grupit të auditimit ju vu në dispozicion kontrata dhe produkti i dorëzuar prej tij ne nr, 358/2, datë 11.4.2022 " dërgimi i dokumentacionit tekniko ekonomik për kryerjen e shërbimit të pastrimit të Zonës Bregdetare për 4 Bashkitë Durrës, Kavajë, Himarë dhe Sarandë për sezonin turistik 15 qershor -15 shtator 2022.
Pagesa e ekspertit është bërë për shumën 117,572 lekë, në urdhër shpenzimin nr. 17.5.2022 nga llogaria ekonomike 602.
-Eksperti i kontraktuar ka depozituar shkresën nr .358/2 datë 11.04.2022 me lëndë ;Dërgim dokumentacioni tekniko-ekonomik për kryerjen e shërbimit të Pastrimit të Zonës Bregdetare
-Me urdhrin nr. 48 prot nr. 358/1datë 08.04.2022,është ngrit Komisioni për marrjen në dorëzim të shërbimit të ekspertizës së jashtme të kontraktuar me nr 358, datë 05.04.2022 "Për përgatitjen e dokumentacionit tekniko ekonomik për shërbimin e pastrimit të zonës Bregdetare përgjatë sezonit turistik 15 qershor -15 shtator 2022", rezulton I përbërë nga tre anëtarë si më poshtë vijon:

1. D. S.
2. E. D.
3. E. Rr.

Komisioni i marrjes në dozim të shërbimit të ekspertit ka nënshkruar proces verbalin e marrjes në dorëzim pa asnjë oponencë apo kërkesë për sqarim ndaj raportit të dorëzuar me nr. Prot 358/2 datë 11.4.2022 . Duket që materiali i dorëzuar është pranuar brenda ditës në datën e dorëzimit dhe Komisioni ka marrë të mirëqenë të padiskutueshme çdo të dhënë të dorëzuar nga eksperti.
- Nga auditimi i dokumentacionit të punuar nga i Ekspertit për dokumentacioni tekniko-ekonomik për kryerjen e shërbimit të Pastrimit të Zonës u kërkua baza e të dhënave teknike të përdorura si referenca në raport nga të cilat janë bërë llogaritje nga ku janë përcaktuar:
1. Numër të punonjësve për çdo shërbim pastrimi.
2. Numër i automjeteve teknologjike të transportit të mbetjeve urbane,
3. Përcaktimi i numrit të punëtorëve të procesit të shërbimit të larjes dhe dezinfektimin të kontejnerëve të mbetjeve urbane si dhe mjetet dhe pajisjet për të domosdoshme për realizimin e tij.

Eksperti ka referuar mbi metodologjinë që ka përdorur për kryerjen e llogaritjes si dhe miratimit të numrit të popullsisë bashkëlidhur VKM –së,804 datë 20.12.2021Për disa shtesa

në vendim nr 569 "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKB së," për pastrimin e vijës bregdetare si të dhënave të miratuara nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit.
Në pikën e parë të metodologjisë është "Të dhëna të përgjithshme nga Njësitë e Qeverisjes Vendore", por në fakt bashkëlidhur me materialin nuk kishte asnjë të dhënë dhe asnjë burim të dhënash nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.
Kostoja operative, kostoja e amortizimit dhe ajo e administrimit janë llogaritur në zbatim të VKM-së 319, datë 31.5.2018 "Për miratimin e masave për koston e Menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane".

Eksperti në dokument të vënë në dispozicion nuk i është referuar si burim të dhënash Vendimit nr. 687, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", si dhe shtojcës 4 të këtij vendimi "Metodologjia për grumbullimin, gjenerimin dhe përpunimin e të dhënave për menaxhimin e mbetjeve".
Në metodologjinë përcaktohet se si bëhet llogaritja e;

1. numrit të popullsisë,
2. sasisë së mbetjeve të prodhuara për person,
3. llogaritja e normës së gjenerimit përmes peshës së kamionëve
4. llogaritja e normës së gjenerimit duke përdorur koeficientet e PKSMM-norma e gjenerimit II.

Nisur nga faktet e parashtruara më lart të dhënat teknike të përdorura nga shërbimi i ekspertit nuk kanë një shpjegim teknik të qartësuar AK dhe aktorët e tjerë që monitorojnë produktin e tij. Nga këto të dhëna vijon llogaritja dhe përcaktimi i treguesve më kryesorë për vijimin e përcaktimit të fondit limit si dhe të kushteve e specifikimeve teknike të tenderit të cilat janë përdorur me tej në vijim të procedurës nga KHD.

| **Titulli i gjetje** | *Përzgjedhja e Ekspertit* |
|---|---|
| **Situata:** | - Nga auditimi u konstatua se , në procedurën e prokurimit të kontratës së shërbimit me objekt; ''Pastrimi i zonës bregdetare për Bashkitë Durrës , Sarandë Kavajë dhe Himarë". Përzgjedhja e ekspertit të jashtëm për kryerjen e justifikimit të fondit limit nuk i është nënshtruar procedurave të konkurrimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5 datë 25.06.20211"Për blerjet me vlera të vogla dhe zhvillimi nëpërmes sistemit elektronik" por përzgjedhja e tij është bërë drejtpërdrejt me një kontratë të përkohshme pune. |
| **Kriteri:** | VKM Nr.1703, date 24.12.2008 "Për vendosjen e standardeve te shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale /te përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore", Udhëzimin nr.5 datë 25.06.20211 "Për blerjet me vlera të vogla dhe zhvillimi nëpërmes sistemit elektronik" . |
| **Ndikimi/Efekti** | Shmangie prokurimit blerje me vlera të vogël. |
| **Shkaku** | Mungese stafi të fushës për të cilën është kryer përzgjedhja |
| **Rëndësia** | E Mesme. |
| **Rekomandim** | Agjencia Kombëtare të Bregdetit, të marrë masa për zbatimin e procedurave të prokurimit publik në përzgjedhjen e ekspertëve të jashtëm. |

*Të dhënat për procedurën e Prokurimit:*

***Nga auditimi i audituar mbi procedurën e prokurimit*** *"'Pastrimi i zonës bregdetare për Bashkitë Durrës , Sarandë Kavajë dhe Himarë".*
*Nga auditimi i procedurës në vlerësim dhe marrjen në dorëzim nuk janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore pasi tenderi është vlerësuar sipas dokumenteve standarde /kërkesave të vendosura nga njësia e hartimit te dokumenteve.*
*Marrja ne dorëzim e shërbimit është bërë sipas kontratës dhe grupit të punës të ngritur nga titullari i institucionit* Urdhri nr/prot. 101, datë 13.6.2022, nr/prot,1195/1, datë 13.6.2022, "Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e ecurisë së zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim të shërbimit te kryer'', për çdo bashki,
-Procesverbalet e mbajtura për çdo ditë me nr datë
-Grafikët e shërbimit grafikët e shërbimit për objektin "protokolluar në AKB rast pas rasti
-Raporti përmbledh, nr/prot.

***Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Pastrimi i zonës bregdetare për Bashkitë Durrës , Sarandë Kavajë dhe Himarë".***

| **1.Urdhër Prokurimi** | **2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:** | **3.KomisioniVlerësimit Ofertave:** |
|---|---|---|
| Nr. 25, datë 11.03.2022 | 1.G.A. Drejtor DPMIZB, AKB<br>2.B. K., Personi përgjegjës per prokurimet AKB<br>3.Sh. M., Specialiste e fushes Ministria e Turizmit dhe Mjedisit | Urdhër nr.26, date 11.03.2022<br>1.E. M. (Kryetar)<br>2.G. T. (Anëtar)<br>3. E. R. Drejtore MTM (Anetar) |
| Ndryshuar ne urdhrin me nr. 34, date 25.3.2023 | Zëvendësohet anëtare e komisionit B. K. me z, S. J., Drejtor Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. | |
| Urdhrin me nr. 49, date 12.4.2022 | Fondi Limit 91, 557,753 leke, pa tvsh | |
| | Proces verbal për miratimin e kritereve dhe kualifikimin e proced ures "Shërbim", me mjete elektronike, "Shërbim pastrimi I zonës Bregdetare, për bashkitë Durrës, Sarandë, Kavajë, Himarë. | |
| **4.Lloji i Procedurës së Prokurimit: e hapur, mbi kufirin monetarë** | **6.Oferta fituese: F. Shpk nipt J..S me vlere** 86,411,340 lekë pa Tvsh dhe 103,693,608 lekë me tvsh, kontrata nr 1195, datë 13.6.2022. | **7. Diferenca me fondin limit** 5,146,413 lekë (pa Tvsh) |
| 5. **Fondi Limit (pa Tvsh)** 91,557,753lekë pa Tvsh | | |
| **8.Dorëzimi I ofertave:** A. shpk 12.5.2022 ora 12:32 F. Shpk datë 12.5.2022, ora 9:36 | **9.Burimi Financimit:** Buxheti i Shtetit | **10. Operatorët Ekonomikë**<br>a)Pjesëmarrës në tender: **2**<br>b) S'kualifikuar : **1** |
| **11.Ankimime AK. Ska** | **12. Përgjigje ankesës nga AK. Ska** | **13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP** ska. |

Lidhur me llogaritjen e kostove financiare u evidentuan si më poshtë vijon:
-Referuar shkresës nr. 1179 datë 15.10.20211 ,të miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, e cila ka marrë si bazë kapacitetet e pushuesve të plazheve sipas Vendimit nr.2

datë 28.07.2020 "'Të Këshillit Kombëtare të Territorit" *Për përcaktimin e zonës me përparësi zhvillimi e turizmit dhe miratimin hartës së aktiviteteve*"

Analiza e kostove financiare rezulton të jetë bërë për:

1. Numrin e popullsisë,
2. Sasisë së mbetjeve të prodhuara për person,
3. Llogaritja e normës së gjenerimit përmes peshës së kamionëve
4. llogaritja e normës së gjenerimit duke përdorur koeficientet e PKSMM-norma e gjenerimit II.

Janë bërë parashikimet për Mjetet që do të përdoren dhe punëtorët që janë si më poshtë vijon: Parashikimet janë bërë nga ekspert duke u bazuar ne numrin e pushuesve ku mbi këto bazë janë llogaritur dhe mbetjet që do gjëndërohen. Konkretisht me shkresën nr.1799 datë 15.10.2021.Të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Pastrimi i zonës Bregdetare pastrimin e zonës ranore duke marre si bazë kapacitetin pushues të plazheve , bazuar në vendimin nr.2 datë 28.07.2020,të Këshillit Kombëtare të Territorit pika 1.'Për përcaktimin e zonës me përparësi zhvillimin e turizmit detare dhe hartës së aktiviteteve'. Pika 2. që zona që do pastrohet të përfshijë strukturat Akomoduese ku merret parasysh de kapaciteti i tyre për secilën zonë duke i shtuar kapacitete si zonë ranore të plazhit bashkëlidhur tabela me të dhëna sipas zonave .

| | **Saranda** | **Himara** | **Kavaja** | **Durrës** | **Total** |
|---|---|---|---|---|---|
| Kamionë 10 ton | 3 | 3 | 3 | 6 | 15 |
| Kamionë 7 ton | 1 | | | | 1 |
| Makineri pompe speciale | 1 | | 1 | | 2 |
| Numër total Mjete | | | | | |
| **Total Mjete** | | | | | **18** |
| Shofer makine teknologjike | 6 | 3 | 9 | 12 | 30 |
| Punëtor transporti | 12 | 6 | 27 | 34 | 79 |
| Punëtor fshese | 14 | 15 | 6 | 13 | 48 |
| Shofere për makinat e larjes | 1 | | 1 | | 2 |
| Punëtor larje kazanësh | 1 | | 1 | | 2 |
| **Numër total Punëtorësh** | | | | | **161** |

Në lidhje me automjetet janë llogaritur kosto për mirëmbajtjen e tyre, amortizimin dhe taksat, gjithashtu është bërë llogaritja e kostos për shpenzimet e karburantit gjatë mbushjes dhe transportit të mbeturinave. Gjatë auditimit rezultoi se çmimi për litër i karburantit është përdorur në vlerën 183.8 leke për litër, ndërkohë u be procesi i rivlerësimin e çmimit si në tabelën më poshtë ku rezulton të jetë 177.91. Diferenca e vlerësuar nga çmimi i rezultuar ne fakt është në vlerën 206,150 lekë duke ju referuar sasisë së litrave të planifikuara për procesin e mbledhjes dhe transportimit.

**Në tabelën më poshtë është dhënë llogaritja e çmimit të karburantit**

| | PERLLOGARITJA E CMIMIT TE KARBURANTIT<br>Perllogaritja e cmimit te karburantit gazoil 10 ppm | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Emertimi | Cmimi $/Ton | Kursi (dt.7.4.2022) | Vlera Lek/Ton | Vlera Lek/Kg | Densiteti | Vlera Lek/all |
| 1 | BURSA (sipas buletinit datë 07 Prill 2022 Referuar Burses date 7.4.2022 | 1026 | 111.53 | 114,429.78 | 114.43 | | |
| 2 | Premio | 30 | 111.53 | 3,345.90 | 3.35 | | |
| | CMIMI I BLERJES | | | | 117.78 | 0.8412 | 99.07 |
| a | AKCIZA | | | | | | 38.221 |
| b | TAKSE KARBONI | | | | | | 3 |
| c | TAKSE QARKULLIMI | | | | | | 27 |
| | TAKSE markimi Karburanti | | | | | | 0.614 |
| d | MARZHI I FITIMIT | | | | | 10.00% | 10 |
| SHUMA | | | | | | | 177.91 |
| TVSH | | | | | | | 35.58 |
| CMIMI ME TVSH | | | | | | | 213.49 |

Për llogaritjen e kostove për punëtorët është përdorur paga minimale sipas Vendimit nr. 158 datë 12.03.2022 "Për Përcaktimin e pagës në Shkalle Vendi" për detyrimet e punëdhënësit në masën 16.7%. Për pagën e shoferëve të kamionëve paga bazë është përdorur ne vlerën 51,406 lekë.

***-Vlerësimi i tenderit pas hartimit të fondit limit***

Në zbatim të Urdhrit të Prokurimit nr.25, datë 11.03.2022, i ndryshuar, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për procedurën e prokurimit "Procedure e hapur shërbimi mbi kufirin e lartë monetar", me mjete elektronike, me objekt "Shërbim Pastrimi i Zonës Bregdetare, për Bashkitë Durrës, Sarandë, Kavajë, Himarë", me fond limit 91,557,753 (nëntëdhjetë e një milion e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) leke pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit dhe Urdhrit të Titullarit të Autoritetit Kontraktor me Nr. 26, datë 11.03.2022 "Për Ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave", i ndryshuar, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me prezencën e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, në datë 13.05.2022, ora 11:00, kanë realizuar fazën e shqyrtimit të ofertave të operatorëve ekonomik që kanë shprehur interes për këtë procedurë.
Në datën 13.05.2022, në orën 11:00, me mjete elektronike është bërë hapja e ofertave. Në listën e shfaqur nga hapja elektronike figuronin emrat e operatorëve si më poshtë:

| Nr | Emri i ofertuesit ekonomik | NIPT |
|---|---|---|
| 1. | "A.-I. G. C." SH.P.K. | K. |
| 2. | "F." SH.P.K. | J. |

Nëpërmjet sistemit elektronik u evidentuan ofertat ekonomike të operatorëve si më poshtë:

| Nr | Emri i ofertuesit ekonomik | Vlera (lekë) pa TVSH |
|---|---|---|
| 1. | "A.-I. G. C." SH.P.K. | 89,792,100.00 |
| 2. | "F." SH.P.K. | 86,411,340.00 |

Në zbatim të nenit në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162, datë 23.12.*2020 "Për Prokurimin Publik",* të nenit 80 dhe të nenit 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, KVO ka verifikuar dhe vlerësuar ofertat e dorëzuara, KVO, me unanimit ka vendosur për sa më poshtë vijon;
**Ka s'kualifikoje Operatorin Ekonomik "A.-I. G. C." sh.p.k. me NIPT K....I**, i cili nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor .

**1. Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/kualifikimit**

**2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas Shtojcës 8,** konkretisht**: Kritere të veçanta të kualifikimit,** germa b)**, Pika 2.3 Për kapacitetin Teknik,** pika 2.3.1, pika 2.3.3, pika 2.3.5, pika 2.3.7, pika 2.3.8,
Në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për Prokurimin Publik”,* nenit 47, nenit 75 dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar, si dhe dokumentet e tenderit të miratuara, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vendosur që oferta është e shkualifikuar dhe nuk pranohet pasi nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të dokumenteve të tenderit.

**Të kualifikoje Operatorin Ekonomik “F.” SH.P.K., me NIPT J..S**, i cili plotëson të gjitha kriteret: **1. kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit dhe 2. kriteret e veçanta të kualifikimit,** sipas **Shtojcës 8** të DST-ve.
Në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për Prokurimin Publik”* dhe neni 47, nenit 75, dhe neni 82, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,* të ndryshuar, si dhe dokumenteve të tenderit të miratuara, Komisioni ka vendosur se oferta është e **kualifikuar** dhe pranohet, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka verifikuar dhe pranuar se Operatori Ekonomik, disponon kualifikimet e nevojshme ekonomike, ligjore, teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, përvojën e duhur, besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm në funksion të realizimit me sukses të kontratës së objektit të prokurimit.

Në përfundim të vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në bazë të përmbushjes së kërkesave kualifikuese të përgjithshme dhe të veçanta, është bërë propozuar për kualifikim dhe renditje i pari, operatorin ekonomik **“F.” SH.P.K., me NIPT J..S,** me ofertën në vlerën 86,411,340.00 (tetëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e dyzetë) lekë pa TVSH.
Njoftimi i klasifikimit përfundimtar është bërë në datë 24.05.2022.
Publikimi i Njoftimit të fituesit ne SPE është bërë në datë 30.05.2022
Me operatorin i shpallur fitues është lidhur kontrata nr/prot.354, datë 12.4.2022.
**- Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve** .
Nga auditimi i dokumentacionit për shërbimin kryer u konstatua si me poshtë;
Për marrjen në dorëzim të shërbimit të kryer në zonën bregdetare për katër Bashkitë është hartuar Urdhri nr/prot. 101, datë 13.6.2022, nr/prot,1195/1, datë 13.6.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e ecurisë së zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim të shërbimit të kryer’’, bashkëlidhur nga Grupi i punës i ngritur nga Titullari me përcaktim të grupeve të punës për çdo ARB të cilat kanë hartuar proçes verbale” Tip “ditore sipas pikave për shërbimin ë zonës bregdetare dhe marrja në dorëzim për punën e kryer dhe plotësime proçes verbaleve më shkrim dore për sasinë grumbullimit e mbetjeve
( kontenier240I;1100I) mbi monitorimin /ecurinë e punimeve ditore dhe problematikave që mund të këtë gjatë ditës /si dhe orit nga ora (18;-06 ) ky orare I përcaktuar në kushtet kontratës të mëngjesit dhe dorëzimi nga grupi I punës nr/prot. datë ARB-së, në Durrës, Kavajë Himarë dhe Sarandë. Dërgim grafikët e shërbimit të akseve në çdo Bashki. Proçes verbalet për marrjen dorëzim për pastrimin e zonës bregdetare dhe situacion ditor të cilat ishin hartuar çdo ditë nga grupi I punës të ARB-ve dhe me subjektin “F.” ku janë nënshkruar nga të dy palët ,me objekt “Shërbim i pastrimit i zonës bregdetare për Bashkitë: Durrës, Sarandë, Kavajë dhe Himarë, protokolluar në AKB më nr/prot, datë për çdo rast Raporti përmbledhëse,

Akt-rakordomi, Dërgim stacioni pranë AKB. Veprime këto në përputhje me Udhëzimin nr 30 datë 27.11.2012 "' Aktivet në Njësite e Sektorit Publik" pika 36 dhe të Ligjit nr. 10296 "'Menaxhimit Financiar dhe kontrollit" neni 26.

*Tabela me urdhër-shpenzimet, pastrimi I zonës Bregdetit sipas bashkive.*

| Nr/USH | data | Objekti I shpenzimit | Plan/kontratës | Likujduar/lekë | Diferenca (+)(-) | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 122 | 9.8.2022 | Shërbim pastrimi Bashkia Himarë | 7,923,096 | 7,922,530 | 566 | Volume punimesh më pak |
| 123 | 9.8.2022 | Shërbim pastrimi Bashkia Kavajë | 5,816,016 | 5,813,546 | 2,470 | Volume punimesh më pak |
| 124 | 9.8.2022 | Shërbim pastrimi Bashkia Sarandë | 5,544,360 | 5,516,928 | 27,432 | Volume punimesh më pak |
| 125 | 9.8.2022 | Shërbim pastrimi Bashkia Durrës | 15,281,064 | 15,241,812 | 39,252 | Volume punimesh më pak |
| | | Total | **34,564,536** | **34,494,816** | **69,720** | |

*Faza e dytë e likuidimit*

| Nr/USH | data | Objekti I shpenzimit | | Vlera | Diferenca (+)(-) | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 146 | 7.9.2022 | Shërbim pastrimi Bashkia Himarë | 8,187,199 | 8,175,305 | 11,894 | Volume punimesh më pak |
| 143 | 2.9.2022 | Shërbim pastrimi Bashkia Kavajë | 6,009,883 | 6,008,825 | 1,058 | Volume punimesh më pak |
| 145 | 7.9.2022 | Shërbim pastrimi Bashkia Sarandë | 5,729,172 | 5,714,268 | 14,904 | Volume punimesh më pak |
| 142 | 2.9.2022 | Shërbim pastrimi Bashkia Durrës | 15,790,433 | 15,787,745 | 2,688 | Volume punimesh më pak |
| | | Total | **35,716,687** | **35,686,143** | **30,544** | |

**Faza e tretë e likujdimit**

| Nr/USH | data | Objekti I shpenzimit | | Vlera | Diferenca (+)(-) | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 175 | 27.10.2022 | Shërbim pastrimi Bashkia Himarë | 7,658,993 | 7,658,993 | (0) | |
| 178 | 27.10.2022 | Shërbim pastrimi Bashkia Kavajë | 5,622,149 | 5,622,149 | (0) | |
| 176 | 27.10.2022 | Shërbim pastrimi Bashkia Sarandë | 5,359,548 | 5,342,700 | 16,848 | Volume punimesh më pak |
| 177 | 27.10.2022 | Shërbim pastrimi Bashkia Durrës | 14,771,695 | 14,771,695 | - | |
| | | **Total** | 33,412,385 | **33,395,537** | **16,848** | |
| | | **Totali gjithsej likujdim** | **103,693,608** | **103,576,496** | **117,112** | |

*Faza e parë e likuidimit*

Rezulton se për periudhën 15-Qershor 2022- 15 Shator 2022, për shërbim të pa kryer në terren në Bashkitë Sarandë, Durrës, Himarë dhe Kavajë, nuk është likuiduar operatori ekonomik në vlerën **117,112 lekë .**

Në procesverbalet ditore dhe grafiket dhe situacionet e mbajtura nga grupi i punës janë paraqitur shërbime të pa kryera nga operatori ekonomik këto të dokumentuara a me procesverbalet për punime të kryera, sasinë grumbullimit e mbetjeve, sipas kontejnerëve, de kazanëve të përcaktuar që në kontratë.

***Konkluzioni:*** Proçes- verbalet ditore të mbajtura në terren nga grupi i punës me subjektin "F." janë të plotësuara në terren sipas Tip me shkrim(dore) për sasinë/ volumin e punës së

kryer për pastrimin e zonës bregdetare të nënshkruara nga grupi I punës dhe subjekti; kazanët dhe kamionët e kane vëllim dhe sasinë të e përcaktuara që në kontratë Proçes verbalet ditore të mbajtura në terren nga grupi I punës, si dhe grafikët përmbledhës për çdo muaj sipas bashkive janë të nënshkruar nga grupi i punës si dhe përfaqësuesi I Firmës.
Për një punë sa më efiçente duhet që të hartohet dhe një urdhër nga Titullari i AKB –së, për zyrat përkatëse të Financës sipas ARB –ve, që të përfshihen në kontrollin e brendshme financiare të dokumenteve shoqëruese, për verifikimin e dokumentacion të mbajtur në terren nga grupet e punës.
Autoriteti Kontraktor për shërbime tilla duhet të prokuroje nëpërmes procedurës me blerje te vogla për përzgjedhje të ekspertit të fushës.
Praktika për shërbimin e zonës bregdetare, është në përputhje me Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "' Për Menaxhimin e Aktivet në Njësite e Sektorit Publik" pika 36, si dhe të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.20210 "'Menaxhimit Financiar dhe kontrollit" neni 4 pika 26 .

| **Titulli i gjetje** | *Zbatimi i kontratës* |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi u konstatua se**,** lidhur me dorëzimin e produktit për tenderin e pastrimi të zonës bregdetare, Eksperti i kontraktuar ka depozituar shkresën nr. 358/2 datë 11.04.2022 "Dërgim dokumentacioni tekniko-ekonomik për kryerjen e shërbimit të Pastrimit të Zonës Bregdetare për 4 Bashkitë Durrës, Kavajë, Himarë Sarandë".<br>-Komisioni i marrjes në dorëzim të produktit ka nënshkruar proces verbalin e marrjes në dorëzim pa oponencë apo kërkesë për sqarim ndaj raportit të dorëzuar me nr. Prot 358/2 datë 11.4.2022. |
| **Kriteri:** | Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "'Për Menaxhimin e Aktivet në Njësite e Sektorit Publik" |
| **Ndikimi/Efekti** | Monitorim sa me evidencë për pastrimin e zonës bregdetare |
| **Shkaku** | Mos ngritje urdhri nga titullari për sektorin e financës pranë ARB-ve. |
| **Rëndësia** | E Mesme. |
| **Rekomandim** | Komisioni i marrjes në dorëzim të produktit të përgatitura nga eksperti jashtëm, ne raste të ngjashme komisionet të studiojnë materialet dhe të paraqesin për aprovim nëpërmjet një informacioni pranë titullarit të Autoritetit Kontraktor. |

***Për sa është trajtuar në këtë Akt-Konstatim nr.3, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 561/11 prot., datë 05.10.2023,***
***Pretendimi i subjektit:***
Përsa i përket observacionit në lidhje me justifikimin e punësimit të ekspertit të jashtëm dokumentacioni i sjellë nga grupi i punës për mënyrën e përzgjedhjes së ekspertit dokument bashkangjitur ka përcjellë grupin e punës dhe arsyet që përzgjedhja është bere me ekspert të fushës të menaxhimit të mbetjeve të integruara dhe eksperti është i certifikuar për kryerjen e këtyre shërbimeve ,Grupi i marrjes në dorëzim të produktit të punës, ka sjellë bashkëlidhur urdhrin e titullarit.

***Qëndrimi i grupit të auditimit:***
*Përsa i përket observacionit në lidhje me plotësimin e dokumentacionit për përzgjedhjen e ekspertit, është sjellë dokumentacioni bashkëlidhur, grupi i auditimit pasi shqyrtojë*

*dokumentacioni mori në konsideratë pjesërisht dhe u reflektuan në Projekt-Raportin e Auditimit.*

**Në zbatim të pikës 2. a. Mbi auditimin e prokurimeve të fondeve publike në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit**
Në zbatim të pikës nr. 2, të programit të auditimit 561/1, datë 30.06.2023,
2. Mbi auditimin e prokurimeve të fondeve publike:
a. Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.
b. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.
Në zbatim të pikës nr. 2, të programit të auditimit 561/1, datë 30.06.2023, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Regjistrat e planifikimit dhe realizimit të prokurimeve për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021.
2. Urdhrat për ngritjen e komisioneve të prokurimeve me vlera të vogla për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021.
3. Procedurat e prokurimeve me vlera të vogla me zgjedhje për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021.
4. Dokumentacion plotësues/justifikues si fatura, transaksione bankare, fletë-hyrje në magazinë etj.,.

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar dhe aksesit në sistemin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) konstatohet se:**
***Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021*** janë realizuar 25 procedura prokurimi me vlera të vogla, nga të cilat 16 të publikuara në sistemin elektronik të APP-së me fond limit **1,927,714.00** lekë pa tvsh dhe realizuar me vlerë kontrate në shumën **1,582,100.00** lekë pa tvsh dhe 9 janë blerje të vogla nën 100,000 lekë pa tvsh.
*(Të detajuara në aneksin nr. 1)*
Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:
- Me Urdhrin nr. 4 të Drejtorit të Përgjithshëm z. L. L., "Për krijimin e Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël", nr. 38 prot, datë 15.01.2021, është krijuar komisioni për Prokurimin me vlerë të vogël si më poshtë:
1. E. D. Kryetar
2. A. Z. Anëtar
3. B. K. Anëtar
Referuar të dhënave të sipërpërmendura dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion grupi i auditimit, për vitin 2021, ka konstatuar se në 6 raste është zbatuar procedura e blerjeve të vogla nën 100.000 mijë lekë pa tvsh, Për sa më sipër nuk është bërë hedhja në sistemin e APP-së, duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit. Për sa më sipër këto procedura duhet të kryheshin si procedura normale prokurimi dhe jo si blerje nën 100.000 lekë pa tvsh. Konkretisht:

**1. Me Urdhër Prokurimi nr. 107, datë 20.12.2021,** të Drejtorit të Përgjithshëm z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. E. D. (kryetar i komisionit), znj. A. Z. dhe znj. B. K. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Riparime Elektrike"** me fond limit **52,000 lekë pa tvsh.**
**2. Me Urdhër Prokurimi nr. 108, datë 20.12.2021,** të Drejtorit të Përgjithshëm z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për

procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. E. D. (kryetar i komisionit), znj. A. Z. dhe znj. B. K. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Riparime Hidraulike"** me fond limit **78,000 lekë pa tvsh.**
Për sa më sipër të dyja këto procedura që janë kryer si blerje të vogla nën 100.000 lekë pa tvsh duhet të kryheshin si një procedurë normale prokurimi dhe jo si dy blerje nën 100.000 lekë pa tvsh pasi totali i fondit limit për të dy këto procedura është **52,000 + 78,000 = 130,000** lekë pa tvsh.
Për sa më sipër për dy procedurat e mësipërme kemi copëzim fondi pasi janë procedura të ngjashme dhe duhet të përfshihen në regjistrin e parashikimeve dhe të zhvillohen si një procedurë normale prokurimi.
**1. Me Urdhër Prokurimi nr. 96, datë 10.12.2021,** të Drejtorit të Përgjithshëm z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. E. D. (kryetar i komisionit), znj. A. Z. dhe znj. B. K. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Mirëmbajtje rutinë në ambientet e AKB"** me fond limit **82,320 lekë pa tvsh.**

**2. Me Urdhër Prokurimi nr. 97, datë 10.12.2021,** të Drejtorit të Përgjithshëm z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. G. T. (kryetar i komisionit), znj. E. D. dhe znj. M. C. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Shërbime të tjera në ambientet e AKB"** me fond limit **49,700 lekë pa tvsh.**

**3. Me Urdhër Prokurimi nr. 95, datë 10.12.2021,** të Drejtorit të Përgjithshëm z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. G. T. (kryetar i komisionit), znj. E. D. dhe znj. M. C. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Mirëmbajtje rutinë në ambientet e AKB"** me fond limit **99,800 lekë pa tvsh.**
Për sa më sipër të treja këto procedura që janë kryer si blerje të vogla nën 100.000 lekë pa tvsh duhet të kryheshin si një procedurë normale prokurimi dhe jo si tre blerje nën 100.000 lekë pa tvsh pasi totali i fondit limit për të tre këto procedura është **82,320 + 49,700 + 99,800 = 231,820** lekë pa tvsh.
Për sa më sipër për tre procedurat e mësipërme kemi copëzim fondi pasi janë procedura të ngjashme dhe duhet të përfshihen në regjistrin e parashikimeve dhe të zhvillohen si një procedurë normale prokurimi.

***Blerjet e vogla deri nën 1,000,000 lekë për vitin 2021***
**1.** Me Urdhër Prokurimi nr. 14, datë 19.05.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. E.D. (kryetar i komisionit), znj. A. Z. dhe znj. B. K. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje Kancelari"** me fond limit 332,824 lekë pa tvsh.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 20.05.2021, është shpallur fitues operatori ekonomik "I. O." me vlerë 221,000 lekë pa tvsh i cili është i renditur i pari në klasifikimin përfundimtar sipas.

**2.** Me Urdhër Prokurimi nr. 24, datë 28.06.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së z. L.L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. E.D. (kryetar i komisionit), znj. A.Z. dhe znj.

B. K. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Pjesë Këmbimi"** me fond limit 110,800 lekë pa tvsh.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 05.07.2021, është shpallur fitues operatori ekonomik "A. M. S." me vlerë 93,300 lekë pa tvsh i cili është i renditur i pesti në klasifikimin përfundimtar. Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 01.07.2021, operatori i renditur në vend të parë, L. S., u tërhoq për arsye objektive. Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 02.07.2021 operatori i renditur në vendin e dytë, N., nuk u paraqit në orar. Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 05.07.2021, operatori i renditur në vend të tretë, S. & C. C., nuk u paraqit në orar dhe sipas Procesverbalit të mbajtur datë 05.07.2021 operatori i renditur në vend të katërt, O. M. M. u tërhoq për arsye objektive.
**3.** Me Urdhër Prokurimi nr. 104, datë 16.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. E. D. (kryetar i komisionit), znj. A. Z. dhe znj. B. K. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje Kancelari"** me fond limit 86,333 lekë pa tvsh.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 23.12.2021, është shpallur fitues operatori ekonomik "L. D." me vlerë 86,333 lekë pa tvsh i cili është i renditur i gjashti në klasifikimin përfundimtar.
Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 21.12.2021, për operatorin e renditur në vend të parë, R. dhe operatorin e renditur në vendin e dytë, O.T., është bërë hedhja e shortit pasi të dy këta operator kishin ofertë të njëjtë. Operatori R. u rendit në vendin e parë pas hedhjes së shortit dhe operatori o. T. në vendin e dytë. Për operatorin R. nuk argumentohet arsyeja e tërheqjes as në sistem dhe as shkresërisht me një procesverbal por thjeshtë citohet që është tërhequr pas hedhjes së shortit.
Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 22.12.2021 operatori i renditur në vendin e dytë, O. T., u tërhoq për arsye të përllogaritjes së gabuar të kostos.
Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 22.12.2021, për operatorin J. dhe për operatori A. S., është bërë hedhja e shortit pasi të dy këta operator kishin ofertë të njëjtë.
Pas hedhjes së shortit në vend të parë ka dale operatori J. dhe në vendin e dytë operatori A.S.. Grupi i auditimit ka konstatuar se për operatorin J., nuk ka asnjë informacion për tërheqjen apo skualifikimin e tij dhe rrjedhimisht as për kalimin në operatorin A. S..
Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 22.12.2021 operatori A.S., u tërhoq për arsye të përllogaritjes së gabuar të kostos.
Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 22.12.2021 operatori i renditur në vendin e pestë, D. & F., u tërhoq për arsye të përllogaritjes së gabuar të kostos.

***<u>Pretendimi i subjektit:</u>***
*Subjekti ka dërguar kërkesën për tërheqje për arsye objektive të subjektit J. shpk, procesverbal nr. 2989/3 datë 22.12.2021, marrë nga sistemi elektronik i APP-së.*

***<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>***
*Observacioni merret në konsideratë.*

**4.** Me Urdhër Prokurimi nr. 72, datë 19.11.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. E. D. (kryetar i komisionit), znj. A. Z. dhe znj. B. K. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje Materiale Pastrimi"** me fond limit 110,960 lekë pa tvsh.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 26.11.2021, është shpallur fitues operatori ekonomik "H.2." me vlerë 78,000 lekë pa tvsh i cili është i renditur i gjashti në klasifikimin përfundimtar. Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 23.11.2021, operatori i renditur në vend të parë, E. P. u tërhoq për arsye objektive. Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 24.11.2021 operatori i renditur në vendin e dytë, N., u tërhoq për arsye shëndetësore. Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 24.11.2021, operatori i renditur në vend të tretë, I&. C., u tërhoq për arsye objektive. Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 25.11.2021 operatori i renditur në vend të katërt, V.O., u tërhoq për arsye të përllogaritjes së gabuar të kostos. Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 26.11.2021 operatori i renditur në vendin e pestë, S.G., u tërhoq për arsye të përllogaritjes së gabuar të kostos.

- **Nga auditimi për procedurat e blerjeve të vogla për vitin 2021u konstatuan këto problematika:**

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 64, pika 2, "Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës.

- Nuk është nënshkruar procesverbali i marrjes në dorëzim të dokumentacionit të operatorit fitues, nuk është përpiluar Proces Verbali dorëzimit të dokumentacionit të Operatorit fitues që duhet të firmoset nga Komisioni i Prokurimit për Procedurat me Vlera të Vogla si dhe nga Operatori Ekonomik fitues, nuk është përpiluar Proces Verbali Vlerësimit dhe gjeneruar nga sistemi Raporti i Vlerësimit, nuk është gjeneruar nga sistemi dhe bashkangjitur praktikës Raporti Përfundimtar. Për sa më sipër, të gjitha këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni nr. 40, pika nr. 5, "Në rastin kur procedura e prokurimit me vlerë të vogël kryhet me mjete elektronike, anëtarët e komisionit ftojnë të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë, kur është e mundur, si dhe publikojnë ftesën për ofertë për çdo të interesuar, në sistemin e prokurimit elektronik.

Në çdo rast, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet autoritetit kontraktor, brenda afatit të përcaktuar nga ky i fundit në ftesën për ofertë.

Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet të njoftojë autoritetin kontraktor brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë. Në njoftim duhet të jepen arsyet, që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit. Autoriteti kontraktor mund të refuzojë ofertën e paraqitur nga një operator ekonomik, i cili në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël, të zhvilluar nga ky autoritet gjatë këtij viti, nuk e ka njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë mbi arsyet që kanë çuar në pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit.

Kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë.

Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nëpërmjet një procesverbali të mbajtur për këtë qëllim. Në çdo rast, autoriteti kontraktor të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të kontratës vetëm operatorët ekonomikë të renditur deri në vendin e dhjetë të klasifikimit, neni nr. 57, pika nr. 3, " Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/janë detyrat e mëposhtme: Administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke

përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti, neni nr. 64, pika nr. 5, "Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Njëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të pasqyrohet në procesverbal. Dokumentet që shoqërojnë ofertën nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen, në përputhje me nenin 12 të LPP."

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe aksesit në sistemin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) konstatohet se:**

***Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022*** janë realizuar 26 procedura prokurimi me vlera të vogla, nga të cilat 20 të publikuara në sistemin elektronik të APP-së me fond limit **1,794,975.68** lekë pa tvsh dhe realizuar me vlerë kontrate në shumën **1,435,978.33** lekë pa tvsh dhe 6 janë blerje të vogla nën 100,000 lekë pa tvsh.

Gjithashtu gjatë vitin 2022 janë realizuar edhe:

- Procedura e prokurimit me objekt "Pastrimi i zonës bregdetare për bashkitë Durrës, Sarandë, Kavajë dhe Himarë me fond limit 91,557,753 lekë pa tvsh.
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje lëndë djegëse disel (gasoil) për automjetet e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", (Marrëveshje kuadër e kryer nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve Publike të Përqendruara)

( Të detajuara në aneksin nr. 2)

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

- Me Urdhrin nr. 5 të Drejtorit të Përgjithshëm z. L. L., "Për krijimin e Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël", nr. 123 prot, datë 07.02.2022,është krijuar komisioni për Prokurimin me vlerë të vogël si më poshtë:

1. G. T. Kryetar
2. B. K. Anëtar
3. E. D. Anëtar

- Me Urdhrin nr. 37 të Drejtorit të Përgjithshëm z. L. L., për ndryshimin e Urdhrit nr. 5, Datë 07.02.2022 "Për krijimin e Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël", nr. 123/1 prot, datë 23.03.2022,është krijuar komisioni për Prokurimin me vlerë të vogël si më poshtë:

1. G.T. Kryetar
2. E. D. Anëtar
3. D. S. Anëtar

- Me Urdhrin nr. 72 të Drejtorit të Përgjithshëm z. L. L., për ndryshimin e Urdhërit nr. 5, Datë 07.02.2022 "Për krijimin e Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël", nr. 879 prot, datë 19.05.2022, është krijuar komisioni për Prokurimin me vlerë të vogël si më poshtë:

1. G. T. Kryetar
2. E. D. Anëtar
3. M. C. Anëtar

Gjithashtu me Urdhrin nr. 92 të Drejtorit të Përgjithshëm z. L. L., "Për krijimin e Komisionit të sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar", nr. 879/1 prot, datë 07.06.2022, është krijuar Komisioni i sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar si më poshtë:

1. G.T. Kryetar
2. E. D. Anëtar
3. M. C. Anëtar

Referuar të dhënave të sipërpërmendura dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion grupi i auditimit, për vitin 2022, ka konstatuar se në 4 raste është zbatuar procedura e blerjeve të vogla nën 100.000 mijë lekë pa tvsh, Për sa më sipër nuk është bërë hedhja në sistemin e APP-së, duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit. Për sa më sipër këto procedura duhet të kryheshin si procedura normale prokurimi dhe jo si blerje nën 100.000 lekë pa tvsh. Konkretisht:

**1. Me Urdhër Prokurimi nr. 165, datë 13.10.2022,** të Drejtorit të Përgjithshëm z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. G. T. (kryetar i komisionit), znj. E. D. dhe znj. M. Ç. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Përshtatja dhe kthimi i ambienteve të ish-magazinës në zyrë funksionale pune për inspektoreve AKB-së"** me fond limit **44,168 lekë pa tvsh.**

**2. Me Urdhër Prokurimi nr. 190, datë 13.10.2022,** të Drejtorit të Përgjithshëm z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. G. T. (kryetar i komisionit), znj. E. D. dhe znj. M. Ç. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Riparim Çatie"** me fond limit **61,750 lekë pa tvsh.**

Për sa më sipër të dyja këto procedura që janë kryer si blerje të vogla nën 100.000 lekë pa tvsh duhet të kryheshin si një procedurë normale prokurimi dhe jo si dy blerje nën 100.000 lekë pa tvsh pasi totali i fondit limit për të dy këto procedura është **44,168 + 61,750 = 105,918** lekë pa tvsh.

Për sa më sipër për dy procedurat e mësipërme kemi copëzim fondi.

**1. Me Urdhër Prokurimi nr. 181, datë 22.11.2022,** të Drejtorit të Përgjithshëm z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. G.T. (kryetar i komisionit), znj. E. D. dhe znj. M. C. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Riparime Elektrike"** me fond limit **99,760 lekë pa tvsh.**

**2. Me Urdhër Prokurimi nr. 190, datë 13.10.2022,** të Drejtorit të Përgjithshëm z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. G.T. (kryetar i komisionit), znj. E. D. dhe znj. M. Ç. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Riparime Hidraulike"** me fond limit **49,780 lekë pa tvsh.**

Për sa më sipër të dyja këto procedura që janë kryer si blerje të vogla nën 100.000 lekë pa tvsh duhet të kryheshin si një procedurë normale prokurimi dhe jo si dy blerje nën 100.000 lekë pa tvsh pasi totali i fondit limit për të dy këto procedura është **99,760 + 49,780 = 149,540** lekë pa tvsh.

Për sa më sipër për dy procedurat e mësipërme kemi copëzim fondi.

***<u>Blerjet e vogla deri në 1,000,000 lekë për vitin 2022</u>***

**1.** Me Urdhër Prokurimi nr. 182, datë 24.11.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. G. T. (kryetar i komisionit), znj. E. D. dhe znj. M. Ç. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Pjesë Këmbimi"** me fond limit 70,444 lekë pa tvsh.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 01.12.2022, është shpallur fitues operatori ekonomik "T. G. A." me vlerë 50,000 lekë pa tvsh i cili është i renditur i dyti në

klasifikimin përfundimtar. Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 01.12.2022, operatori i renditur në vend të parë, L. S., u tërhoq pasi nuk plotëson kriteret.
**2.** Me Urdhër Prokurimi nr. 152, datë 28.09.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. G. T. (kryetar i komisionit), znj. E. D. dhe znj. M. Ç. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Blerje Kancelarie"** me fond limit 350,914 lekë pa tvsh.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 04.10.2022, është shpallur fitues operatori ekonomik "L. D." me vlerë 300,000 lekë pa tvsh i cili është i renditur i dyti në klasifikimin përfundimtar. Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 04.10.2022, operatori i renditur në vend të parë, "Sh. G.", u s'kualifikua pasi nuk u paraqit brenda afatit të përcaktuar.
**3.** Me Urdhër Prokurimi nr. 79, datë 20.05.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. G. T. (kryetar i komisionit), znj. E. D. dhe znj. M. Ç. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Sigurimi i mjeteve të transportit"** me fond limit 29,460 lekë pa tvsh.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 24.05.2022, është shpallur fitues operatori ekonomik "A." me vlerë 26,586 lekë pa tvsh.
**4.** Me Urdhër Prokurimi nr. 155, datë 04.10.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së z. L. L. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga znj. G. T. (kryetar i komisionit), znj. E. D. dhe znj. M. Ç. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **"Materialë pastrimi"** me fond limit 199,925 lekë pa tvsh.
- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 11.10.2022, është shpallur fitues operatori ekonomik "2-M." me vlerë 153,000 lekë pa tvsh i cili është i renditur i treti në klasifikimin përfundimtar. Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 06.10.2022, operatori i renditur në vend të parë, "B. L.", u u tërhoq për shkak të keq llogaritjes së ofertës. Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 10.10.2022, operatori i renditur në vendin e dytë, "N. V.", nuk u paraqit brenda afatit të përcaktuar.
Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 10.10.2022, për operatorin e renditur në vend të tretë, 2-M.dhe operatorin e renditur në vendin e katërt, N., është bërë hedhja e shortit pasi të dy këta operator kanë paraqitur ofertë të njëjtë. Pas hedhjes së shortit fitues ka rezultuar operatori 2-M.
Vlen të përmendet se në vitin 2022 procedurat e prokurimit publik, janë kryer konformë legjislacionit.

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetje** | Parregullsi në dokumentacion si dhe në zhvillimin e procedurave të prokurimeve me vlera të vogla nën 100,000 lekë pa TVSH. |
| **Situata:** | Nga auditimi për blerjet e vogla nën 100,000 lekë pa TVSH në procedurat e prokurimit publik në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, u konstatuan këto problematika:<br>- Për vitin 2021, nga 9 procedura me vlerë nën 100,000 lekë pa tvsh, në 6 raste është zbatuar procedura e blerjeve.Për sa më sipër nuk është bërë hedhja në sistemin e APP-së, duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit. Për sa më sipër këto procedura duhet të kryheshin si procedura normale prokurimi dhe jo si blerje nën 100.000 lekë pa tvsh, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914, datë |

| | |
|---|---|
| | 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 40, pika 1 dhe pika 8.<br>- Për vitin 2022, nga 6 procedura me vlerë nën 100,000 lekë pa tvsh, në 4 raste është zbatuar procedura e blerjeve të vogla nën 100.000 mijë lekë pa tvsh, Për sa më sipër nuk është bërë hedhja në sistemin e APP-së, duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit. Për sa më sipër këto procedura duhet të kryheshin si procedura normale prokurimi dhe jo si blerje nën 100.000 lekë pa tvsh, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 40, pika 1 dhe pika 8.<br>- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla nën 100,000 mijë lekë pa tvsh, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 64, pika 2, "Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës." |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni nr. 40, pika nr.1, 6, 8.<br>- Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar, pika nr. 18. |
| **Ndikimi/Efekti** | Copëzimi i fondit në këto procedura sjell mos kryerjen e këtyre si procedurë normale prokurimi dhe si rrjedhojë nuk garanton besueshmëri në kryerjen e procedurës si dhe në shpalljen e operatorit fitues. |
| **Shkaku** | Mos zbatimi procedurave ligjore të procedurave të prokurimit publik duke aplikuar copëzimin e fondeve. |
| **Rëndësia** | E Mesme. |
| **Rekomandim** | Komisioni Prokurimit me Vlerë të Vogël në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit të marrë masa që në fazën e hartimit të regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit të përfshijë këto blerje në procedurat normale të prokurimit me vlerë të vogël për të minimizuar mundësinë e abuzimit me fondet e institucionit. |

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetje** | Parregullsi në dokumentacion në zhvillimin e procedurave të prokurimeve me vlera të vogla. |
| **Situata:** | Nga auditimi për blerjet e vogla në procedurat e prokurimit publik në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit u konstatuan këto problematika për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021:<br>- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 64, pika 2. |

| | |
|---|---|
| | - Nuk është nënshkruar një procesverbal ku çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në të, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 64, pika 5.<br>- Nuk është përpiluar Proces Verbali dorëzimit të dokumentacionit të Operatorit fitues që duhet të firmoset nga Komisioni i Prokurimit për Procedurat me Vlera të Vogla si dhe nga Operatori Ekonomik fitues<br>- Nuk është përpiluar Proces Verbali Vlerësimit dhe gjeneruar nga sistemi Raporti i Vlerësimit.<br>- Nuk është gjeneruar nga sistemi dhe bashkangjitur Raporti Përfundimtar. |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar<br>- Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar. |
| **Ndikimi/Efekti** | Mangësia në plotësimin e dokumentacionit nuk garanton besueshmëri në vlerësim dhe shpalljen e operatorit fitues. |
| **Shkaku** | Mosrespektimi dispozitave ligjore në zbatimin e procedurave të prokurimit. |
| **Rëndësia** | E Mesme. |
| **Rekomandim** | Komisioni Prokurimit me Vlerë të Vogël në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, në vazhdimësi të marrë masa në plotësimin me dokumentacionin e nevojshëm si dhe zbatimin e të gjitha procedurave të prokurimit publik për të garantuar besueshmëri në zhvillimin e procedurës së prokurimit si dhe vlerësim dhe shpalljen e operatorit fitues. |

**Marrëveshja Kuadër për blerjen e karburantit për nevoja të AKB-së.**

- **Procedure "Blerje karburanti, përvec Jet Al", REF- 32485-06-10-2022, viti 2022-2023.**

| | | |
|---|---|---|
| Marrëveshje kuadër nr. 139/11 prot, datë 26.08.2022<br>Marrëveshje kaudër, urdhër prokurimi nr. 223, datë 07.06.2022 | NJHDT<br><br>- | KVO<br><br>- |
| Fond total 345,090,265 lekë pa tvsh | | |
| Procedura e prokurimit – Marrëveshje kuadër | | |
| Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit. | Fitues: "K." Sh.p.k, "K. Group" sh.a. | Vlera 1,999,968 lekë pa tvsh viti 2022.<br>Vlera 1,999,968 lekë pa tvsh viti 2023. |
| Datë e hapjes së tenderit 13.07.2022. | Vlera e kontratës 3,999,936 lekë pa tvsh dhe 4,799,923.20 lekë me tvsh. | Kontrata, shkresa 2195/11 prot, datë 27.09.2022 |
| Marrin pjesë 3 OE<br>S'kualifikuam 0 OE | Ankimime në AK - Jo<br>Ankimime në KPP - Jo | Titullar i AK – A. S. (Zv. Drejtor i Përgjithshëm Administrativ) |

Në zbatim të pikës 1/b të kreut III, të VKM-së nr. 393, Datë 09.06.2022 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencisë shtetërore të prokurimeve të përqendruara dhe

ngarkimin e kësaj agjencie për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë", Agjencia Shtetërore e Prokurimeve Publike të përqendruara, ka zhvilluar më datë 13.07.2022 procedurën e prokurimit me objekt "Blerje karburanti, përvec Jet Al", ndarë më tre lotët, me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër 345,090,265 lekë pa tvsh dhe me nr. REF-32485-06-10-2022.

Me urdhër prokurimi nr. 223, datë 07.06.2022, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara ka urdhëruar kryerjen e prokurimit me mjete elektronikeme fond total 345,090,265 lekë pa tvsh për procedurën e prokurimit me object "Blerje karburanti, përvec Jet Al", ndarë më tre lote si më poshtë:

1. Loti 1. "Furnizimi me lëndë djegëse F-16", me afat 3 vjet me fond limit të marrëveshjes kuadër 277,000,000 lekë pa tvsh.
2. Loti 2. "Furnizimi me lëndë djegëse GLN", me afat 2 vjet me fond limit të marrëveshjes kuadër 37,924,446 lekë pa tvsh.
3. Loti 3. "Furnizimi me lëndë djegëse për automjetet Disel (Gazoil)", me afat 2 vjet me fond limit të marrëveshjes kuadër 30,165,819 lekë pa tvsh.

Me Urdhër nr. 23, datë 24.03.2022, "Për krijimin e Komisionit për përllogaritjen e karburantit për Institucionin", nr. Prot 307 datë 24.03.2022, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, z. L. L., ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për përllogaritjen e karburantit për Institucionin, në përbërje të të cilit janë:

1. zj. E. H.
2. zj. E. D.
3. z. E. B.

Me shkresë nr. 316 prot, datë 25.03.2022, me lëndë "Kërkesë për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje lëndë djegëse disel (gasoil) për automjetet e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për vitin 2022", drejtuar z. E. M., drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara, është dërguar përllogaritja e fondit limit për realizimin e për realizimin e procedurës së prokurimit me object "Blerje lëndë djegëse disel (gazoil) për automjetet e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për 7 automjetet në dispozicion të kësaj Agjencie të ndara në dy loti si më poshtë:

- Loti 1 për vitin 2022, në vlerën 1,000,000 lekë pa tvsh.
- Loti 2 për vitin 2023, në vlerën 1,000,000 lekë pa tvsh.

Ky fond limit del sipas përllogaritjes së kryer nga komisioni për përllogaritjen e karburantit për Institucionin ku nevojat e institucionit për karburant për automjetet në dispozicion të tij për vitin 2022 janë përllogaritur 5,716 litra në total dhe cmimi pa tvsh, për cdo litër karburanti, i përllogaritur nga ky komision, është 174.9354lekë/litër.

Me shkresë nr. 693/1 prot, datë 09.05.2022, me lëndë "Kërkesë për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje lëndë djegëse disel (gazoil) për automjetet e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për vitin 2022", drejtuar z. E.M., drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara, është dërguar përllogaritja e fondit limit për realizimin e procedurës së prokurimit me object "Blerje lëndë djegëse disel (gazoil) për automjetet e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për 7 automjetet në dispozicion të kësaj Agjencie të ndara për nevojat e Institucionit si më poshtë:

- Nevojat për karburant për vitin 2022, në sasinë 9,960.15 litra.
- Nevojat për karburant për vitin 2023, në sasinë 9,960.15 litra.

Ky fond limit del sipas përllogaritjes së kryer nga komisioni për përllogaritjen e karburantit për Institucionin ku nevojat e institucionit për karburant për automjetet në dispozicion të tij

për vitin 2022 janë përllogaritur 9,960 litra në total dhe çmimi për çdo litër karburanti, i përllogaritur nga ky komision, është 200.8 lekë/litër pa tvsh.
Fondi limit i përllogaritur është 9,960 x 200.8 lekë/litër = 1,999,968 Lekë për një vit.
Grupi i auditimit ka konstatuar se ka një diferencë të konsiderueshme ndërmjet përllogaritjes së nevojave për karburant në dy shkresat e mësipërme. Konkretisht:
- Me shkresë nr. 316 prot, datë 25.03.2022, nevojat për karburant për AKB janë përllogaritur në sasinë5,716 litra për vitin 2022 dhe 5,716 litra për vitin 2023.
- Me shkresë nr. 693/1 prot, datë 09.05.2022, nevojat për karburant për AKB janë përllogaritur në sasinë9,960 litra për vitin 2022 dhe 9,960 litra për vitin 2023.
Arsyja se në shkresës nr. 316 prot, datë 25.03.2022 për nevojat për karburant për AKB janë përllogaritur në sasinë 5,716 litra/vit është si pasojë e vendimit nr. 160, datë 14.03.2022, të Kryeministrit "Për reduktimin e shpenzimeve të transportit për funksionarët, nëpunësit, punonjësit e institucioneve të Administratës Shtetërore nën përgjegjësinë Këshillit të Ministrave dhe Shoqërive/Ndërmarrjeve me capita l shtetëror".
Pas kërkesës për nënshkrimin e kontratës së parë të karburantit me shkresë nr. 2195/1 prot, datë 12.09.2022 të z. T. K., me shkresën nr. 2195/2, datë 15.09.2022 është bërë ftesa për ofertë për "Blerje karburanti, përvec Jet Al", ndarë në lote, Loti III Dizel (Gazoil), për shoqërinë "K." shpk.
Me Urdhër nr. 151, datë 16.09.2022, "Për kolaudimin , marrjen në dorëzim dhe administrimin e mallit të kontraktuar nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, për llogari të AKB-së me subjektin "K." shpk Group SH.A. sipas kontratave që do të lidhen në bazë të Marrëveshjes Kuadër nr. 139/11 prot, datë 26.08.2022", nr. 2340 Prot, datë 16.09.2022, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, z. L. L., ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për kolaudimin, marrjen në dorëzim dhe administrimin e mallit të kontraktuar nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, për llogari të AKB-së me subjektin "K." shpk Group SH.A. sipas kontratave që do të lidhen në bazë të Marrëveshjes Kuadër nr. 139/11 prot, datë 26.08.2022, me objekt "Blerje karburanti, përvec Jet Al", ndarë në lotët: Loti III "Furnizim me lëndë djegëse për automjetet e Institucionit Dizel (Gazoil), Procedurë e Hapur, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara (me afat 24 muaj)".
Komisioni përbëhet nga:
- Z. T. K. Kryetar, (Përgjegjës në sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse)
- Z. E. R.Anëtar, (Specialist në sektorin e Financës, Buxhetit dhe Prokurimeve)
- Zj. L. Sh. Anëtar, (Specialist në sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse)
Me shkresë nr. 2195/4 prot, datë 27.09.2022, është lidhur Minikontrata e Furnizimit Nr. 1, midis palëve:
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. L. L..
- BOE: Shoqërisë "K." shpk, përfaqësuar nga administrator Sh. K. dhe shoqërisë "K. G." sha, përfaqësuar nga administrator z. G.k..
Me shkresën nr. 2195/11 prot, datë 04.10.2022, është mbajtur Proces-verbali i marrjes në dorëzim dhe firmosur nga përfaqësuesit e AKB-së, z. T. K., z. E. R.dhe zj. L. Sh., si dhe firmosur nga zj. A.V., përfaqësuese e kontraktuesit.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, grupi i auditimi ka konstatuar se nuk është argumentuar përllogaritja e fondit limit në mënyrë të detajuar. Konkretisht, sasia e karburantit

që nevojitet për institucionin e AKB-së, e përllogaritur nga Komisionit për përllogaritjen e karburantit për Institucionin është 9,960 litra/vit dhe çmimi i karburantit 200.8 lekë/litër.
Sasi e përllogaritur 9,960 litra/vit për nevojat e institucionit të AKB-së, Komisioni për përllogaritjen e karburantit për Institucionin, justifikohet që i është referuar sasisë së karburantit të konsumuar në dy vitet e fundit si dhe VKM nr. 569, datë 17.07.2019, "Për krijimin e dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit".
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, Grupi i auditimit ka konstatuar se përllogaritja e nevojave të institucionit për karburant nga Komisioni për përllogaritjen e karburantit për Institucionin nuk është bërë në mënyrë të detajuar pasi nuk janë përcaktuar shumë faktor të rëndësishëm si numri total i Inspektimeve, Monitorimeve, Verifikimeve etj të kryera gjatë viteve të kaluara. Për sa më sipër si rrjedhojë nuk është bërë një përllogaritje e detajuar për totalin e kilometrave të përshkruara në vitet e kaluara.
Gjithashtu AKB nuk ka krijuar një komision "Për përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për kilometër" për automjetet e Institucionit.

***Pretendimi i subjektit:***

*Subjekti ka dërguar shkresës nr 1850/2 prot, datë 19.11.2020, me objekt Urdhër nr. 73, datë 19.11.2020, "Për krijimin e komisionit për përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për automjetet që ndodhen në inventarin e AKB-së" i përbërë nga M.Z., F. V. dhe K. B., të cilët me anë të procesverbalit datë 01.12.2020 dhe procesverbalit datë 03.12.2020 është përcaktuar norma e konsumit të karburantit për automjetet të cilat ndodhen në inventarin e AKB-së.*

***Qëndrimi i grupit të auditimit:***

*Observacioni merret në konsideratë por duhet theksuar se ky informacion nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit edhe pse nga ana e grupit janë bërë kërkesa të vazhdueshme gjatë periudhës së auditimit për këtë dokumentacion.*

Për sa më sipër nuk kemi një përllogaritje të saktë të konsumit të automjeteve të institucionit dhe si rrjedhojë nuk mund të kemi një përllogaritje të saktë për sasinë e karburantit që nevojitet për të përshkuar një numër të caktuar kilometrash.

***Konkluzion.***

Nga dokumentacioni vënë në dispozicion Grupi i Auditimit konstatoi se nuk argumentohet mënyra e përllogaritjes së totalit të kilometrave që automjetet e Institucionit do përshkojë gjatë vitit, Gjithashtu Grupi i Auditimit ka konstatuar se nuk argumentohet sasia e karburantit që nevojitet nga automjetet e institucionit për të përshkuar një numër të caktuar kilometrash pasi nuk ekziston një komision "Për përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për kilometër" dhe si rrjedhojë është i paqartë konsumi i automjeteve të institucionit.
Si konkluzion, nga të dhënat e sipërpërmendura, grupi i auditimit konstaton se nuk argumentohet përllogaritja e fondit limit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 59, pika 2. "Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.)" si dhe Udhëzimi Nr. 6, datë 16.01.2018, pika nr. 7, "Përllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër", nënpikat:

7.1 Vlera e parashikuar e një marrëveshje kuadër duhet të përfshijë shumën e përllogaritur të të gjitha vlerave të kontratave, që parashikohen të jepen gjatë kohës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.
7.2 Në rastin kur autoriteti kontraktor e ka të pamundur të përcaktojë sasinë e objektit të prokurimit, për efekt të përllogaritjes së vlerës së marrëveshjes kuadër, duhet t'i referohet për aq sa është e mundur, nevojave të planifikuara dhe/ose nevojave të mëparshme për këtë objekt. Në çdo rast, përllogaritja e nevojave, duhet të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e situatave kur dalin nevoja të reja, për të njëjtin objekt, të pa përfshira në marrëveshjen kuadër.
7.3 Në çdo rast, autoriteti kontraktor planifikon me përafërsi sasinë dhe vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër bazuar në eksperiencat e mëparshme, me qëllim jo vetëm orientimin e operatorëve ekonomikë, por edhe hartimin e kritereve për kualifikimin apo kërkesave të tjera, të cilat lidhen përpjesëtimisht me fondin limit.

***Pretendimi i subjektit:***
*Subjekti ka dërguar shkresës nr 3041 prot, datë 02.10.2023, e-mail i gërguar nga z. E. B., datë 29.09.2023, drejtuar AKB ku konstatohet" në Akt konstatim thuhet që " Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, grupi i auditimit ka konstatuar se nuk është argumentuar përllogaritja e fondit limite mënyrë të detajuar..."*
*Në lidhje me mos argumentimin e përllogaritjes së detajuar të konsumit vjetor të karburantit për AKB sqaroj:*
*Komisioni për përllogaritjen e konsumit të karburantit, duke u bazuar në Udhëzimin nr. 6, pika 7.2, vendosi që për përllogaritjen e konsumit të karburantit për vitet 2022 dhe 2023, të bazohet në konsumin e viteve të mëparshme 2020 dhe 2021......"*

***Qëndrimi i grupit të auditimit:***
*Observacioni nuk merret në konsideratë pasi sikurse thuhet edhe në Udhëzimin nr. 6, pika 7,2 thotë:"* Në rastin kur autoriteti kontraktor e ka të pamundur të përcaktojë sasinë e objektit të prokurimit, për efekt të përllogaritjes së vlerës së marrëveshjes kuadër, duhet t'i referohet për aq sa është e mundur, nevojave të planifikuara dhe/ose nevojave të mëparshme për këtë objekt. Në çdo rast, përllogaritja e nevojave, duhet të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e situatave kur dalin nevoja të reja, për të njëjtin objekt, të përfshira në marrëveshjen kuadër."
Duke u nisur edhe nga pika 7.2 e udhëzimit nr.6 nuk argumentohet pamundësia e përllogaritjes së sasisë të objektit të prokurimit, në rastin konkret nevojës për karburant.

| **Titulli i gjetje** | Mos argumentimi dhe dokumentimi i përllogaritjes së fondit limit |
|---|---|
| **Situata:** | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, Grupi i auditimit ka konstatuar se përllogaritja e nevojave të institucionit për karburant nga Komisioni për përllogaritjen e karburantit për Institucionin nuk është bërë në mënyrë të detajuar pasi nuk janë përcaktuar shumë faktor të rëndësishëm si numri total i Inspektimeve, Monitorimeve, Verifikimeve etj të kryera gjatë viteve të kaluara. Për sa më sipër si rrjedhojë nuk është bërë një përllogaritje e detajuar për totalin e kilometrave të përshkruara në vitet e kaluara për të arritur në një përllogaritje më të saktë për nevojat e institucionit të AKB-së për karburant për automjetet në dispozicion të tij. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri:** | - VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.<br>- Udhëzimi Nr. 6, datë 16.01.2018, pika nr. 7, "Përllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër". |
| **Ndikimi/Efekti** | Mos argumentimi dhe mos dokumentimi i përllogaritjes së fondit limit sjell mos përdorimin me efektivitet, efecientë dhe ekonomi citet të fondeve publike. |
| **Shkaku** | Mangësi në procesin e parashikimit të realizimit prokurimeve dhe në përdorimin e fondit limit. |
| **Rëndësia** | E Lartë. |
| **Rekomandim** | Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që në vijimësi, të bëhet një përllogaritje e saktë dhe e detajuar mbi nevojat e institucionit për punë, mallra dhe shërbime, me qëllim realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe përdorimin me efektivitet, efecientë dhe ekonomi citet të fondeve publike. |

**Dokumentimi përdorimit të karburantit nga punonjësit e AKB-së.**
Nga auditimi i përdorimit të karburantit në institucionin e AKB-së grupi i auditimit konstatoi disa mangësi në dokumentimin e përdorimit të karburantit si:
- Përgjithësisht Fletët e Udhëtimit nuk ishin të nënshkruara nga punonjësit e AKB-së për të justifikuar lëvizjet e kryera si dhe Fletë Udhëtimet përgjithësisht nuk janë shoqëruar me faturat tatimore të subjekteve ku është marrë karburanti pavarësisht se në siste sasia e karburantit rezulton e konsumuar.
- Drejtori i Performancës dhe Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare, z. G. A., nuk ka të argumentuara dhe të dokumentuara lëvizjet e tij gjatë periudhës objekt auditimi, pasi nuk ka të bashkangjitur produktin e punës nëpërmjet raporteve të përpiluar për punë e kryer dhe arsyen e shërbimit, për të justifikuar udhëtimet e tij, veprime këto në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika nr. 36.

| **Titulli i gjetje** | Parregullsi në dokumentimin e përdorimit të karburantit |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi i përdorimit të karburantit në institucionin e AKB-së grupi i auditimit konstatoi disa mangësi në dokumentimin e përdorimit të karburantit si:<br>- Përgjithësisht Fletët e Udhëtimit nuk ishin të nënshkruara nga punonjësit e AKB-së për të justifikuar lëvizjet e kryera si dhe Fletë Udhëtimet përgjithësisht nuk janë shoqëruar me faturat tatimore të subjekteve ku është marrë karburanti pavarësisht se në siste sasia e karburantit rezulton e konsumuar. |
| **Kriteri:** | - Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika nr. 36. |
| **Ndikimi/Efekti** | Mos dokumentimi i përdorimit të karburantit krijon mundësinë parë gabime, harresa, numërim të dyfishtë dhe mashtrime |
| **Shkaku** | Mangësi në plotësimin e dokumentacionit në përdorimin e karburantit nga ana e punonjësve të AKB-së |
| **Rëndësia** | E Mesme |

| | |
|---|---|
| **Rekomandim** | Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që në vijimësi, të gjithë punonjësit e AKB-së që përdorin automjetet e këtij institucioni të kryejnë dokumentimin e plotë të përdorimit të karburantit dhe ky dokumentacion të shoqërohet me Faturat Fiskale për çdo konsum karburanti. |

**Magazinimi i artikujve dhe rakordomi me Sektorin e Financës.**
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe nga auditimi i kryer në librat e magazinës grupi i auditimi ka konstatuar se ka parregullsi në mbajtjen e artikujve në librat e magazinës pas hyrjes dhe daljes së tyre në magazinë. U konstatua se mbajtja e artikujve në librat e magazinës bëhej pa një kronologji dhe pa një rregullshmëri të caktuar në hedhjen e tyre në këto libra. Konkretisht i njëjti artikull (në kancelari Letër format A4) ndodhej në vende të ndryshme në të njëjtin libër magazine. Për sa më sipër nuk mbahej në mënyrë kronologjike dhe të rregullt veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika nr. 36.
Gjithashtu grupi i auditimit ka konstatuar se nuk është kryer një rakordim periodik ndërmjet magazinës dhe zyrës së financës, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" kapitulli nr. 4.

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetje** | Parregullsi në mbajtjen e artikujve në librat e magazinës dhe mos rakordim sistematik ndërmjet magazinës dhe sektorit të financës |
| **Situata:** | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe nga auditimi i kryer në librat e magazinës grupi i auditimi ka konstatuar se ka parregullsi në mbajtjen e artikujve në librat e magazinës pas hyrjes dhe daljes së tyre në magazinë. Grupi i auditimit ka konstatuar se mbajtja e artikujve në librat e magazinës bëhej pa një kronologji dhe pa një rregullshmëri të caktuar në hedhjen e tyre në këto libra. Konkretisht i njëjti artikull (në kancelari Letër format A4) ndodhej në vende të ndryshme në të njëjtin libër magazine. Për sa më sipër nuk mbahej në mënyrë kronologjike dhe të rregullt.<br>Gjithashtu Grupi i auditimit ka konstatuar se nuk është kryer një rakordim periodik ndërmjet magazinës dhe zyrës së financës. |
| **Kriteri:** | - Ligji nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni nr. 4, pika nr. 26.<br>- Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika nr. 36.<br>- Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kapitulli nr. 4. |
| **Ndikimi/Efekti** | Mbajtja në mënyrë jo kronologjikë dhe jo të rregullt të artikujve në librat e magazinës sjell mundësinë e pasaktësisë në inventarin e magazinës.<br>Mos akordimi ndërmjet magazinës dhe financës në sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse mund të sjellë pasaktësi në përpunimin dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. |
| **Shkaku** | Mbajtja ne mënyrë jo të rregullt dhe jo kronologjike e artikujve në librat e magazinës |
| **Rëndësia** | E Mesme |
| **Rekomandim** | - Agjencia Kombëtare e Bregdetit të bëjë risistemuam të dokumentacionit dhe të librave të magazinës si dhe të bëhet mbajtja e artikujve në librat e magazinës në mënyrë kronologjike dhe të rregullt. |

| | |
|---|---|
| | - Sektori i Burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në AKB të kryej një rakordim sistematik të hyrjeve dhe daljeve të artikujve të magazinës ndërmjet specialistit të magazinës dhe specialistit të financës në këtë sektor. |

**Në zbatim të pikës 3** "*Mbi auditimin për krijimin dhe përditësimin e inventarit kombëtar të zonës bregdetare, bashkëpunimi me strukturat e tjera" u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:*
- *Informacioni mbi ecurinë e procesit të inventarizimit në zonat bregdetare, i sjellë në formë shkresore.*
***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***
Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 569, datë 17.07.2019 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", Kapitulli III, pika 6/b, Agjencia Kombëtare e Bregdetit është përgjegjëse për krijimin dhe përditësimin e Inventarit Kombëtar të Zonës Bregdetare.
Në zbatim të urdhrit nr. 57, datë 29.10.2020 "Për mbikëqyrjen e punës së Agjencive Rajonale të Bregdetit" dhe urdhrit nr. 58 datë 30.10.2020 "Për krijimin dhe përditësimin e inventarit kombëtar të zonës bregdetare", Drejtoria e Performancës dhe Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare dhe Standardeve në Turizëm në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit së bashku me Agjencitë Rajonale të Bregdetit kanë nisur punën për krijimin e Inventarit Kombëtar të Zonës Bregdetare.
Inventarizimi i veprimtarive turistike të zonës bregdetare është në proces realizimi, duke plotësuar dosjet fizike (foto të subjektit, dokumente plotësuese), dosjes digjitale (dosje me informacione të mbledhura të hedhura në hartë me pozicionin përkatës) dhe fletës së inventarizimit, me qëllim krijimin e një harte digjitale ku do të pasqyrohen subjektet që operojnë në fushën e turizmit.
Inventarizimi është kryer në zonat bregdetare si më poshtë:
Bashkia Shkodër: Zona e Velipojës;
Bashkia Lezhë: Zona e Shëngjinit;
Bashkia Durrës: Zona e Shkëmbit të Kavajës;
Bashkia Kavajë: Zona e Qerretit, Plazhi Krapen, Plazhi i Gjeneralit, Mali i Robit, Zona e Golemit;
Bashkia Rrogozhinë: Zona e Spillesë;
Bashkia Vlorë: Zona e Orikumit, Zona e Radhimës, Uji i Ftohtë;
Bashkia Sarandë: Zona e Ksamilit, Sarandë.

| Bashkia | Subjekte të inventarizuar | Tipologjia | NIPT | Adresa | Koordinata gjeografike | Përfaqësues ligjor | Kapaciteti | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shkodër** | **216** | Struktura akomoduese: 107<br>Struktura shërbimi: 109 | Identifikuar: 14<br>Pa identifikuar: 202 | Identifikuar: 216 | Identifikuar: 216 | Identifikuar: 16<br>Pa identifikuar: 200 | Identifikuar: 12<br>Pa identifikuar: 204 | Hapur: 11<br>Mbyllur: 205 |
| **Lezhë** | **350** | Struktura akomoduese: 123<br>Struktura shërbimi: 227 | Identifikuar: 60<br>Pa identifikuar: 290 | Identifikuar: 350 | Identifikuar: 350 | Identifikuar: 66<br>Pa identifikuar: 284 | Identifikuar: 44<br>Pa identifikuar: 306 | Hapur: 50<br>Mbyllur: 300 |
| **Durrës** | **116** | Struktura akomoduese: 49<br>Struktura shërbimi: 67 | Identifikuar: 25<br>Pa identifikuar: 91 | Identifikuar: 116 | Identifikuar: 116 | Identifikuar: 25<br>Pa identifikuar: 91 | Identifikuar: 23<br>Pa identifikuar: 93 | Hapur: 33<br>Mbyllur: 83 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kavajë** | **207** | Struktura akomoduese: 102<br>Struktura shërbimi: 105 | Identifikuar: 47<br>Pa identifikuar: 160 | Identifikuar: 207 | Identifikuar: 207 | Identifikuar: 47<br>Pa identifikuar: 160 | Identifikuar: 47<br>Pa identifikuar: 160 | Hapur: 67<br>Mbyllur: 140 |
| **Rrogozhinë** | **77** | Struktura akomoduese: 29<br>Struktura shërbimi: 48 | Identifikuar: 12<br>Pa identifikuar: 65 | Identifikuar: 77 | Identifikuar: 77 | Identifikuar: 12<br>Pa identifikuar: 65 | Identifikuar: 13<br>Pa identifikuar: 64 | Hapur: 8<br>Mbyllur: 69 |
| **Vlorë** | **259** | Struktura akomoduese: 122<br>Struktura shërbimi: 137 | Identifikuar: 65<br>Pa identifikuar: 194 | Identifikuar: 259 | Identifikuar: 259 | Identifikuar: 69<br>Pa identifikuar: 190 | Identifikuar: 64<br>Pa identifikuar: 195 | Hapur: 67<br>Mbyllur: 192 |
| **Sarandë** | **266** | Struktura akomoduese: 206<br>Struktura shërbimi: 60 | Identifikuar: 56<br>Pa identifikuar: 210 | Identifikuar: 266 | Identifikuar: 266 | Identifikuar: 80<br>Pa identifikuar: 186 | Identifikuar: 49<br>Pa identifikuar: 217 | Hapur: 34<br>Mbyllur: 232 |

Sa sipër, lidhur me subjektet që janë inventarizuar në periudhën Nëntor - Dhjetor 2020 janë kryer 7 bashki: Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Vlorë, Sarandë, ku janë inventarizuar gjithsej 1491 subjekte, për 738 struktura akomoduese dhe 753 struktura shërbimi, prej të cilave identifikuar 279 dhe të paidentifikuara 1212. Ndërsa, përsa i përket periudhës objekt auditimi, statistikat e mësipërme nuk kanë ndryshuar.
Tek struktura akomoduese janë përfshirë: resort, hotel, hotel bar-restorant, dhoma plazhi, shtëpi pushimi, kamping, argotizëm, komplekse. Tek struktura shërbimi janë përfshirë: becash bar, bar-kafe-restorant, pub, supermarket, market, pazëri, fast-food, etj.

Që nga viti 2020, disponohet tashmë dhe harta e plazheve e zonës bregdetare, sipas hartës së plazheve të propozuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe të miratuara nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik Veror, ku çdo parcelë plazhi, ka një kod identifikues dhe është e pasqyruar në sistemin e koordinatave sipas ASIG, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 171/2019, të *ndryshuar*, i cili përcakton:

*4. Detyrat e Komitetit të Menaxhimit të Sezonit Turistik janë:*
*a) miratimi i listës së plazheve dhe i hartës së stacioneve të plazheve, sipas tipologjive të tyre, si dhe plazheve publike, bazuar në propozimet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat pajisen me një numër të veçantë identifikues, që publikohet në momentin e hapjes së aplikimit online.*

Referuar të dhënave të siguruara nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, aktualisht hartat e plazheve për vitin 2021 dhe 2022, nuk janë më, në portalin ASIG, pasi është përditësuar me hartën e plazheve të vitit 2023. Drejtoria e Performancës dhe e Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare dhe Standardeve në Turizëm ka mbikëqyrur gjithashtu edhe procesin e inventarizimit në terren, si dhe ka vijuar me hedhjen e dosjeve fizike të inventarizimit në format dixhital për të përftuar një hartë përmbledhëse me subjektet turistike në zonën bregdetare.
Për sa më Lart, nga grupi i auditimit u konstatua se;
1.Në aktet ligjore dhe nënligjore, nuk përcaktohet dokumentacioni që do të ndihmojë në inventarizimin e zonës bregdetare;
2.Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në saj të këtij procesi nuk ka bashkëpunuar me një sërë institucionesh, midis të cilave;
-Njësitë vendore;
-Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;
-Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
*Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi punonjësit;*

1.L. L.-Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit;
2.G. A.-Drejtor i Performancës.

| **Titulli i gjetjes** | Inventari kombëtar i zonës bregdetare |
|---|---|
| **Situata:** | Agjencia Kombëtare e Bregdetit është angazhuar dhe ka nisur punën për krijimin e Inventarit Kombëtar të Zonës Bregdetare, i cili konsiston në plotësimin e dosjeve fizike (Foto të subjektit, dokumente plotësues nëse ka), dosjes digjitale (Dosje me informacione të mbledhura të hedhur në hartë me pozicionin përkatës) dhe fletës së inventarizimit ç`ka do të bëjë të mundur krijimin e një harte digjitale ku do të pasqyrohen subjektet që operojnë në fushën e turizmit.<br>Pasuritë e identifikuara dhe ato në proces identifikimi, paraqesin të dhënat për strukturat akomoduese dhe të shërbimit, ndërkaq ende nuk ka filluar puna për identifikimin dhe evidentimin e situatës së zonave bregdetare të hedhura në sistemin e regjistrimit fillestar. |
| **Kriteri:** | VKM Nr. 569, datë 17.07.2019 "Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", në pikën 6.b. |
| **Ndikimi/Efekti** | Zona bregdetare nuk është menaxhuar në mënyrë të integruar |
| **Shkaku** | Mungesë bashkëpunimi me institucionet e tjera |
| **Rëndësia** | E Mesme |
| **Rekomandim** | Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa për plotësimin e hartave sipas numrit të pasurive të strukturave akomoduese dhe të shërbimit dhe të rakordojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, mbi situatën e zonave bregdetare të hedhura në sistemin e regjistrimit fillestar, si dhe t'i kërkojë bashkive bregdetare statusin e regjistrimit të pasurive publike, përfshirë ato të transferuara, me qëllim krijimin e një inventari të zonës së bregdetit. |

**Në zbatim të pikës 4** "Mbi auditimin e procedurave të ndjekura për dhënien në përdorim dhe administrim të plazheve publike dhe private" u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhi.

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që;**
Në bazë të Vendimit Nr.1172, datë 24.12.2020 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.171, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" të ndryshuar, Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA) është autoriteti që shqyrton aplikimet për ushtrimin e veprimtarive si stacione plazhi. Ngritja dhe mënyra e funksionimit të GTSHA-së miratohet me urdhër ministri. Referuar e-malit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, për sezonin turistik veror 2021, Grupi Teknik i Shqyrtimit te Aplikimeve, ka funksionuar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
Referuar Urdhrit nr.39, datë 27.01.2022 të Ministrit të Mjedisit, për vitin 2022 është ngritur GTSHA-ja me përbërje si më poshtë:

1.L. L.-Kryetar (Agjencia Kombëtare e Bregdetit )
2.G.A.-Anëtar (Agjencia Kombëtare e Bregdetit )

3.E. D.-Anëtare (Agjencia Kombëtare e Bregdetit)
4.B. K.-Anëtare (Agjencia Kombëtare e Bregdetit )
5.L. V.-Anëtare ( Agjencia Kombëtare e Bregdetit )
Me urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr.114, datë 29.03.2022, anëtarja e GTSHA-së znj. B. K. është zëvendësuar me znj. K.J.

Në datën 28.01.2022, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka bërë njoftim në web[1], se janë hapur aplikimet për stacionet e plazhit. Sipas njoftimit, aplikimet kanë qenë të hapura për 30 ditë, nga data 28.01.2022 deri në datën 27.02.2022.
Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit , për vitin 2022, grupi teknik i shqyrtimit të aplikimeve (GTSHA) ka shqyrtuar 974 aplikime (ose 748 subjekte) për stacion plazhi, nga të cilat:

- **693 aplikime (ose 529 subjekte)** kanë kaluar në statusin e kualifikimit paraprak;
- **279 aplikime (ose 217 subjekte)** janë refuzuar;
- **2 aplikime (ose 2 subjekte)** janë anuluar.

Në përfundim të procesit për shqyrtimin e aplikimeve për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi për subjektet që kanë marrë statusin e kualifikimit paraprak, GTSHA identifikoi se nga **693** aplikime për stacione plazhi të cilat kanë marrë kualifikimin paraprak, situata paraqitet si më poshtë:

- **613 aplikime (ose 462 subjekte)** janë kualifikuar përfundimisht;
- **80 aplikime (ose 67 subjekte)** janë kualifikuar paraprakisht, por nuk kanë vijuar me fazën e dytë (ngarkimin në sistemin e-Albania pagesën e detyrimit në bashki, si dhe planëvendosjen për sipërfaqen e miratuar të stacionit të plazhit) me qëllim marrjen e kualifikimit përfundimtar.

Aplikimet e subjekteve, për ushtrimin e stacioneve të plazheve janë kryer nëpërmjet sistemit online e-Albania.
Nga grupi i auditimit u përzgjodhën procedurat e dhënies së mendimit për subjektet si më poshtë;

**1.Subjekti S. D.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë " stacion plazhi ", me vendndodhje në Plazhi Vila Bashtovë, Kavajë, parcela RR-76. Subjekti operon me një strukturë shërbimi të ndodhur në plazhin Spille. Sipërfaqja e marrë me qira 1359 m2 .
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit/kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.852 prot., datë 18.05.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Mungon plani i operimit sipas formatit të kërkuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1172, datë 24.12.2020;
-Kontrata e punës e firmosur ndërmjet subjektit dhe vrojtuesit të plazhit, përcakton se vrojtuesi ka një ditë pushim në javë. Mungon një vetëdeklarim i subjektit, se një ditë në javë nuk do punojë.

**2.Subjekti A. B.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në Durrës. Subjekti operon me një strukturë

[1] https://turizmi.gov.al/njoftim-per-ushtrimin-e-veprimtarise-si-stacion-plazhi-3

shërbimi të ndodhur në Katund i Ri. Sipërfaqja e marrë me qira 1805 m2,(parcelat DR-208, DR-209, DR-210, DR-211, DR-212, DR-213).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit/kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1318 prot., datë 28.06.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-**Plani i operimit nuk është plotësuar sipas fushave përkatëse (rubrika plani i masave higjieno-sanitare nuk është plotësuar);
-Mungon certifikata e vrojtuesit. Subjekti ka bashkëngjitur kartën e vrojtuesit (E.D.).

**3.Subjekti Gj. N.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë " stacion plazhi ", me vendndodhje në Durrës.
Subjekti operon me një strukturë shërbimi të ndodhur në Katund i Ri, Durrës. Sipërfaqja e marrë me qira 1200 m2, (parcelat DR-164, DR-165, DR-166, DR-167).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1310 prot., datë 27.06.2022.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Në ekstraktin e QKB-së, subjekti ka si aktivitet shërbime kundrejt ndërmarrjeve dhe individëve (vendi i ushtrimit të aktivitetit makinë lëvizëse Toyata në Durrës).

**4.Subjekti B.N.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në Vlorë. Subjekti operon me një strukturë shërbimi të ndodhur në plazhin Radhimë. Sipërfaqja e marrë me qira 200 m2, (parcela VL-276).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1452 prot., datë 07.07.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Mungojnë fotografi të stacionit të plazhit në raport më strukturën akomoduese;
-Kontrata e qirasë nuk është e firmosur nga përfaqësues të bashkisë Vlorë.

**5.Subjekti A. I. (Hotel E.)** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në Radhimë. Subjekti operon me një strukturë shërbimi të ndodhur në plazhin Radhimë. Sipërfaqja e marrë me qira 200 m2, (parcela VL-182) .
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1095 prot., datë 03.06.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Mungojnë fotografi të stacionit të plazhit në raport me strukturën e shërbimit;
-Kontrata nuk është e firmosur nga përfaqësues të bashkisë Vlorë.
**6.Subjekti R. M. (**B.) ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në Vlorë. Subjekti operon me një strukturë shërbimi të ndodhur në plazhin e Nartës. Sipërfaqja e marrë me qira 750 m2, (parcela VL-42).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.478 prot., datë 22.04.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

-Kontrata e punës e firmosur ndërmjet subjektit dhe vrojtuesit të plazhit, përcakton se vrojtuesi ka dy ditë pushim në javë. Mungon një vetëdeklarim i subjektit, se dy ditë në javë nuk do punojë;
-Kontrata e qirasë nuk është e firmosur nga përfaqësues të bashkisë Vlorë.
**7.Subjekti G. (Hotel P.)** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në bashkinë Vlorë. Subjekti operon me një strukturë akomoduese të ndodhur në plazhin Lungomare. Sipërfaqja e marrë me qira 600 m2, (parcelat VL-97-98).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.655 prot., datë 05.05.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Mungojnë fotografi të stacionit të plazhit në raport me strukturën akomoduese;
-Kontrata e qirasë nuk është e firmosur nga përfaqësues të bashkisë Vlorë;
-Nga verifikimi në google earth, subjekti është larg nga stacioni i plazhit.

**8.Subjekti E. M.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në bashkinë Vlorë. Subjekti operon me një strukturë shërbimi të ndodhur në plazhin e Nartës. Sipërfaqja e marrë me qira 300 m2, (parcela VL-30) .
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka lidhur nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.402 prot., datë 12.04.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Planëvendosja e njësisë vendore nuk është e firmosur sipas normave teknike-ligjore të arkivave (ka vetëm firmë nëpunësi, ska emër dhe mbiemër të personit përgjegjës);
-Kontrata e qirasë nuk është e firmosur nga përfaqësues të bashkisë Vlorë.

**9.Subjekti L. D.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në Vlorë. Subjekti operon me një strukturë shërbimi të ndodhur në plazhin e vjetër , Vlorë. Sipërfaqja e marrë me qira 500 m2, (parcela VL-77).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1433 prot., datë 06.07.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Kontrata e punës e firmosur ndërmjet subjektit dhe vrojtuesit të plazhit, përcakton se vrojtuesi ka një ditë pushim në javë. Mungon një vetëdeklarim i subjektit, se një ditë në javë nuk do punojë;
-Kontrata e qirasë nuk është e firmosur nga përfaqësues të bashkisë Vlorë.
**10.Subjekti E. C.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-Albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë " stacion plazhi ", me vendndodhje në Pogradec. Subjekti operon me një strukturë shërbimi në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit të ndodhur në plazhin e Pogradecit. Sipërfaqja e marrë me qira 150 m2, (parcela PG-30). .
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1244 prot., datë 21.06.2022
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Relacioni teknik nuk është i firmosur;

-Subjekti nuk ka bashkëngjitur Vendimin me kusht të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (Urdhri i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, nr.38, datë 27.01.2022, pika 1, gërma dh);
-Mungon certifikata përkatëse e kualifikimit të vrojtuesit (O. P.).
**11.Subjekti P. D.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë " stacion plazhi ", me vendndodhje në bashkinë Durrës. Subjekti operon me një strukturë shërbimi të ndodhur në katundin e ri. Sipërfaqja e marrë me qira 600 m2, (parcelat DR-275; DR-276).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1439 prot., datë 07.07.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Mungojnë fotografi të strukturës së shërbimit në raport me stacionin e plazhit.
**12.Subjekti D. T.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në fshatin Spille, Kryevidh. Subjekti operon me një strukturë shërbimi të ndodhur në plazhin Spille. Sipërfaqja e marrë me qira 1904 m2, (parcela RR-17).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.750 prot., datë 11.05.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Subjekti ka detyrime tatimore;
-Në deklaratën e punës me vrojtuesin dhe subjektin, përcaktohet se orari i punës së vrojtuesit është 6 orë në ditë (mungon një vetëdeklarim i subjektit që do të punojë për 6 orë në ditë);
-Mungon certifikata e kualifikimit të vrojtuesit (O. Z.).

**13.Subjekti R-A.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në Kepi i Rodonit. Subjekti operon me një strukturë shërbimi të ndodhur në plazhin Kepi i Rodenit. Sipërfaqja e marrë me qira 1000 m2, (parcela DR-3).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1196 prot., datë 13.06.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**-**Kontrata e punës e firmosur ndërmjet subjektit dhe vrojtuesit të plazhit, përcaktohet se vrojtuesi ka dy ditë pushim në javë. Mungon një vetëdeklarim i subjektit, se dy ditë në javë nuk do punojë.
**14.Subjekti K. B.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në rruga nacionale "Vlorë-Orikum", Radhimë. Subjekti operon me një strukturë akomoduese të vijës së parë të ndodhur në plazhin e Radhimës. Sipërfaqja e marrë me qira 363 m2, (parcela VL-185).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.391 prot., datë 11.04.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Plani i operimit nuk është sipas formatit të kërkuar;
-Mungojnë fotografi të strukturës akomoduese në raport me stacionin e plazhit;
-Kontrata e qirasë nuk është e firmosur nga përfaqësues të bashkisë Vlorë.
**15.Subjekti E. Rr.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në bashkinë Divjakë. Subjekti operon me një

strukturë shërbimi të ndodhur në Divjakë. Sipërfaqja e marrë me qira 500 m2, (parcela DJ-23)..
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.2141 prot., datë 19.08.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Mungojnë fotografi të strukturës së shërbimit në raport me stacionin e plazhit;
-Kontrata e punës e firmosur ndërmjet subjektit dhe vrojtuesit të plazhit, përcakton se vrojtuesi ka dy ditë pushim në javë. Mungon një vetëdeklarim i subjektit, se dy ditë në javë nuk do punojë.
-Mungon certifikatë e kualifikimit të vrojtuesit (L. A.).

**16.Subjekti H. M.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-Albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në rruga "e Pulëbardhave", Ksamil, Sarandë. Subjekti operon me një strukturë shërbimi të ndodhur në plazhin Pulëbardha. Sipërfaqja e marrë me qira 409 m2, (parcelat SR-72).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.838 prot., datë 17.05.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Mungojnë fotografi të stacionit të plazhit në raport me strukturën e shërbimit;
-Kontrata e punës e firmosur ndërmjet subjektit dhe vrojtuesit të plazhit, përcakton se vrojtuesi ka dy ditë pushim në javë. Mungon një vetëdeklarim i subjektit, se dy ditë në javë nuk do punojë.
-Kontrata e punës me vrojtuesin (M. M.) nuk është e noterizuar.
**17.Subjekti Q. I.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-Albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në Durrës. Subjekti operon me një strukturë shërbimi në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit të ndodhur në plazhin Durrës, Plazh. Sipërfaqja e marrë me qira 1119 m2, (parcelat DR-566, DR-567).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1142 prot., datë 09.06.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Mungojnë fotografi të strukturës së shërbimit që do të ndërtohet (dokumenti i AZHT);
-Kontrata e punës e firmosur ndërmjet subjektit dhe vrojtuesit të plazhit, përcakton se vrojtuesi ka dy ditë pushim në javë. Mungon një vetëdeklarim i subjektit, se dy ditë në javë nuk do punojë.
**18.Subjekti L. G.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi ", me vendndodhje në plazhin Rrashbull, Durrës. Subjekti operon me një strukturë shërbimi të ndodhur në plazhin Rrashbull. Sipërfaqja e marrë me qira 1204 m2, (parcelat DR-710,DR-711,DR-712,DR-713).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1150 prot., datë 09.06.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi**
-Mungojnë fotografi të strukturës së shërbimit në raport me stacionin e plazhit;
-Subjekti ka aplikuar si strukturë akomoduese por kontrata është dhënë si strukturë shërbimi (plani i operimit nuk është plotësuar sipas kontratës së firmosur);
-Nga verifikimi në gogle earth, subjekti rezulton larg nga stacioni i plazhit.
**19.Subjekti P. V.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në Katund i Ri, Durrës. Subjekti operon me

një strukturë shërbimi të ndodhur në Katund i Ri. Sipërfaqja e marrë me qira 1800 m2, (parcela DR-259;DR-260;DR-261;DR-262; DR-263;DR-264;DR-265).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka lidhur nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1262 prot., datë 23.06.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Mungojnë fotografi të strukturës së shërbimit në raport me stacionin e plazhit.
**20.Subjekti A. A.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi ", me vendndodhje në rruga "Lagjia nr.13", rruga "Pavarësia", Durrës. Subjekti operon me një strukturë akomoduese të ndodhur në plazhin Durrës, Plazh. Sipërfaqja e marrë me qira 530 m2, (parcelat DR-399;DR-400; DR-401).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.698 prot., datë 09.05.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Subjekti ka aplikuar si strukturë shërbimi në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit por e ka firmosur kontratën si strukturë akomoduese (plani i operimit nuk përputhet me kontratën e firmosur);
-Mungojnë fotografi të strukturës akomoduese në raport me stacionin e plazhit.
**21.Subjekti G. K.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-Albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në Lagjia Nr.13, Durrës. Subjekti operon me një strukturë shërbimi të ndodhur në plazhin Durrës, Plazh. Sipërfaqja e marrë me qira 394 m2, (parcelat DR-365, DR- 366, DR-367, DR-368)
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.917 prot., datë 23.05.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Subjekti ka aplikuar si strukturë akomoduese por e ka marrë si strukturë shërbimi( plani i operimit i plotësuar nga subjekti nuk përputhet me kontratën e firmosur);
-Plani i operimit flet për sezonin turistik për vitin 2021, ndërsa aplikimi është për ushtrimin e stacionin e stacioneve të plazhit për vitin 2022;
-Mungojnë fotografi të stacionit të plazhit në raport me strukturën e shërbimit.
**22.Subjekti G. B. F.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë " stacion plazhi ". Subjekti operon me një strukturë akomoduese e vijës së parë të ndodhur në plazhin Rrashbull. Sipërfaqja e marrë me qira 1231 m2, (parcelat DR-809, DR-810).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1053 prot., datë 01.06.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**--**Kontrata e punës e firmosur ndërmjet subjektit dhe vrojtuesit të plazhit, përcakton se vrojtuesi ka dy ditë pushim në javë. Mungon një vetëdeklarim i subjektit, se dy ditë në javë nuk do punojë**.**
**23.Subjekti H. V. B. 2.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë " stacion plazhi ", me vendndodhje në fshatin Rashbull , Lagjja Nr.1, Durrës. Subjekti operon me një strukturë akomoduese të ndodhur në plazhin Rrashbull, Plazh. Sipërfaqja e marrë me qira 547 m2, (parcelat DR-707, DR-708).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1071 prot., datë 02.06.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Mungojnë fotografi të strukturës akomoduese në raport me stacionin e plazhit;

-Nga verifikimi në google earth rezulton se subjekti është larg nga stacioni i plazhit.

**24.Subjekti H. V.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në Plazh, Apollonia, Lagjia 13, Durrës. Subjekti operon me një strukturë akomoduese e vijës së parë të ndodhur në plazhin Apolonia , Plazh. Sipërfaqja e marrë me qira 1500 m2, (parcela DR-380).

Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1051 prot., datë 01.06.2022.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

-Nga verifikimi në google earth, rezulton se subjekti është larg nga stacioni i plazhit.

**25.Subjekti V. H.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në Lagjja Nr.13, Durrës. Subjekti operon me një strukturë shërbimi të ndodhur në plazhin Durrës, Plazh. Sipërfaqja e marrë me qira 327 m2, (parcela DR-482).

Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.1046 prot., datë 31.05.2022.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

-Mungojnë fotografi të stacionit të plazhit në raport me strukturën e shërbimit;

-Nga verifikimi në google earth, rezulton se subjekti është larg nga stacioni i plazhit.

**26.Subjekti S. K.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në Qeparo, Vlorë. Sipërfaqja e stacionit të plazhit është 700 m2. Subjekti operon me një strukturë akomoduese e vijës së parë të ndodhur në Qeparo, (parcelat HI-177, HI-178).

Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.611 prot., datë 04.05.2022.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

-Mungon certifikata e kualifikimit të vrojtuesit (A. Gj.);

-Nga verifikimi në google earth, rezulton se subjekti është në distancë nga stacioni i plazhit.

**27.Subjekti S. B. H.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë " stacion plazhi ", me vendndodhje në Livadh. Sipërfaqja e stacionit të plazhit është 300 m2. Subjekti operon me një strukturë shërbimi në plazhin Livadh, (parcela HI-120).

Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.652 prot., datë 05.05.2022.

Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:

-Në planin e operimit, subjekti ka plotësuar të dhëna mbi strukturën e shërbimit në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit, është miratuar si strukturë shërbimi ( plani i operimit nuk është plotësuar sipas kontratës së qirasë);

-Mungojnë fotografi të strukturës së shërbimit në raport me stacionin e plazhit. Subjekti në ekstraktin e QKB-së e ka shtuar si adresë vendndodhjen e stacionit të plazhit në datë 12.08.2022, ndërsa aplikimi është bërë në datën 14.02.2022 , lidhja e kontratës është në datën 05.05.2022**;**

-Kontrata e punës e firmosur ndërmjet subjektit dhe vrojtuesit të plazhit, përcakton se vrojtuesi ka dy ditë pushim në javë. Mungon një vetëdeklarim i subjektit, se dy ditë në javë nuk do punojë.

**28.Subjekti I. H.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë " stacion plazhi ", me vendndodhje në plazhin e Tales, Lezhë. Subjekti operon me një strukturë shërbimi. Sipërfaqja është 480 m2, (parcelat LE-500, LE-501).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.524 prot., datë 27.04.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
- Nuk ka plan operimi;
-Mungojnë fotografi të subjektit, fotografi të strukturës së shërbimit me raport me strukturën e plazhit;
- planvendosja nuk është e specifikuar për subjektin.
**29. Subjekti D. P.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë " stacion plazhi ", me vendndodhje në plazhin e Tales, Lezhë. Subjekti operon me një strukturë shërbimi në brezin e shërbimeve të plazhit. Sipërfaqja është 953 m2, (parcelat LE-527).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës, me nr.2125 prot., datë 22.08.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Kontrata e punës e firmosur ndërmjet subjektit dhe vrojtuesit të plazhit, përcakton se vrojtuesi ka dy ditë pushim në javë. Mungon një vetëdeklarim i subjektit, se dy ditë në javë nuk do punojë.
-Mungon relacioni përkatës;
-Mungon vendimi paraprak i miratuar i Këshillit Kombëtar të Territorit;
-Plani i operimit nuk është plotësuar për rubrikën strukturë shërbimi në brezin e shërbimeve të stacionit te plazhit;
-planvendosja nuk specifikon subjektin aplikuar.
**30. Subjekti F.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë " stacion plazhi ", me vendndodhje në Lezhë. Subjekti operon me një strukturë shërbimi. Sipërfaqja është 111 m2, (parcela LE-289).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Në ekstraktin e QKB-së, fusha e veprimtarisë së subjektin nuk përfshin aktivitetin "bar-kafe";
-Rezulton debitor në tatime;
-Mungojnë fotografi të strukturës së shërbimit në raport me stacionin e plazhit;
-Në planvendosjen e miratuar nuk specifikohet subjekti.
**31. Subjekti Sh.L.** ka aplikuar në portalin qeveritar e-albania për tu pajisur për ushtrimin e veprimtarisë "stacion plazhi", me vendndodhje në Fier. Subjekti operon me një strukturë shërbimi. Sipërfaqja është 200 m2, (parcela FR-76).
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka nënshkruar kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit /kontratë qiraje me subjektin përkatës.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
-Subjekti deklaron në planin e operimit 13 tavolina (numri minimal duhet të jetë 20 tavolina);
-Plani i operimit nuk është plotësuar në përputhje me kontratën e qirasë, (në plan operimi është përshkruar strukturë shërbimi në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit, ndërsa është miratuar si strukturë shërbimi).
Nga grupi i auditimit u përzgjodhën disa prej subjekteve, që janë refuzuar nga Agjencia

Kombëtare e Bregdetit për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit.

| Nr. rendor | Subjekti | Arsyeja e refuzimit nga AKB |
|---|---|---|
| 1. | M. S. | Aplikimi është refuzuar pasi nuk është identifikuar struktura e shërbimit me të cilën aplikoni. |
| 2. | B. P. | Aplikimi është refuzuar, pasi struktura me të cilën operohet është shumë larg nga stacioni i plazhit. |
| 3. | F. sh.p.k | Aplikimi është refuzuar, pasi struktura me të cilën operohet është shumë larg nga stacioni i plazhit. |
| 4. | G. C. | Aplikimi është refuzuar pasi aplikimi nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në VKM |
| 5. | G. sh.p.k | Aplikimi për parcelën KJ-101 është refuzuar , pasi është miratuar aplikimi për parcelat KJ-99 dhe KJ-100,vetëm për hapësirën e plazhit pranë strukturës së shërbimit me të cilën aplikoni. |
| 6. | B. L. | Aplikimi është refuzuar , pasi struktura me të cilën operohet është shumë larg nga stacioni i plazhit për të cilën aplikoni |

*Punoi: Grupi i Auditimi*

**-Për sa më lart, nga auditimi u konstatua:**

1. Disa prej aplikimeve (G., S. K., V. H., Hotel V. B. 2. etj) që janë miratuar për ushtrimin e veprimtarisë si stacioneve të plazhit nuk janë afër me stacionet e plazhet, kjo në kundërshtim me Vendimin Nr. 1172, datë 24.12.2020, pika 7/a përcakton se; "*Përzgjedhja e subjekteve për lidhjen e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve bëhet sipas prioritetit të mëposhtëm:*

*a) Subjekti të disponojë një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi pranë strukturës akomoduese".*

Verifikimet e mësipërme u kryen nëpërmjet programit kompjuterik google earth, pasi Agjencia Kombëtare e Bregdetit nuk ka miratuar një rregullore sesi bëhet verifikimi i subjekteve përpara miratimit përkatës në portalin e-Albania.

1.1.Disa prej aplikimeve për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit ( kërkesa të miratuara) mungojnë;

-foto të strukturave të shërbimeve, të strukturave akomoduese në raport me stacionin e plazheve , kjo në kundërshtim me Vendimin nr.1172, datë 24.12.2020 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.171, datë 27.03.2019 të Këshillit të Ministrave " Për miratimin e rregullores " Për miratimin e rregullores " Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" të ndryshuar", pika 9/c përcakton se ;

*c) foto të jashtme të qarta të strukturës akomoduese/së shërbimit, të cilat të identifikojnë strukturën akomoduese/e shërbimit në raport me hapësirën e plazhit, si dhe foto të qarta të hapësirës së plazhit për të cilën aplikohet;*

-plani i operimit nuk është sipas formatit të kërkuar, kjo në kundërshtim me Vendimin nr.1172, datë 24.12.2020 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.171, datë 27.03.2019 të Këshillit të Ministrave " Për miratimin e rregullores " Për miratimin e rregullores " Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" të ndryshuar", pika 9/b përcakton se;

*b)plani i operimit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi dhe strukturë shërbimi, sipas rastit, sipas formatit të publikuar online;*

2.Kontratat e qirasë të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e stacioneve të plazhit në bashkinë e Vlorës nuk janë firmosur nga përfaqësues të bashkisë Vlorë, kjo në kundërshtim me Vendimin Nr. 1172, datë 24.12.2020, pika 10/c/iii përcakton se;

*"pas plotësimit të dokumentacionit shtesë si më sipër, GTSHA-ja miraton në portalin e-Albania aplikimin përkatës dhe AKB-ja njofton menjëherë subjektin dhe NJVV-në për nënshkrimin e kontratës sipas formatit tip bashkëlidhur këtij vendimi".*

3. Disa prej subjekteve që ushtrojnë stacione plazhe ( kërkesa të miratuara) , në deklaratën noteriale të punës të firmosur nga subjekti dhe vrojtuesit e plazhit specifikohet 1-2 ditë pushim në javë. Nga ana e subjektit nuk është paraqitur një kontratë e dytë me vrojtues/deklaratë noteriale se nuk do të punojë për aq ditë që vrojtuesi ka pushim.
4.Ministrja e Mjedisit dhe Turizmit ka hapur thirrje për subjektet për të kryer aplikim për stacion plazhi nga data 28.01.2022-27.02.2022. Deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e GTSHA është nënshkruar në datë 31.01.2022, ndërsa sipas urdhërit nr.39, datë 27.01.2022 të ministrit të mjedisit " Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të grupit Teknik të shqyrtimit të aplikimeve (GTSHA)për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit , si dhe për vendosjen e strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve ne brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit, pika 10 përcakton se "*anëtarët e GTSHA, pasi janë njohur me subjektet aplikuese në portalin e-Albania , para shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, nënshkruajnë paraprakisht, një deklaratë ku deklarojnë nëse kanë apo jo konflikte interesi me subjektet që do vlerësohen prej tyre. Deklarata do të jetë sipas modelit bashkëlidhur këtij urdhëri"*. Për sa më lart, deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e Grupit Teknik të Shqyrtimit të Aplikimeve( GTSHA), është nënshkruar para së të mbyllen aplikimet për stacionet e plazhit.
5.Disa prej aplikimeve që janë miratuar për ushtrimin e stacioneve të plazhit rezultojnë debitorë, kjo në kundërshtim me Vendimin Nr.827, datë 24.12.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.171, datë 27.03.2019 të Këshillit të Ministrave "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit " të ndryshuar " pika 4/ii/1 ku përcakton se ;
*"vërtetimin nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore".*

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetjes** | Kërkesat për stacionet e plazhit janë miratuar me mangësi në dokumentacion. |
| **Situata:** | Nga auditimi i kontratave për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturë shërbimi janë konstatuar mangësi në elementët dhe dokumentacionin e nevojshëm, në dosje si vijon:<br>Në 9 raste, aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë për stacione plazhi janë miratuar me plan operimi që nuk është sipas formatit të publikuar online dhe nuk janë plotësuar nga subjekti sipas rubrikave të kërkuara;<br>Në 16 raste, nuk janë paraqitur fotografi të strukturës së shërbimit/ strukturës akomoduese në raport me stacionin e plazhit;<br>Në 5 raste , aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë për stacione plazhi janë miratuar pa certifikatat e kualifikimit të vrojtuesve;<br>Në 2 raste, subjekti rezulton debitor në tatime;<br>Në 2 raste, subjekti nuk ka të regjistruar aktivitetin " strukturë shërbimi/strukturë akomoduese " në ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit. |
| **Kriteri:** | Vendim Nr.1172, datë 24.12.2020 " Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.171, datë 27.03.2019 të Këshillit të Ministrave " Për miratimin e rregullores " Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit " të ndryshuar, Neni 9, pika b, c. |
| **Ndikimi/Efekti** | Parregullsi në miratimin e kontratave të qirasë për ushtrimin e veprimtarive të stacionit të plazhit. |
| **Shkaku** | Moszbatim i kritereve për dhënien me qira të stacioneve të plazhit |

| | |
|---|---|
| **Rëndësia** | E Lartë |
| **Rekomandim** | Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit të marrë masa që të shqyrtojë aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit, në respektim të kritereve dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi, duke përfshirë kontrollin e rregullshmërisë nga pikëpamja ligjore e dokumentacionit. |

| **Titulli i gjetjes** | Kontratat e punës mes subjekteve dhe vrojtuesve |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi i kontratave për ushtrimin e stacioneve të plazhit janë konstatuar se në 9 raste , në kontratat e punës ndërmjet subjekteve dhe vrojtuesve të plazhit, është përcaktuar se vrojtuesit kanë 1-2 ditë pushim në javë. Në këto raste mungon një vetëdeklarim i subjektit, se nuk do ta ushtrojë veprimtarinë përgjatë gjithë ditëve të javës. |
| **Kriteri:** | Vendimin Nr.171, datë 27.03.2019 të Këshillit të Ministrave " Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit ", pika 8, germa b |
| **Ndikimi/Efekti** | Subjektet nuk kanë garantuar shërbimin me vrojtues plazhi, përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të veprimtarisë si stacione plazhi. |
| **Shkaku** | Mungesë njohjeje e legjislacionit në fuqi |
| **Rëndësia** | E Lartë |
| **Rekomandim** | Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa, që para nënshkrimit të kontratës subjekti duhet të paraqesë; marrëveshjen e noterizuar me vrojtuesit e plazhit, së bashku me një vetëdeklarim për kohëzgjatjen e punës, si dhe ditët e javës që do të ushtrojë aktivitetin si stacion plazhi. |

| **Titulli i gjetjes** | Mungesë bashkëpunimi me Bashkinë Vlorë për nënshkrimin e kontratës |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi i kontratave për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturës së shërbimit janë konstatuar se në 7 raste , kontratat e formatit tip të qirasë nuk janë firmosur nga përfaqësues të Bashkisë së Vlorës. |
| **Kriteri:** | Vendimi Nr.1172, datë 24.12.2020 " Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.171, datë 27.03.2019 të Këshillit të Ministrave " Për miratimin e rregullores " Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit " të ndryshuar, Neni 9, pika iii. |
| **Ndikimi/Efekti** | Mungesë bashkëpunimi me bashkinë Vlorë për dorëzimin e hapësirave të plazhit. |
| **Shkaku** | Mungesë bashkëpunimi me bashkinë Vlorë |
| **Rëndësia** | E mesme |
| **Rekomandim** | Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që të njoftojë në rrugë shkresore të gjitha njësitë vendore për nënshkrimin e kontratave për ushtrimin e veprimtarive si stacione plazhi. |

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetjes** | Kërkesat e strukturave të shërbimit/strukturave akomoduese janë miratuar në distancë të madhe nga stacioni i plazhit |
| **Situata:** | Nga auditimi i kontratave për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturës së shërbimit janë konstatuar 7 raste që janë në distancë prej stacioneve të plazhit (distancë që varion 1 km, 800 m. etj) .Ndërkohë për të njëjtën situatë objektive, nga ana e Grupit Teknik të Shqyrtimit të Aplikimeve janë refuzuar 4 subjekte ( tabela e mësipërme e përpunuar nga grupi i Auditimit). |
| **Kriteri:** | Vendim Nr.1172, datë 24.12.2020 " Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.171, datë 27.03.2019 të Këshillit të Ministrave " Për miratimin e rregullores " Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit " të ndryshuar, Neni 9, pika iii |
| **Ndikimi/Efekti** | Mungesë transparence dhe barazie në vendimmarrjet e Grupit Teknik të Shqyrtimit të Aplikimeve. |
| **Shkaku** | Moszbatim i kritereve për dhënien me qira të stacioneve të plazhit. |
| **Rëndësia** | E Lartë |
| **Rekomandim** | Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që ti shqyrtojë aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit në mënyrë transparente, duke i trajtuar të gjithë subjektet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. |

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetjes** | Mungesë e deklaratës së konfliktit të interesit |
| **Situata:** | Nga auditimi i kontratave për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturës së shërbimit është konstatuar se, anëtarët e Grupit Teknik të Shqyrtimit të Aplikimeve nuk kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në momentin e mbylljes së aplikimeve. |
| **Kriteri:** | Urdhri nr.39, datë 27.01.2022 të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit " Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të grupit Teknik të shqyrtimit të aplikimeve (GTSHA)për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit , si dhe për vendosjen e strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit, pika 10. |
| **Ndikimi/Efekti** | Nuk garantohet një proces i paanshëm |
| **Shkaku** | Mungesë koordinimi dhe njohje |
| **Rëndësia** | E mesme |
| **Rekomandim** | Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masat që anëtarët e komisionit të shqyrtimit të aplikimeve të përpilojnë deklaratat e konfliktit të interesit në momentin e fillimit të procesit të shqyrtimit të aplikimeve për ushtrimin e veprimtarive të stacionit të plazhit. |

**Trajtimi i observacioneve**

Me shkresën me nr.779/2 prot., datë 03.10.2023, protokolluar në KLSH me nr.561/1 prot., datë 05.10.2023, Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka dërguar observacionet si vijon:

**-Pretendimet e subjektit:**

Lidhur me kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë stacion plazhi, aplikimi i secilit subjekt është bërë nga GTSHA , bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga secili subjekt aplikues.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**
Lidhur me pretendimin e pikës 1, pas shqyrtimit të observacioneve të bëra më sipër, sqarojmë se grupi i auditimit i merr pjesërisht në konsideratë dokumentacionin e paraqitur dhe u reflektuan në Projekt Raport. Ndërsa një pjesë e dokumentacionit të bashkëngjitur në observacione nga GTSHA, nuk janë sipas kërkesave ligjore, referuar VKM nr. 1172, datë 24.12.2020.
*Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:*
1.L. L.-Kryetar i GTSHA (Agjencia Kombëtare e Bregdetit );
2.G. A.-Anëtar i GTSHA (Agjencia Kombëtare e Bregdetit );
3.E. D.-Anëtare e GTSHA (Agjencia Kombëtare e Bregdetit);
4.B. K.-Anëtare e GTSHA (Agjencia Kombëtare e Bregdetit );
5.L. V.-Anëtare e GTSHA ( Agjencia Kombëtare e Bregdetit ) ;

***Në zbatim të pikës 5.*** *"Mbi kryerjen e monitorimeve, inspektimeve, dhe zbatimin e procedurave për shkeljet e konstatua,*

Nga auditimi u konstatua se:
**-**Në total nga Drejtoria për Sigurimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit dhe Zonave Bregdetare, gjate vitit 2021 janë kryer 1824 kontrolle, nga të cilat 833 me karakter informues, monitoruar 751 stacione plazhi ,50 inspektime nga të cilat në 13 raste janë marre masa administrative me gjobë si dhe 27 Paralajmërim ndaj subjekteve, si dhe 426 verifikime për strukturat akomoduese nga lista e venë në dispozicion nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**.**

***Monitorimet dhe kontrollet e kryera në vitin 2021***
***Për vitin 2021,*** Drejtoria e Inspektimit, monitorimit pranë AKB-së, ka kryer monitorimin e stacioneve të plazhit si dhe inspektime mbi plotësimin e kritereve dhe standardeve. Ka kryer verifikimin e dorëzimit të dokumentacionit për strukturat Akomoduese **pas pajisjes me certifikatë kategorizimi**, nga të cilta; 426 Verifikime në Strukturat Akomoduese (hotele), me objekt "për pajisjen me certifikatë kategorizimi",**751** monitorime për stacionet e plazhit **në 949** parcela për gjatë vijës bregujore, mbi plotësimin e kritereve dhe standardeve të përcaktuara sipas VKM-së, ,pasqyruar në tabelat emërtuar: ***Stacione Plazhi, Monitorime 2021***

**Tabela me monitorime stacione plazhi**

| Nr. | Bashkia | Subj. te monitoruara | Konstatime |
|---|---|---|---|
| 1 | Durrës | 122 | Ka 111 kulla vrojtimi |
| 2 | Kavajë | 73 | Ka 67 kulla vrojtimi |
| 3 | Rrogozhine | 39 | Ka 38 kulla vrojtimi |
| 4 | Lezhe | 40 | Ka 40 kulla vrojtimi |
| 5 | Pogradec | 41 | Ka 35 kulla vrojtimi |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 6 | Divjake | 16 | Ka 15 kulla vrojtim |
| 7 | Shkoder | 43 | Ka 41 kulla vrojtimi |
| 8 | Fier | 42 | Ka 35 kulla vrojtimi |
| 9 | Vlore | 97 | Ka 95 kulla vrojtimi |
| 10 | Sarandë | 89 | Ka 85 kulla vrojtimi |
| 11 | Himarë | 149 | Ka 115 kulla vrojtimi |
| | **Totali** | **751** | |

***Burimi D**rejtoria për Sigurimin dhe Zhvillimin e Qëndrueshme të Turizmit dhe Zonave Bregdetare*

**-Verifikimi i dorëzimit të dokumentacionit shtesë nga strukturat Akomoduese, pas pajisjes me certifikatë kategorizimi.**

**a.Auditim mbi kryerjen e** monitorimeve **me tematikë** "Verifikimin e veprimtarisë së strukturat Akomoduese për pajisjen me certifikatë kategorizimi", dokumentacioni i mbajtur, zbatimi i procedurave përkatëse për mangësitë e konstatuara dhe masat e marra këshillime, vënie në dijeni të ministrive dhe brenda me strukturat e AKB-së.

***Për vitin 2021*** inspektorati i AKB ka kryer 426 monitorime m***e urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm*** **nr.38, datë 14.09.2021** me tematikë "Për Verifikimin e strukturave Akomoduese për pajisjen me certifikatë kategorizimi".

Urdhri nr. **38, datë 14.09.2021,** ku përcaktohen: grupi i punës i përbërë nga inspektorët e Drejtorisë për Sigurimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit dhe Zonave Bregdetare, të AKB, periudhën e kryerjes 17.09.2021 deri datë 31/12/2021 dhe objektin e verifikimeve: "Verifikimin e çdo sipërmarrësi turistik qe ushtron veprimtari si strukturë Akomoduese nëse është apo jo i pajisur më certifikatë kategorizimi.

Ky urdhër konstatohet se është në përmbushje të detyrave të AKB-së, sipas Vendimit të Këshilli të Ministrave Nr. 569, datë 17.07.2019, "Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", kreu 3, pika 6, germat *"e","ë", "ç", "d", "dh", "f",* dhe rezulton në përputhje me Ligjin nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, Urdhrit të Ministrit nr. 267, datë 24.07.2019 "Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave Akomoduese".

*Për kryerjen e këtyre monitorimeve janë mbajtur akte verifikime në përmbajtje të cilit përfshihen të dhënat bazë të subjektit dhe informacion nëse ka aplikuar ose jo ( dhe arsyen në këtë rast) pranë MTM-së për pajisjen me certifikate kategorizimi,* në zbatim të Urdhrit të Ministrit nr. 267, datë 24.07.2019 "Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave Akomoduese.

Gjatë vitit 2021 janë verifikuan **426 struktura Akomoduese,** ku janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e paraqitur për pajisjen me certifikatë kategorizimi. Te paraqitura si me poshtë vijon;

Gjatë kësaj periudhe DSZHQTZB ka verifikuar në total **426 (rreth 81%)** subjekte nga lista e vënë në dispozicion prej **526**, duke informuar subjektet mbi plotësimin e dokumentacionit të munguar të nevojshëm pas pajisjes me certifikatën e kategorizimit. Ky proçes ka ndikuar në verifikimin dhe në nxitjen e subjekteve për të plotësuar dokumentacionin e munguar duke

qenë gjithashtu në kontakt të vazhdueshëm institucionin Tabela e mposhtem paraqiten nivel qarqesh me strukturat Akomoduese.

**TabelaSubjektet e verifikuara sipas qarqeve,**

| Qarku | Subjekte ne total per tu verifikuar | Subjektet e verifikuara |
|---|---|---|
| Gjirokaster | 7 | 3 |
| Tirana | 129 | 126 |
| Vlore | 110 | 108 |
| Sarande | 35 | 35 |
| Fier | 5 | 5 |
| Elbasan | 23 | 23 |
| Korce | 51 | 23 |
| Berat | 5 | 5 |
| Lezhe | 32 | 18 |
| Shkoder | 54 | 31 |
| Durres | 57 | 49 |
| Diber | 10 | |
| Kukes | 8 | |
| **Total** | **526** | **426** |

***Burimi ; Burimi D****rejtoria për Sigurimin dhe Zhvillimin e Qëndrueshme të Turizmit dhe Zonave Bregdetare*

**Monitorimi i pajisjes me certifikatë kategorizimi të strukturave Akomoduese dhe zbatimi i kritereve dhe kushteve minimale sipas kategorisë.** Në zbatim të VKM 730, datë 20.10.2016 *"Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave Akomoduese",* të ndryshuar, është miratuar "*Rregullorja për mënyrën, kriteret dhe procedurën për kategorizimin e strukturave Akomoduese"* me Urdhër të Ministrit nr. 267 datë 24.07.2019, sipas së cilës çdo subjekt duhet të plotësojë kriteret e detyrueshme për nivelin më të ulët të sistemit të klasifikimit, nga AKB është realizuar kontrolli i **593** subjekteve me veprimtari strukturë akomoduese përmes mbajtjes së akt verifikimeve.

Si më poshtë paraqiten të dhënat statistikore:

| QYTETI | Subjekte të kontrolluara |
|---|---|
| Tiranë | 178 |
| Lezhë | 82 |
| Berat | 26 |
| Diber | 13 |
| Elbasan | 36 |
| Fier | 16 |
| Gjirokastër | 19 |
| Kavajë | 36 |
| Korçë | 58 |
| Krujë | 7 |
| Permet | 10 |
| Rrogozhinë | 6 |
| Sarandë | 41 |
| Shkodër | 19 |
| Vlorë | 46 |
| TOTAL | 593 |

*Burimi i të dhënave sektori i Inspektimit dhe monitorimit*

Në zbatim të ligjit nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, në zbatim të nenit 4 pika 3 e VKM-së 730, datë 20.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave Akomoduese", i ndryshuar, Urdhër Ministri nr.

267 datë 24.07.2019 i ndryshuar, "Rregullorja për mënyrën, kriteret dhe procedurën për kategorizimin e strukturave Akomoduese", janë realizuar inspektimet e programuara për periudhën shtator – dhjetor në qytetet Tiranë, Elbasan, Berat, Korçë, të subjekteve me veprimtari strukturë Akomoduese .
Si rezultat i këtij procesi janë inspektuan **593** subjekte gjithsej me aktivitet strukturë Akomoduese, lidhur me pajisjen me certifikatë kategorizimi dhe zbatimin i kritereve dhe kushteve minimale sipas kategorizimit. ***Theksojmë se për strukturat Akomoduese, në ligjin "Për turizmin" si dhe në Urdhrin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.*** *267 datë 24.07.2019 i ndryshuar, "Rregullorja për mënyrën, kriteret dhe procedurën për kategorizimin e strukturave Akomoduese",* ***nuk përcaktohen masat administrative për*** **subjektet që gjenden( monitorohen/inspektohen) pa certifikatat e kategorizimit.**

**<u>b. Stacionet e Plazhit</u>**

**Monitorimi i Kushteve dhe Kritereve të Stacioneve të Plazhit,**

Gjatë sezonit turistik 2021 janë monitoruar **751** subjekte që ushtrojnë veprimtarinë si stacion plazhi në 949 parcela përgjatë vijës bregujore, mbi plotësimin e kritereve dhe standardeve të përcaktuara në VKM 171, datë 27.03.2019, i ndryshuar, në Bashkitë Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Pogradec, Fier, Lezhë, Vlorë, Shkodër, Himarë dhe Sarandë.
Në total janë monitoruar 751 subjekte që ushtronin veprimtarinë si stacion plazhi;

- Përsa i përket kushteve të sigurisë, 677 subjekte janë konstatuar të pajisur me pika vrojtimi. Markimin e zonës së notimit e zbatonin si kriter 491 subjekte dhe 151 subjekte plotësonin kriterin lidhur me sinjalizimin për mjetet lundruese (pjesa më e madhe nuk kanë mjete lundruese);
- Përsa i përket kushteve minimale 750 subjekte respektojnë hapësirën midis çadrave 738 janë të pajisur me dushe 660 kanë kabina zhveshjeje dhe 750 kanë kosha për mbeturinat.

Inspektorët e Drejtorisë për Sigurimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit dhe Zonave Bregdetare, kanë informuar dhe ndërgjegjësuar subjektet mbi rëndësinë dhe detyrimin që kanë për të zbatuar me rigorozitet të gjitha kushtet e kriteret e përcaktuara në ligj.
**Nga auditimi rezultoi se : për vitin 2021 ne 38 raste në formatin tip të monitorimit nuk kishte nënshkrim të subjekteve të monitoruar, e cila e bënë të pa mundur nëse është kryer monitorimi në këto subjekte.**
**<u>Monitorimi viti 2022,</u>**
**Monitorime për respektimin e kritereve ligjore.**
**Në total nga DSZHQTZB gjatë vitit 2022 janë kryer 1335 kontrolle, nga të cilat 537 me karakter monitorues si dhe 798 inspektime, nga të cilat janë vendosur 91 gjoba dhe 128 paralajmërime**.
**Monitorimi i kritereve dhe kushteve minimale për strukturat akomoduese të kategorizuara.**
Në zbatim të VKM 730, datë 20.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave Akomoduese", i ndryshuar, është miratuar "Rregullorja për mënyrën, kriteret dhe procedurën për kategorizimin e strukturave Akomoduese" me Urdhër të Ministrit nr. 267 datë 24.07.2019, sipas së cilës çdo subjekt duhet të plotësojë kriteret e detyrueshme për nivelin më të ulët të sistemit të klasifikimit, nga DSZHQTZB është realizuar kontrolli i **371** subjekteve me veprimtari strukturë Akomoduese përmes mbajtjes së akt verifikimeve.

| **Titulli i gjetje** | Monitorimet, kontrollet, nga Sektori i inspektimeve në AKB; |
|---|---|

| | |
|---|---|
| **Situata:** | -Nisur nga inspektimet dhe monitorimet e ndërmarra nga AKB , lidhur me Problematikat për subjektet që ushtrojnë aktivitete në strukturat Akomoduese është konstatuar, se nuk parashikohet asnjë masë administrative me gjobë në zbatim të VKM 730, datë 20.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave Akomoduese", i ndryshuar", si dhe as në VKM nr. 569, datë 17.07 2019 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit". Monitorime të kryera sipas të Urdhrit nr. 267, datë 24.07.201.9 "Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave Akomoduese", i ndryshuar.<br>- Në total nga MTM janë kategorizuar 1,366 subjekte. Nga kjo shifër janë kontrolluar për vitin 2021 një total prej 593 (ose 43%) subjektesh.<br>Nga të dhënat ë marra nga AKB dhe Urdhri i Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, për vitin 2021 pjesa e madhe e punës është fokusuar në monitorime për subjektet si ato me strukture Akomoduese, ashtu edhe për stacionet e plazhit, pas janë pas post covid dhe me tepër janë realizuar për ndërgjegjësim, këshillime apo dhe paralajmërime ndaj subjekteve. |
| **Kriteri:** | - Ligji nr. 93/2015 "Për Turizmin" neni 17 "Funksionet dhe Kompetencat e Inspektoratit të Turizmit"; ligji nr. 10433,datë16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë";VKM nr. 569, datë 17.07.2019, kapitulli III-të, pika 6. |
| **Ndikimi/Efekti** | Kryerje monitorimesh dhe inspektimesh por jo efektive për arsye të mangësive në legjislacion. |
| **Shkaku** | Mungesat në struktura dhe mangësitë në legjislacionin për inspektimin, mungesa e një ligji të integruar për zonën bregdetare. |
| **Rëndësia** | E Mesme. |
| **Rekomandim** | -AKB dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrin masa për përmirësimet e akteve ligjore apo nënligjore lidhur me parashikimin dhe përcaktimin e vendosjes së masave administrative me gjobë si në ligjin 93/2015 "Për Turizmin", VKM 730, datë 20.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave Akomoduese", i ndryshuar", në VKM nr. 569, datë 17.07 2019 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit",me synim rritjen e përgjegjësisë ligjore për subjektet e pajisura me licenca certifikata dhe subjektet me veprimtari stacione plazhi. |

**-Monitorimi i Kushteve dhe Kritereve të Stacioneve të Plazhi.**

Me nisjen e sezonit turistik 2022, DSZHQTZB ka monitoruar **166** subjekte që ushtrojnë veprimtarinë si stacion plazhi, mbi plotësimin e kritereve dhe standardeve të përcaktuara në VKM 171, datë 27.03.2019, i ndryshuar, në Bashkitë Durrës, Kavajë, Fier, Himarë dhe Sarandë. Nga monitorimi i kryer në stacionet e plazhit janë konstatuar se subjekte kanë mangësi kryesisht në Sinjalizim e zonave të mjeteve lundruese për argëtim dhe markimin e zonës së notimit.

Tabela me 166 subjekte te monitoruara me veprimtari stacione plazhi

| Nr. | Bashkia | Subj. te monitoruara | Subjekte me kontratë | Subjekte pa kontratë | Konstatime | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Durrës | 102 | 94 | 8 | Ka 77 kulla vrojtimi 88 vrojtues | Ka mangësi kryesisht ne Sinjalizim e zonave te mjeteve lundruese për argëtim dhe markimin e zonës se notimit |
| 2 | Kavajë | 41 | 40 | 1 | Ka 33 kulla vrojtimi 33 vrojtues | Nuk ka mangësi |
| 3 | Fier | 3 | 1 | 2 | Ka 2 kulla vrojtimi dhe 1vrojtues | Nuk u konstatuan mangësi |
| 4 | Sarandë | 11 | 9 | 2 | Ka 11 kulla vrojtimi dhe 8 vrojtues | Ka mangësi kryesisht ne Sinjalizim e zonave te mjeteve lundruese për argëtim dhe markimin e zones se notimit |
| 5 | Himarë | 9 | 1 | 8 | Ka 8 kulla vrojtimi dhe 3 vrojtues | Ka mangësi kryesisht ne tabelat informuese |
| | **Total** | **166** | **145** | **21** | | Ka mangësi kryesisht ne Sinjalizim e zonave te mjeteve markimin e zonës së notimit |

***Burimi D****rejtoria për Sigurimin dhe Zhvillimin e Qëndrueshme të Turizmit dhe Zonave Bregdetare*

**Kontrata për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit.**

AKB, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në kuadër të sezonit turistik veror 2021, si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1172, datë 24.12.2020, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 171, datë 27.03.2019, Për miratimin e rregullores "*Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"*, i ndryshuar, ka vijuar me nënshkrimin e kontratave për përdorimin e hapësirave të plazhit me subjektet në të gjithë zonën bregdetare për subjektet që marrin miratimin përfundimtar nga GTSHA.

- **Kontrata të ndara në vite:**

Kontrata për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit të miratuara në vitin 2021, të ndara sipas kohëzgjatjes në vite të kontratave, deri ne datën 08.10.2021

| KONTRATA TË MIRATUARA – 2021 | | KOHËZGJATJA (VITE) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | *Totali sipas njësive vendore* |
| BASHKIA | SHKODËR | 6 | 23 | 15 | 0 | 19 | 63 |
| | LEZHË | 39 | 50 | 7 | 0 | 41 | 137 |
| | DURRËS | 116 | 49 | 13 | 0 | 68 | 246 |
| | KAVAJË | 25 | 27 | 6 | 0 | 42 | 100 |
| | RROGOZHINË | 13 | 6 | 6 | 0 | 42 | 67 |
| | DIVJAKË | 6 | 8 | 0 | 0 | 1 | 15 |
| | POGRADEC | 11 | 23 | 5 | 0 | 12 | 51 |
| | FIER | 2 | 75 | 0 | 0 | 0 | 77 |
| | VLORË | 71 | 10 | 39 | 2 | 41 | 163 |
| | HIMARË | 41 | 16 | 45 | 1 | 71 | 174 |
| | SARANDË | 67 | 16 | 10 | 1 | 44 | 138 |
| *Totali për vijën bregdetare* | | 397 | 303 | 146 | 4 | 381 | 1231 |

Për (1231 subjekte) e miratuara nga GTSHA për nënshkrimin e kontratës për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, kanë kryer pagesën për ushtrimin e kësaj veprimtarie, pranë njësive vendore përkatëse, si institucione përfituese të këtyre të ardhurave, pas procesit të negocimit të sipërfaqes së plazhit dhe përgatitjes së plan vendosjes nga këto njësi vendore, për secilin subjekt**. Të hartuara dhe Nënshkruara Nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit Tabela me të dhënat e marra nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit**

**Tabela Të ardhurat nga sezoni turistik veror 2021, në raport me sezonin turistik veror 2020-2021**

| Nr | Bashkia | Sezoni turistik veror 2019 (aplikimet për stacione plazhi, pranë njësive vendore) | Sezoni turistik veror 2020 (fillimi i aplikimit on-line për stacione plazhi, n.p.m e-Albania) | Rritja/Ulja në përqindje 2019-2020 | Sezoni turistik veror 2021 (aplikimi online për stacione plazhi, n.p.m e-Albania) | Rritja/Ulja në përqindje 2020-2021 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Lezhë | 28,438,000.00 | 32,632,021.00 | 14.75% | 39,649,390.00 | 21.50% |
| 2. | Shkodër | 31,047,000.00 | 38,769,850.00 | 24.87% | 31,480,010.00 | -18.80% |
| 3. | Durrës | 48,407,050.00 | 75,122,605.00 | 55.19% | 78,190,323.00 | 4.08% |
| 4. | Kavajë | 31,754,700.00 | 27,771,000.00 | -12.55% | 40,006,400.00 | 44.06% |
| 5. | Rrogozhinë | 16,247,800.00 | 17,554,200.00 | 8.04% | 30,751,800.00 | 75.18% |
| 6. | Divjakë | 2,417,412.00 | 3,720,000.00 | 53.88% | 4,612,000.00 | 23.98% |
| 7. | Pogradec | 2,440,000.00 | 2,886,000.00 | 18.28% | 4,505,000.00 | 56.10% |
| 8. | Fier | 3,412,000.00 | 4,254,550.00 | 24.69% | 4,699,997.00 | 10.47% |
| 9. | Vlorë | 32,000,000.00 | 28,700,000.00 | -10.31% | 31,900,000.00 | 11.15% |
| 10. | Sarandë | 39,000,000.00 | 52,788,305.00 | 35.35% | 56,977,200.00 | 7.94% |
| 11. | Himarë | 45,000,000.00 | 40,000,000.00 | -11.11% | 92,000,000.00 | 130.00% |
| TOTALI | | **280,163,962.00** | **324,198,531.00** | **15.72%** | **414,772,120.00** | **27.94%** |
| **Diferencat në vlerë arkëtimesh në lëkë** | | **viti bazë** | **44,034,569.00 (2020 vs. 2019)** | | **90,573,589.00 (2021 vs. 2020)** | |
| **Diferencat në vlerë arkëtimesh në përqindje %** | | **viti bazë** | **15.72% (2020 vs. 2019)** | | **27.94% (2021 2020)** | |

## Hapësirat publike, sipas njësive vendore, raporti në parcela me sezonin turistik veror 2021:

| Përmbledhje e parcelave publike për sezonin turistik veror 2021 | | |
|---|---|---|
| BASHKIA | PARCELA PUBLIKE | |
| | SHKODËR | 105 |
| | LEZHË | 232 |
| | DURRËS | 338 |
| | KAVAJË | 67 |
| | RROGOZHINË | 23 |
| | DIVJAKË | 21 |
| | POGRADEC | 27 |
| | FIER | 79 |
| | VLORË | 121 |
| | HIMARË | 79 |
| | SARANDË | 18 |
| | **TOTALI** | **1110** |

## Nr i tabelave sipas bashkive

| | | Nr. Parcela (të miratuara fillimisht, nga harta e plazheve) | Kthyer publike (pas përfundimit të procesit të aplikimit në portalin e-Albania) | *Total* |
|---|---|---|---|---|
| BASHKIA | SHKODER | 15 | 90 | **105** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **LEZHE** | 19 | 213 | **232** |
| | **DURRES** | 148 | 190 | **338** |
| | **KAVAJE** | 53 | 14 | **67** |
| | **RROGOZHINE** | 20 | 3 | **23** |
| | **DIVJAKE** | 10 | 11 | **21** |
| | **POGRADEC** | 16 | 11 | **27** |
| | **FIER** | 17 | 62 | **79** |
| | **VLORE** | 19 | 102 | **121** |
| | **HIMARE** | 56 | 23 | **79** |
| | **SARANDE** | 6 | 12 | **18** |
| ***Total*** | | **379** | ***731*** | ***1110*** |

- *Nga tabela e mësipërme vërehet se ka një rritje të parcelave të plazhit publik, në raport me sezonin turistik veror 2020, ku në sezonin turistik veror 2021 kanë shërbyer si parcela publike 485 të tilla dhe në sezonin turistik veror 2021 kanë shërbyen si plazhe publike 1110 parcela .Numri i Parcelave të miratuara fillimisht nga hartat e plazheve 379 parcela dhe 731 parcela kthyer publike pas shqyrtimit të bërë nga GTSHA*

**Të ardhurat nga sezoni turistik veror 2022, në raport me sezonin turistik veror 2019-2020-2021:**

-Dokumenti "Vendim Përfundimtar", në disa raste, nuk plotësohet në mënyrë të detajuar në rubrikën "shkelje të konstatuara", nga ana e inspektorëve.
-Në 2 raste, Vendimi Përfundimtar është marrë në të njëjtën ditë , duke mos respektuar afatin për paraqitjen e konstatimeve nga subjekti, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 45,të ligjit për inspektimin.
-Në asnjë rast nga inspektorët nuk plotësohet në zbatim të pikë 10, të Kreut XIII, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, "Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik "e-Inspektimi", të pasqyrohet ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti), ne modulin "gjoba".

-Nga monitorimet e kryera në vitin 2021 për 21 subjekte me aktivitet ''Stacione plazhi'' në formatin tip të miratuar nga titullari i institucionit nuk janë marrë nënshkrimi nga subjekti çfarë e bën të pa mundur verifikimin e kryerjes së monitorimit në terren nga inspektoret, për por në vitin 2022 është hartuar dokumenti me nënshkrim nga të dyja palët institucion / subjekt.
-Nga auditimi rezultoi se në 13 raste subjektet me veprimtari "Operatore Turistik" janë konstatuar të mbyllura inspektorët të marrin masa për verifikimin e subjekteve në qkb nëse ushtrojnë aktivitet dhe të hartojnë listat e subjekteve /të paraqitën pranë drejtorisë së inspektimit dhe hartimit të planeve për inspektim ne vijimësi.
-Në përgjithësi mungon dokumentacioni bashkëlidhur në sistem, nga inspektorët ,veprime në kundërshtim me Urdhrin nr. 25 datë 10.08.2018 'Për miratimin e rregullores për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ ',si dhe aktet tjera ligjore të fushës së inspektimit.

| **Titulli i gjetje** | *Në vitin 2021 Nuk janë hartuar programe vjetore* |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi u konstatua se**,** për vitin 2021, Drejtoria për Sigurimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit dhe Zonave Bregdetare, nuk ka hartuar programin vjetor të inspektimit, por kanë kryer inspektimet në mënyrë rastësore, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 24, Kreu IV në Ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", pikën 2.2 dhe 2.7, Kreu II të Urdhrit nr. 13, datë 23.04.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në RSH", pikën 4 dhe 5 të Kreut I të Urdhrit nr.5, datë 19.02.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve". |
| **Kriteri:** | - Ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", |
| **Ndikimi/Efekti** | Nuk janë inspektuar të gjitha subjektet sipas fushave të veprimtarisë |
| **Shkaku** | Mungesat në struktura dhe mangësitë në legjislacionin për inspektimin, mungesa e një ligji të integruar për zonën bregdetare. |
| **Rëndësia** | E Mesme. |
| **Rekomandim** | Agjencia Kombëtare e Bregdetit, të marri masa të hartojë dhe miratojë programet vjetore dhe mujore të inspektimit për fushat përkatëse të aktivitetit të saj. |

***Për sa është trajtuar në këtë Akt-Konstatim nr.5, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 399/12 prot., datë 02.10.2023 , 561/3 datë 02.10.202,***
***Pretendimi i subjektit:***
Përsa i përket observacionit në lidhje me plotësimin e dokumentacionit, inspektorët L. V. dhe K. J.,Z. D.,E. H., L. K., F. V. M. B., H.T. ,F. S., kanë sjellë dokumentacionin plotësues për subjektet Q. – V., subjektit H. M., Sh. Y., Z. R., I. H., D. S., V. M. A. D., A. S., Q. K., E. V. A. F. dokument bashkangjitur.
***Qëndrimi i grupit të auditimit:***

*Përsa i përket observacionit në lidhje me plotësimin e dokumentacionit është sjellë dokumentacioni bashkëlidhur, certifikatë të kategorizimit , foto të strukturave Akomoduese grupi i auditimit pasi shqyrtojë dokumentacioni mori në konsideratë dhe u reflektuan në Raportin Perfundimtarë të Auditimit.*
Subjekti E. V., grupi i auditimi pasi shqyrtoi dokumentacioni nuk mori në konsideratë pasi mungonte dokumentacioni vërtetues .
*Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi punonjësit e lartë përmendur.*
**Në zbatim të Pikës 5. 1. Zbatimi i proceduarve për shkeljet e konstatuara.**
U audituan procedurat e animimit,
Procedurat e shfuqizuara,
Proces verbalet e mbajtura nga grupi i animimit,
Nga auditimi i kryer për marrjen e masave administrative (Gjoba) në AKB janë marrë gjithsej 105 masa administrative për subjektet me veprimtari "'Stacione plazhi", struktura Akomoduese,
Për marrjen e masave për shqyrtimin praktikave, deri ne vjeljen e tyre është ngritur urdhri i titullarit me komisionin e ankimimit të përbërë si më poshtë;
Komisioni i ngritur me urdhrin nr.16 (314 prot)., datë 01.06.2021 "*Për krijimin e komisionit të ankimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit"*, me përbërje si më poshtë:
**z.** L.L., Kryetar, z . G. A., Anëtar, znj. E. M., Anëtar, znj. G. T., Anëtar, znj. E. D., Anëtar (Sekretariati), i cili shqyrton ankimet administrative të depozituara pranë AKB për vendimet përfundimtare të inspektimeve, bazuar në ligjin nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave*

| Statusi i Vendimeve Administrative te ankimuara pranë Komisionit te Ankimeve | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Viti** | **Gjoba të dërguara ne përmbarim** | | **Gjoba në proces për titull ekzekutiv në Gjykatë** | | **Gjoba të shlyera vullnetarisht(pa përmbarues)** | | **Gjoba në ankim gjyqësor , në proces** | | **Gjoba në pritje mbarimit të afatit të ankimit administrativ** | | **Gjoba të shfuqizuara** | | **Totali i gjobave të vëna nga akb** | |
| | **Nr Gjoba** | **Vlera leke (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera leke (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera leke (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Nr Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Nr .Gjoba** | **Vlera lek (/000)** |
| 2021 | **5** | **1.000.000** | 4 | 800.000 | 2 | 400.000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 400.000 | **13** | 2,600,000 |
| 2022 | **28** | **5.320.000** | 17 | 2900000 | 9 | 1260000 | 2 | 400.000 | 0 | 0 | 6 | 600.000 | **92** | 10480000 |
| **Totali** | **33** | **6,320,000** | **21** | **3700,000** | **11** | **1,660,000** | **2** | **400.000** | **0** | **0** | **8** | **1,000,000** | **105** | **13,080,000** |

*Administrative*", Ligjin nr. 93/2015 "*Për Turizmin*", të ndryshuar, Ligjit 10 433, datë 16.06.2011 "*Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 17.03.2021 për disa shtesa në vendimin nr.569, datë 17.07.2019, të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit*", si dhe Rregulloren nr.314/2 prot., datë 16.09.2021 "*Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Ankimit, si dhe përcaktimi i procedurave të hollësishme të shqyrtimit të ankimit administrativ në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit*", me datë 29.10.2021 ka shqyrtuar ankimet administrative, si më poshtë:
**Tabela me masat e marra nga AKB**

Nga 92 gjoba të vendosura në 2022 , janë shfuqizuar 2 masa administrative (gjoba) prej tyre nga komisioni i ankimimi dhe 4 gjoba shfuqizuar nga gjykata.
Nga 105 masa administrative të marra nga AKB , janë në përgatitje të kërkesës për lëshimin e urdhrit, të ekzekutimit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Tiranë ,për ekzekutimin e 28 masave administrative.

**<u>Konkluzion;</u>**

**Në** AKB për vitin 2021 deri në fund të vitit 2022 rezulton janë vendosur gjithsej **105 gjoba** nga viti 2021 deri në funde vitin 2022 në vlerë totale **13,080 mije lekë,** nga këto kanë likuiduar 11 subjekte kryesisht me vlerë likuidues **1,660** mije lekë me likuidim vullnetare, janë pa arkëtuar në vlerën **87,440 mijë lekë**, për këto vlerë nuk janë ndjekur procedurat ligjore sipas "Kreut VI ,neni 45,46, te ligjit nr. 10433,datë 16.06.2011 si dhe Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenin 9, shkronja b pika 4 të nenit 30, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

**-Komisioni i ankimimeve** në 58 raste nga të cilat; në 24 raste ka tejkaluar afatet ligjore 30 ditore, për shqyrtimin e ankimimeve, në 3 raste ka lejuar ankesën e subjektit jashtë afatit 30 ditor, dhe në 31 raste ***nuk ka përgatitur*** *vendimit për kthim në titull ekzekutimi nga gjykata Administrative e Shkalles së Parë Tiranë, veprime* në kundërshtim me nenin 46 *"Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar*" të ligjit 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin ne Republikën e Shqipërisë*", me pikën 1 neni 132 *"për afatin kohor për ankimin administrativ*" të ligjit 45/2015 "*Kodi Procedurës Administrative*", *në kundërshtim me* pika1, 3, të të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative". Në pikën 1. Gjoba dhe shumat, që duhet të paguhen sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve, nga data kur: a) është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë, që përbën titull ekzekutiv; b) vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë. 2. Ligji i posaçëm mund të vendosë afate të tjera për detyrimin për arkëtimin e shumave. 3. ku theksohet ;
Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet kamatë 2 % në muaj të masës së gjobës, me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon përqindje të ndryshme për kamatëvonesat.

***-Në procesverbalet e mbajtura nga komisioni i ankimimit në asnjë rast nuk janë hartuar dhe nënshkruar procesverbalet por janë mbajtur nëpërmjet një relacioni pa nënshkrim veprime në kundërshtim me Urdhrin*** nr. 314/2 prot. datë 16.09.2021, neni 12 Shqyrtim i ankimimit pika ,2,3,në pikën 5 ku citohet se; Pas përpilimit ,procesverbali u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve ne funde të mbledhjes. Pas miratimit procesverbali nga Kryetari dhe sekretari.

-Në 8 raste Komisioni ankimimi *të AKB Tiranë* ka vendosur shfuqizimin e vendimit administrativ nuk ka patur në prani autoritetin përkatës, i cili ka marrë vendimin, pra ka gjykuar në mungesë të inspektorëve të cilët kanë vendosur gjobat për Kundërvajtjet e konstatuara, çka bie ndesh me VKB NR. 59 datë 17.07.2019 ''Për Organizimin de Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit "si dhe ligjet 91/2015 Për Turizmin "si dhe të ligjit 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin ne Republikën e Shqipërisë*" dhe me pikën 1 neni 132 *"për afatin kohor për ankimin administrativ*" të ligjit 45/2015 "*Kodi Procedurës Administrative*", ku thuhet: *Neni 46 i ligjit 10433 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"' datë 16.06.2011 vendimi përfundimtar i inspektimit merret brenda 30 ditëve nga data e procesverbalit të inspektimit subjektit.*- në pikën 1 neni 132 *"për afatin kohor të ankimin administrativ*" ligjit 45/2015 "*KPA*", thuhet: *Ankimi ndaj aktit administrativ duhet të*

*paraqitet brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen ose refuzimin e këtij akti.*

| **Titulli i gjetje** | *Ankimimi i gjobave* |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi u konstatua se, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për vitin 2021- 2022, që janë vendosur gjithsej 105 gjoba, në vlerë totale 13,080 mije lekë, nga këto kanë likuiduar 11 subjekte kryesisht me vlerë likuiduese 1,660 mije lekë, me likuidimi vullnetare, janë pa arkëtuar në vlerën 87,440 mijë lekë, duke mos ndjekur procedurat ligjore sipas "Kreut VI ,neni 45,46, te ligjit nr. 10433,datë 16.06.2011 si dhe Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenin 9, shkronja b pika 4 të nenit 30, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative.<br>-në 24 raste ka tejkaluar afatet ligjore 30 ditore për shqyrtimin e ankimimeve, në 2 raste ka lejuar ankesën e subjektit jashtë afatit 30 ditor dhe në 31 raste nuk ka përgatitur *vendimit për kthim në titull ekzekutimi nga gjykata Administrative e Shkalles së Parë Tiranë, veprime* në kundërshtim me nenin 46 *"Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar*" të ligjit 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin ne Republikën e Shqipërisë*", me pikën 1 neni 132*"për afatin kohor për ankimin administrativ*" të ligjit 45/2015"*Kodi Procedurës Administrative*", me pikën 1 neni 132 *"për afatin kohor për ankimin administrativ*" të ligjit 45/2015 "*Kodi Procedurës Administrative''/* |
| **Kriteri:** | ligjit 45/2015 "Kodi Procedurës Administrative" . |
| **Ndikimi/Efekti** | Mos respektim afatesh për vendimmarrje te masave administrative |
| **Shkaku** | Struktura të pa plotësuara. |
| **Rëndësia** | E Mesme. |
| **Rekomandim** | Agjencia Kombëtare e Bregdetit, të marri masa për arkëtimin e 94 gjobave në vlerën në vlerën 87,440 mijë lekë të vendosura nga inspektorët e saj.-Komisioni i Ankimimit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit të marri masa të paraqesë në Gjykatës Administrative për kthim në titull ekzekutiv të 31 ankesave jashtë afateve ligjore. |

*Për veprimet e mësipërm mbajnë përgjegjësi Komisioni I animimit*

***Për sa është trajtuar në këtë Akt-Konstatim nr.5, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 399/16 prot., datë 02.10.2023 ,***

***Pretendimi i subjektit:***

Përsa i përket observacionit në lidhje me trajtimi dhe mbajtjen e procesverbaleve nga komisioni i ankimimi të gjobave ,dokument bashkangjitur.

***Qëndrimi i grupit të auditimit:***

Përsa i përket observacionit në lidhje me plotësimin e dokumentacionit dhe mbajtjen e procesverbaleve nga komisioni i ankimimit të gjobave është sjellë dokumentacioni bashkëlidhur, si grupet e punës dhe procesverbal e mbajtura nga komisioni i ankimimit, grupi

i auditimit pasi shqyrtojë dokumentacioni mori në konsiderate pjesërisht dhe u reflektuan në Projekt-Raportin e Auditimit.

**Trajtimi i observacioneve**
Me shkresën me nr.1779/4 prot., datë 20.11.2023, protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me 561/15 prot., datë 22.11.2023 , Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka dërguar observacionet Në Raport Përfundimtarë si vijon:
**-Pretendimet e subjektit:**
Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka përcjellë sqarimet dhe dokumentacionin lidhur me projekt raportin e auditimit të KLSH.
**-Qëndrimi i grupit të auditimit:**
Pas shqyrtimit të dokumentacionit të bërë më sipër, sqarojmë se observacionet e sjella nga subjekti janë të njëjta si në fazën e hartimit të projektit raportit dhe Raport Përfundimtrë dhe janë reflektuar ne Raport Përfundimtarë. Sa më sipër, grupi i auditimit ka marrë në konsideratë vetëm dokumentacionin justifikues ligjor.

Për sa u trajtua në këtë Raport /Përfundimtarë mbajnë përgjegjësi punonjësit e trajtuar në material.

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

**1. Gjetje: Nga auditimi u konstatua se,** Informacioni për parashikimin e dy viteve PBA 2021-2023 si dhe 2022-2024, nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit për shkak se nuk disponohet në forme elektronike por as në formë shkresore. Arsyeja sulmi Kibernetike që u bë mbi disa platforma ndër të cilat edhe AKSH-i. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", i ndryshuar, neni nr. 43 dhe Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, neni nr. 17. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 10-14, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

**1.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtarë Bregdetit të marrë masa që të gjitha dokumentet të përpilohen dhe të mbahen edhe në formë shkresore si dhe të protokollohet dhe arkivohen për të krijuar sigurinë e mbajtjes dhe disponibilitetin e informacionit duke respektuar legjislacionin në fuqi.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2. Gjetje:** Nga auditimi u konstatua se në bazë të dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe nga auditimi i kryer në librat e magazinave ka parregullsi në mbajtjen e artikujve pas hyrjes dhe daljes së tyre në magazinë. Grupi i auditimit ka konstatuar se mbajtja e artikujve në librat e magazinës bëhej pa një kronologji dhe pa një rregullshmëri të caktuar në hedhjen e tyre në këto libra. Gjithashtu Grupi i auditimit ka konstatuar se nuk është kryer një rakordim periodik ndërmjet magazinës dhe zyrës së financës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 30-37, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*
**2.1. Rekomandim:** Sektori i Burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në AKB , të bëjë sistemimin e dokumentacionit në librat të magazinës si dhe të bëhet mbajtja e artikujve në librat e magazinës në mënyrë kronologjike dhe të rregullt.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje:** Nga auditimi i përdorimit të karburantit në institucionin e AKB-së grupi i auditimit konstatoi disa mangësi në dokumentimin e përdorimit të karburantit si:
- Përgjithësisht Fletët e Udhëtimit nuk ishin të nënshkruara nga punonjësit e AKB-së për të justifikuar lëvizjet e kryera si dhe Fletë Udhëtimet përgjithësisht, nuk janë shoqëruar me faturat tatimore të subjekteve ku është marrë karburanti pavarësisht se, në sistem sasia e karburantit rezulton e konsumuar veprime këto, në kundërshtim me Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika nr. 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 34-39, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)*

**3.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që në vijimësi, të gjithë punonjësit e AKB-së që përdorin automjetet e këtij institucioni të kryejnë dokumentimin e plotë të përdorimit të karburantit dhe ky dokumentacion të shoqërohet me Faturat Fiskale për çdo konsum karburanti.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4. Gjetje:** Nga auditimi u konstatua se, përllogaritja e fondit limit nga "Komisioni për përllogaritjen e karburantit për Institucionin" nuk është bërë në mënyrë të detajuar pasi nuk janë përcaktuar shumë faktor të rëndësishëm si numri total i Inspektimeve, Monitorimeve, Verifikimeve etj të kryera gjatë viteve të kaluara. Për sa më sipër nuk është bërë një përllogaritje e detajuar për totalin e kilometrave të përshkruara në vitet e kaluara për të arritur në një përllogaritje më të saktë për nevojat e institucionit të AKB-së për karburant për automjetet në dispozicion të tij, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 2875, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar si dhe Udhëzimi nr. 6, datë 16.01.2018, "Përllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër" pika nr.7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 21-36, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)*
**4.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa dhe të bëhet një përllogaritje e saktë dhe e detajuar mbi nevojat e institucionit për punë, mallra dhe shërbime, në çdo procedurë me qëllim realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe përdorimin me efektivitet, efecientë dhe ekonomi citet të fondeve publike.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetje:** Nga auditimi u konstatua se, për blerjet e vogla në procedurat e prokurimit publik në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit u konstatuan disa problematika.
a- Nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 2875, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
b- Nuk është nënshkruar:
-procesverbali i marrjes në dorëzim të dokumentacionit të operatorit fitues,
-nuk është përpiluar Proces Verbali dorëzimit të dokumentacionit të Operatorit fitues që duhet të firmoset nga Komisioni i Prokurimit për Procedurat me Vlera të Vogla si dhe nga Operatori Ekonomik fitues.
- nuk është përpiluar Proces Verbali Vlerësimit dhe gjeneruar nga sistemi Raporti i Vlerësimit, nuk është gjeneruar nga sistemi dhe bashkangjitur praktikës Raporti Përfundimtarë. Për sa më sipër, të gjitha këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 2875, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 29-34, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)*

**5.1. Rekomandim:** Komisioni Prokurimit me Vlerë të Vogël në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të marrë masa në plotësimin me dokumentacionin e nevojshëm si dhe zbatimin e të gjitha procedurave të prokurimit publik për të garantuar besueshmëri në zhvillimin e procedurës së prokurimit si dhe vlerësim dhe shpalljen e operatorit fitues.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**6. Gjetje:** Nga auditimi u konstatua se, për blerjet e vogla nën 100,000 lekë pa TVSH .
- Për vitin 2021,janë zhvilluar nga 9 procedura, ku në 6 raste, nuk është bërë hedhja në sistemin e APP-së, duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 2875, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
- Për vitin 2022, janë zhvilluar 6 procedura ku , në 4 raste nuk është bërë hedhja në sistemin e APP-së,
- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 2875, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 31-37, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

**6.1. Rekomandim:** Komisioni Prokurimit me Vlerë të Vogël në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të marrë masa që në fazën e hartimit të regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit të përfshijë këto blerje në procedurat normale të prokurimit me vlerë të vogël për të minimizuar mundësinë e abuzimit me fondet e institucionit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se**,** për vitin 2021, Drejtoria për Sigurimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit dhe Zonave Bregdetare, nuk ka hartuar programin vjetor të inspektimit, por kanë kryer inspektimet në mënyrë rastësore, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 24, Kreu IV në Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", pikën 2.2 dhe 2.7, Kreu II të Urdhrit nr.13, datë 23.04.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në RSH", pikën 4 dhe 5 të Kreut I të Urdhrit nr.5, datë 19.02.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 59-61, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

**7.1.Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Drejtoria për Sigurimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit dhe Zonave Bregdetare, të marrin masat e nevojshme, që për çdo vit, ta hartojnë dhe miratojnë programet vjetore dhe mujore të inspektimit për fushat përkatëse të aktivitetit të tyre, duke respektuar kërkesat ligjore në përmbajtjen informacionit të tyre dhe afatet e përgatitjes dhe miratimit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, për 25 subjekte nga të cilat 13 me veprimtari "Operator Turistik" dhe 12 subjekte me veprimtari" struktura Akomoduese" në listat e verifikimeve, në rubrikën "Komente" evidentohet se subjektet e planifikuara për inspektim kanë qenë të mbyllura fizikisht, nga inspektorët nuk janë verifikua në sistem nëse subjekte kanë status aktiv. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 60-69 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

**8.1.Rekomandim:**Agjencia Kombëtare e Bregdetit, nëpërmjet Drejtorisë për Sigurimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit dhe Zonave, të marrë masa për hartimin e një regjistri me subjektet e konstatuara të mbyllura nga inspektimet dhe të konfirmojë statusin e gjendjes së regjistrimit, aktiv apo pasiv si biznes në QKB-së, me qëllim që të hartojnë dhe nxjerrjen e autorizimeve për kryerjen e inspektimeve, ndaj subjekteve që janë aktiv, në të kundërt të merren masa administrative (gjobë) sipas ligjit në fuqi**.**

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se**,** dokumentacioni në sistemin e-inspektime, në përgjithësi, i mungonte dokumentacioni bashkëlidhur, veprime në kundërshtim me Urdhrin nr. 25 datë 10.08.2018 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e procedurës së inspektimit si një proces i rregullt administrativ" si dhe pikën 2.2 dhe 2.7, Kreu II të Urdhrit nr. 13, datë 23.04.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në RSH". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 60-71, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit)*
**9.1.Rekomandim;** Inspektoret e Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të marrin për çdo subjekt të inspektuar të hidhen të gjithë dokumentacioni në sistem e-inspektime, që ndodhet në subjekt, në të kundërt të merren masa administrative me gjobe sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se , në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, për vitin 2021-2022 janë marrë 44 masa administrative (gjoba) për subjektet që ushtrojnë aktiviteti pa kontrata "stacione plazhi'. Por nga AKB, nuk ka korrespodencë zyrtare / shkresa informuese drejtuar Policisë Bashkiake, apo dhe një bashkëpunim me inspektoret e taksave pranë NJQV-ve, për marrjen e masave për pezullimin e aktivitetit të pa ligjshëm, dhe lirimin e hapësirave publike .Por janë mjaftuar vetëm me masën administrative gjobë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 52-78, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*
**10.1.Rekomandim:**Agjencia Kombëtare e Bregdetit, të mundësojë korrespodencë zyrtare / shkresa informuese , në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore, të marrë masë në rastet e konstatimi të ushtrimit të aktivitetit pa kontratë, të sekuestrojnë dhe të bëjnë të mundur lirimin e hapësirave publike të zaptuara pa drejtësisht /kontratë.

| Nr | Subjekti | Veprimtaria | Bashkia | Nipt | Adresa | Dt inspektimit | Grupi insp. | Dt. Pv |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | S. J. | Stacion Plazhi | Himare | L..N | Himarë | 27.07.2021 | E.B., A. M., K. J. | 27.07.2021 |
| 2 | Gj. K. | Stacion Plazhi | Himare | L..Q | Rrg.Qender | 28.07.2021 | H. T., F. S., M. B. | 28.07.2021 |
| 3 | V. B. | Stacion Plazhi | Himare | L...V | Lgj.Potam Gd.nr.2 | 29.07.2021 | L. V., E. H.,F. H. | 29.07.2021 |
| 4 | A.K. | Stacion Plazhi | Pogradec | L..U | Fshati Lin, | 03.08.2021 | A. M., F. S. | 03.08.2021 |
| 5 | A.I. | Stacion Plazhi | Lezhe | L..R | Lezhe | 05.08.2021 | M. B., E. H. | 05.08.2021 |
| 6 | A. N. | Stacion Plazhi | Vlore | L..Q | Orikum-Plazh, | 09.08.2021 | M. B., E. H. | 09.08.2021 |
| 7 | L. F. | Stacion Plazhi | Vlore | L..K | , Lagjja Orikum- | 09.08.2021 | M. B., E. H. | 09.08.2021 |
| 8 | SH. | Stacion Plazhi | Golem | J..Ë | Golem | 17.08.2021 | H. T., F. V. | 17.08.2021 |
| 9 | Z. M. | Stacion Plazhi | Kavaje | L..O | Karpen | 19.08.2021 | M.. B., A. M. | 19.08.2021 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | B. H. | Stacion Plazhi | Durres | L..R | Durres | 24.08.2021 | L.V., K. J. | 24.08.2021 |
| 11 | L.S. g. | Stacion Plazhi | Durres | M..S | Lagjia lliria, nr 13, Durrës | 24.08.2021 | A. M., E. H. | 24.08.2021 |
| 12 | Rr.S. | Stacion Plazhi | Ksamil | L..J | Ksamil | 27.08.2021 | L. V., K. J. | 27.08.2021 |
| 13 | Q.V. | Stacion Plazhi | Ksamil | L..B | Ksamil | 27.08.2021 | L. V., K. J. | 27.08.2021 |
| 14 | D.P. | Stacion Plazhi | Tale Lezhe | L..N | Tale Lezhe | 16.06.2022 | L.V.,K.J. | 16.06.2022 |
| 15 | S. T. | Stacion Plazhi | Shkembi iKavajes | L. | Shkembi Kavajës | 22.06.2022 | L.V., K. J. | 22.06.2022 |
| 16 | D.K. | Stacion Plazhi | Zvernec | L..A | Zvernec | 27.06.2022 | H.T. F. S. | 27.06.2022 |
| 17 | A.P. | Stacion plazhi | | L..F | Lezhe | 14.06.2022 | S., M. | 14.06.2022 |
| 18 | T. 2. | stacion plazhi | | L..I | Lezhe | 14.06.2022 | S., M. M. B. | 14.06.2022 |
| 19 | E. P. | stacion plazhi | | L..N | Lezhe | 16.06.2022 | L.V. K. J. | 16.06.2022 |
| 20 | Z.D. | stacion plazhi | | L..H | Durres | 22.06.2022 | L. V. K. J. | 22.06.2022 |
| 21 | I. Sh. | stacion plazhi | | L..A | Vlore | 27.06.2022 | F.S. H.T. | 27.06.2022 |
| 22 | M. H. | stacion plazhi | | M..P | Vlore | 27.06.2022 | L.V., K. J. | 27.06.2022 |
| 23 | M. C. | stacion plazhi | | L..N | Vlore | 28.06.2022 | F.S., H.t. | 28.06.2022 |
| 24 | L. C. | stacion plazhi | | L..V | Himare | 29.06.2022 | Z.D., E. A. | 29.06.2022 |
| 25 | K. P. | stacion plazhi | | H..E | Lezhe | 05.07.2022 | H.T., F. V. | 05.07.2022 |
| 26 | E.C. | stacion plazhi | | L..L | Lezhe | 05.07.2022 | L., V.K. J. | 05.07.2022 |
| 27 | Z.K. | stacion plazhi | | H..J | Lezhe | 05.07.2022 | H. T., F. V. | 05.07.2022 |
| 28 | D. N. | stacion plazhi | | M..O | Lezhe | 05.07.2022 | M.B. A. | 05.07.2022 |
| 29 | N. R. | stacion plazhi | | L..V | Lezhe | 05.07.2022 | L.V. K. J. | 05.07.2022 |
| 30 | A. K. | stacion plazhi | | L..R | Lezhe | 05.07.2022 | Z.D., E. H. | 05.07.2022 |
| 31 | B. P. | stacion plazhi | | H..H | Shkoder | 06.07.2022 | F. S., H. T. | 06.07.2022 |
| 32 | P. K. | stacion plazhi | | G..V | Sarande | 08.07.2022 | Z. D., E. H. | 08.07.2022 |
| 33 | I. K. | stacion plazhi | | M..H | Sarande | 08.07.2022 | L. V. K. J. | 08.07.2022 |
| 34 | G. H. | stacion plazhi | | L..K | Kavaje | 12.07.2022 | L. V. K. J. | 12.07.2022 |
| 35 | E. A. | stacion plazhi | | M..R | Fier | 14.07.2022 | L.V. K. J. | 14.07.2022 |
| 36 | A. B. | stacion plazhi | | L..F | Durres | 25.07.2022 | Z. D. E. V. | 25.07.2022 |
| 37 | F. A. | stacion plazhi | | L..E | Durres | 25.07.2022 | Z. D. E.H. | 25.07.2022 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 38 | I. M. | stacion plazhi | | L..N | Durres | 25.07.2022 | L. V. K. J. | 25.07.2022 |
| 39 | N. T. | stacion plazhi | | L..V | Pogradec | 28.07.2022 | H.T.F. S. | 28.07.2022 |
| 40 | V. B. | stacion plazhi | | M..R | Pogradec | 29.07.2022 | H.T., F. S. | 29.07.2022 |
| 41 | J. 2. | stacion plazhi | | M..V | Vlore | 02.08.2022 | H.T. F. S. | 02.08.2022 |
| 42 | N. C. | stacion plazhi | | L..J | HIMARE | 09.08.2022 | H.T. F. S. | 09.08.2022 |
| 43 | P. | stacion plazhi | | L..B | HIMARE | 09.08.2022 | H. T. F. S. | 09.08.2022 |
| 44 | D. L. | stacion plazhi | | L..K | SARANDE | 15.08.2022 | M.B. F. V. | 15.08.2022 |

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për vitin 2021- 2022, që janë vendosur gjithsej 105 gjoba, në vlerë totale 13,080 mije lekë, nga këto kanë likuiduar 11 subjekte kryesisht me vlerë likuiduese 1,660 mije lekë, me likuidimi vullnetare, janë pa arkëtuar në vlerën 87,440 mijë lekë, duke mos ndjekur procedurat ligjore sipas "Kreut VI ,neni 45,46, te ligjit nr. 10433,datë 16.06.2011 si dhe Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenin 9, shkronja b pika 4 të nenit 30, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 52-78, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

**11.1.Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Bregdetit, sektori juridik të marrin masat e nevojshme për ndjekjen e 94 gjobave në vlerën në vlerën 87,440 mijë lekë dhe të ndjekin të gjitha procedurat ligjore në procese gjyqësore/dhe deri në arkëtimin e tyre.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**12. Gjetje nga auditimi: 22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, komisioni i ankimimeve në 57 raste nga të cilat; në 24 raste ka tejkaluar afatet ligjore 30 ditore për shqyrtimin e ankimimeve, në 2 raste ka lejuar ankesën e subjektit jashtë afatit 31 ditor dhe në 28 raste nuk ka përgatitur *vendimit për kthim në titull ekzekutimi nga gjykata Administrative e Shkalles së Parë Tiranë, veprime* në kundërshtim me nenin 46 *"Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar*" të ligjit 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin ne Republikën e Shqipërisë*", me pikën 1 neni 132*"për afatin kohor për ankimin administrativ*" të ligjit 45/2015"*Kodi Procedurës Administrative*", me pikën 1 neni 132 *"për afatin kohor për ankimin administrativ*" të ligjit 45/2015 "*Kodi Procedurës Administrative*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 78-80, të Projekt Raportit të Auditimit).*

**12.1. Rekomandimi:** Komisioni i Ankimimit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit të marri masa të paraqesë në Gjykatës Administrative për kthim në titull ekzekutiv të 28 ankesave jashtë afateve ligjore.

| Nr. | Emër subjekti | NIPT | Veprimtaria | Data e Vendimit Përfundimtar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | E. A. | K..I | Hotel | 14.10.2022 |
| 2 | R. H. | K..J | Hotel/Motel | 14.10.2022 |
| 3 | H. R. | J..L | Hotel | 14.10.2022 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4 | Sh. Gj. | L..Q | Hotel | 17.10.2022 |
| 5 | H. A. | L..B | Hotel | 17.10.2022 |
| 6 | H. "D." | L..L | Hotel | 18.10.2022 |
| 7 | H."B." | L..C | Hotel | 24.10.2022 |
| 8 | S. T. | K..R | Hotel | 27.10.2022 |
| 9 | M. H. R. | L..T | Hotel | 28.10.2022 |
| 10 | Z. Z. H. | L..G | Fjetinë | 31.10.2022 |
| 11 | "Hotel A." | L..E/M..R | Hotel | 01.11.2022 |
| 12 | A. | K..M | Motel | 31.10.2022 |
| 13 | Hotel "V." | L..I | Htel | 01.11.2022 |
| 14 | S. H. | L..J | HOTEL | 08.11.2022 |
| 15 | "Sh. 0." sh.p.k. | K..Ë | HOTEL | 07.11.2022 |
| 16 | S. B. | L..P | HOTEL | 07.11.2022 |
| 17 | A sh.p.k. | J..P | HOTEL | 04.11.2022 |
| 18 | K. I. | L..N | HOTEL | 11.11.2022 |
| 19 | Sh. M. | K..D | HOTEL | 14.11.2022 |
| 20 | B. K. | L..B | HOTEL | 11.11.2022 |
| 21 | L. N. | K..D | HOTEL | 18.11.2022 |
| 22 | E.A | L..K | HOTEL | 21.11.2022 |
| 23 | A.D. | K..P | HOTEL | 21.11.2022 |
| 24 | P.T. | K..N | MOTEL | 09.12.2022 |
| 25 | Hotel "F." | L..P | HOTEL | 12.12.2022 |
| 26 | S. G. | L..T | fjetje dhe mëngjes | 27.12.2022 |
| 27 | A.K. | L..M | HOTEL | 02.12.2022 |
| 28 | Y. Sh. | L…A | AGJENCI UDHËTIMI | 21.06.2022 |

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se**,** komisioni Ankimimit, në 8 raste ka shfuqizuar vendimet administrative, ku në prani nuk ka patur autoritetin përkatës, i cili ka marrë vendimin, pra ka gjykuar në mungesë inspektorëve të cilët kanë vendosur gjobat për kundërvajtjes e konstatuara, çka bie ndesh me VKB nr. 59 datë 17.07.2019 ‘'Për Organizimin de Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit" si dhe ligjet 91/2015 Për Turizmin "si dhe të ligjit 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin ne Republikën e Shqipërisë*".*(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 75-78, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

**13.1. Rekomandimi:** Komisioni i Ankimimi në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit të marri masa dhe të mos shqyrtojë ankesat dhe të mos marrë vendime pa pranin e inspektorëve që kanë marrë vendimet administrative .

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**14.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se **,** në 13 raste nga auditimi me zgjedhje i praktikave të inspektimit ndaj agjencive dhe operatorëve turistik, janë hartuar autorizime vetëm për një pikë të Ligjit nr. 93/2015 "Për Turizmin", konkretisht pajisja me licencë, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 59-64, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*
**14.1. Rekomandimi:** Titullari i institucionit të marrë masa dhe të hartojë autorizimet ku të përfshihen të gjitha kushtet e licencave sipas subjekteve përkatëse.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se **,** në procedurën e prokurimit të kontratës së shërbimit me objekt; ‘'Pastrimi i zonës bregdetare për Bashkitë Durrës , Sarandë Kavajë dhe Himarë". Përzgjedhja e ekspertit të jashtëm për kryerjen e justifikimit të fondit limit nuk i është nënshtruar procedurave të konkurrimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5 datë 25.06.20211"Për blerjet me vlera të vogla dhe zhvillimi nëpërmes sistemit elektronik"

por përzgjedhja e tij është bërë drejtpërdrejt me një kontratë të përkohshme pune. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 19-24, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

**15.1. Rekomandim**: Titullari i Agjencia Kombëtare të Bregdetit, të marrë masa dhe të nxjerrë përgjegjësit për komisionin e blerjeve të vogla, që nuk ka vepruar sipas udhëzimeve në fuqi.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**16.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se**,** lidhur me dorëzimin e produktit për tenderin e pastrimi të zonës bregdetare, Eksperti i kontraktuar ka depozituar shkresën nr. 358/2 datë 11.04.2022 "Dërgim dokumentacioni tekniko-ekonomik për kryerjen e shërbimit të Pastrimit të Zonës Bregdetare për 4 Bashkitë Durrës, Kavajë, Himarë Sarandë".
-Komisioni i marrjes në dorëzim të produktit ka nënshkruar proces verbalin e marrjes në dorëzim pa oponencë apo kërkesë për sqarim ndaj raportit të dorëzuar me nr. Prot 358/2 datë 11.4.2022 . *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 21-26 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

**16.1 Rekomandim;** Agjencia Kombëtare e Bregdetit, të marrë masa dhe ne raste të ngjashme komisionet të studiojnë materialet dhe të paraqesin për aprovim nëpërmjet një informacioni pranë titullarit të Autoritetit Kontraktor.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Kombëtare e Bregdetit nuk ka përfunduar Inventarin Kombëtar të Zonës Bregdetare, i cili konsiston në plotësimin e dosjeve fizike (Foto të subjektit, dokumente plotësues nëse ka), dosjes digjitale (Dosje me informacione të mbledhura të hedhur në hartë me pozicionin përkatës) dhe fletës së inventarizimit ç`ka do të bëjë të mundur krijimin e një harte digjitale ku do të pasqyrohen subjektet që operojnë në fushën e turizmit, por kjo detyrë nuk është realizuar nga AKB .
Pasuritë e identifikuara dhe ato në proces identifikimi, paraqesin të dhënat për strukturat Akomoduese dhe të shërbimit, ndërkaq AKB ende nuk ka filluar puna për identifikimin dhe evidentimin e situatës së zonave bregdetare të hedhura në sistemin e regjistrimit fillestar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 40-43 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

**17.1 Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa dhe të përcaktojë grupe pune për plotësimin e hartave sipas numrit të pasurive për strukturat akomoduese dhe të shërbimit dhe të bashkëpunoj me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe të rakordojë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, mbi situatën e zonave bregdetare të hedhura në sistemin e regjistrimit fillestar, si dhe t'i kërkojë bashkive bregdetare statusin e regjistrimit të pasurive publike, përfshirë ato të transferuara, me qëllim krijimin e një inventari të zonës së bregdetit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**18.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se**,** kontratat për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturë shërbimi janë konstatuar mangësi në elementët dhe dokumentacionin e nevojshëm, në dosje si vijon:
-Në 9 raste, aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë për stacione plazhi janë miratuar me plan operimi që nuk është sipas formatit të publikuar online dhe nuk janë plotësuar nga subjekti sipas rubrikave të kërkuara;

-Në 16 raste, nuk janë paraqitur fotografi të strukturës së shërbimit/ strukturës akomoduese në raport me stacionin e plazhit;
-Në 5 raste, aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë për stacione plazhi janë miratuar pa certifikatat e kualifikimit të vrojtuesve;
-Në 2 raste, subjekti rezulton debitor në tatime;
-Në 2 raste, subjekti nuk ka të regjistruar aktivitetin "strukturë shërbimi/strukturë akomoduese" në ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 46-50, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

**18.1 Rekomandim:** Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve të marrë masa që të shqyrtojë aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit, në respektim të kritereve dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi, duke përfshirë kontrollin e rregullshmërisë nga pikëpamja ligjore e dokumentacionit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, në 9 raste kontratat për ushtrimin e stacioneve të plazhit në kontratat e punës ndërmjet subjekteve dhe vrojtuesve të plazhit është përcaktuar se vrojtuesit kanë 1-2 ditë pushim në javë. Në këto raste mungon një vetëdeklarim i subjektit, se nuk do ta ushtrojë veprimtarinë përgjatë gjithë ditëve të javës". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 49-51, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

**19.1.Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa në vijimësi, që para nënshkrimit të kontratës, subjekti duhet të paraqesë marrëveshjen e noterizuar me vrojtuesit e plazhit, e vlefshme përgjatë gjithë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se**,** në 7 raste kontratat për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturës së shërbimit , kontratat e formatit tip të qirasë nuk janë firmosur nga përfaqësues të Bashkisë së Vlorës ". *(Më hollësisht trajtuar në pikën p 4, faqet 46-54 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

**20.1.Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që të njoftojë në rrugë shkresore njësitë vendore përkatëse për nënshkrimin e kontratave, që të vijohet më tej me përcaktimin e koordinatave në terren të stacioneve të plazhit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**21.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, në 7 raste kontratat për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturës së shërbimit janë konstatuar që janë në distancë prej stacioneve të plazhit. Ndërkohë për të njëjtën situatë objektive, nga ana e Grupit Teknik të Shqyrtimit të Aplikimeve janë refuzuar disa subjekte. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 46-54, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

**21.1.Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa që ti shqyrtojë aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë/juridikë, duke i trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjithë subjektet aplikuar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**22.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, kontratat për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhe/strukturës së shërbimit është konstatuar se, anëtarët e Grupit Teknik të Shqyrtimit të Aplikimeve nuk kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në momentin e mbylljes së aplikimeve.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 43-55 të Raportit Përfundimtarë të Auditimit).*

**22.1.Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masat që anëtarët e komisionit të shqyrtimit të aplikimeve të përpilojnë deklaratat e konfliktit të interesit në momentin e fillimit të procesit të shqyrtimit të aplikimeve për ushtrimin e veprimtarive të stacionit të plazhit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

***Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtarë Auditimi.***

**GRUPI I AUDITIMIT**
V.**B.**Përgjegjës grupi
Sh. **H.** Anëtare
A.**V.** Anëtar

**DREJTORI I DEPARTAMENTIT**

A. **Z.**